

THANAS
QERAMA

BIBLIOTEKA
E
SHTETIT
GJIROKASTËR

81H-93-31
245



**NJË JAVË
NË VITIN
2044**

Roman fantastiko - shkencor

8.11-31

2 45

BIBLIOTEKA E PIONIERIT

THANAS QERAMA

**NJË JAVË
NË VITIN
2044**

Roman fantastiko-shkencor



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

E DIEL 3 KORRIK 2044

Admiri iu afrua bibliotekës dhe nisi të vështronte me vëmendje titujt e librave. Zgjati dorën dhe mori njërin prej tyre. Sa herë e kishte lexuar! I pëlqente mjaft. Nga ai libër kishte mësuar aq shumë për qëndresën e shqiptarëve kundër armiqve.

Ishte harruar i tëri pas rreshtave, kur dëgjoji një tingull të mprehtë për të dytën herë. Admiri u përmend. U ngrit me shpejtësi dhe shtypi butonin e aparatit televiziv shtëpiak. Ky kishte pak

kohë që ishte shpikur dhe shumë familje e përdornin në apartamentet e tyre. Sapo dëgjohej tingulli i ziles së derës së jashtme, ai që ishte brenda. Shtypte një buton dhe në një ekran televiziv shfaqej fytyra e atij që i binte ziles. Në ekran u dukën fytyrat e nënës, të babait dhe të motrës. I bëri përshtypje fytyra e motrës. Dukej e mër-zitur.

— Akoma në gjumë ishe? — e pyeti nëna.

— Jo, po lexoja. Po ti, Ina, ç'ke? — iu drejtua së motrës.

Ajo dukej gati më të qarë. Adi pa nga prindërit. Ata vunë buzën në gaz dhe u futën në korridor.

— Fol, pra, pse je e mër-zitur? — Adi iu afrua më pranë motrës dhe i përkëdheli lehtë flokët.

Ina sapo i kishte mbushur 10 vjetët. Vinte pak e hollë dhe e gjatë, me leshra të verdha, shumë të verdha.

Ajo e pa njëherë e pastaj foli shumë shpejt:

— Pse të mos jesh i gëzuar ti? Je gjithmonë me fat. Vetëm unë duhet të kaloj gjithë verën në Tiranë.

— Ti nuk ke një javë që u ktheve nga kampi i pushimit të pionierëve në Valbonë, — tha duke qeshur Adi.

— E, e, po nuk kam qenë në bregdet ama! — u ankua ajo.

— E kush ka qenë në bregdet?

— Nuk ka qenë, por do të shkojë!

— Kush kështu? — Adit i rrahu zemra fort.

Ndoshta ishte fjala për të. Do t'i pëlqente mjaft. Vitin e kaluar kishte qenë në një kamp malor, por ai asgjë nuk mund të krahasonte me detin. — Mos e ke fjalën për mua? — pyeti tani me këmbëngulje.

— U vendos, — tha me nxitim Ina, ngaqë nuk mund ta mbante të mbyllur mërzinë e saj. — Ti dhe Gjergji do të shkoni një javë me pushime në Durrës. Do t'ju marrë babai me vete.

— Ashtu! — thirri Adi dhe, pasi e kapi të motrën nga dora, u fut bashkë me të brenda.

Në korridor gati u përplasën me nënën.

— Na fal, nënë, por ne...

— Unë, thuaj, — ndërhyri Ina.

— E pra, unë jam shumë i gëzuar që do të shkoj me pushime në Durrës. Të falem nderit shumë. — Ai e puthi nënën fort në faqe.

— Vetëm unë duhet ta duroj vapën e Tiranës këtu, — pëshpëriti Ina dhe u fut në dhomë.

Agroni, ulur në divan, po ndiqte një emision televiziv dhe, tek dëgjonte fëmijët e tij, qeshte me vete.

— Ina, — tha ai, — harrova të të them se gjatë gushtit do të jem me punë në Himarë. Mund të vish bashkë me mua të takosh edhe tezen.

— Oh, baba, sa po më gëzon! Po mamaja nuk do të vijë?

— Sigurisht edhe mamaja, në qoftë se nuk ke ndonjë kundërshtim, — ia ktheu ai duke qeshur.

— Po, po, patjetër, edhe mamaja, po Adi?

— Jo, Adi do të rrijë në shtëpi. Apo ta marrim!

— E marrim, e marrim! — thirri ajo dhe iu drejtua vëllait: — Adi, e sheh?

— Falemnderit, motër, por...

— Por tani duhet të përgatiteni të dy për gjumë, — tha nëna. — Pásdite do të shkojmë te liqeni artificial.

Të dy fëmijët shkuan në dhomën e tyre për të pushuar në orët e vapës.

*

* *

Iliri u mbështet në karrige dhe pa orën e dorës. «Tani Ana duhet të jetë zgjuar nga gjumi i pasdites», — mendoi ai dhe formoi numrin në videofon. Në ekran u duk fytyra e një vajze të re.

— U zgjove më në fund? — e pyeti Iliri.

— Pse më në fund? Kam fjetur vetëm një orë! — tha ajo si e çuditur.

— Kurse unë nuk kam fjetur fare, — ia ktheu Iliri.

Ana qeshi. Iu kujtua zakoni i Ilirit për ta kaluar pasditen duke lexuar. Ai nuk donte të flinte, sepse, siç thoshte vetë, nuk e zinte gjumi natën.

— Lexove? — e pyeti Ana.

— Po, ç'do të bëjmë tani?

— Sonte e ke radhën ti të zgjedhësh, — tha Ana.

— Atëherë më prit, do të shkojmë në pistën e Currilave.

Iliri mbylli videofonin dhe u ngrit. Shtëpia e Anës nuk ndodhej larg zyrës së tij.

Me Anën, Iliri ishte fejuar para një viti. Iliri u gëzua kur mori vesh se e kishin emëruar me detyrë në qytetin e Durrësit, sapo kishte përfunduar me sukses shkollën e lartë të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Por a do të mësohej vallë me këtë qytet bregdetar ai që ishte mësuar në atë qytet malor, pranë atij lumi të mrekullueshëm, me një emër të bukur, Valbona?

Këto shqetësime i pati vetëm ditët e para, sepse më vonë atij i dukej sikur kishte jetuar tërë jetën në Durrës, sikur që në fëmijëri ishte larë çdo verë në plazhin e bukur të Currilave. Iliri, në qytetin e tij të lindjes, dallohej si notar i zoti, por në Currila sikur gjeti mundësinë të shfaqej plotësisht. Apo nuk notonte edhe Ana mjaft mirë! Të dy së bashku, në ditët e pushimit, vishnin akualangët dhe kalonin orë të tëra nën det, duke u futur nëpër labirintet e shumta e të errëta të shkëmbinjve të Currilave.

Duke kujtuar gjithë këto, Iliri u gjend para shtëpisë së Anës dhe pas pak ndjeu nëpër shka llë hapat e saj.

U drejtuan nga stacioni i urbanit, për të shkuar në Currila.

«Është vend i qetë dhe i bukur», — thoshte shpesh Iliri. Edhe Anës i pëlqente.

Ata qëndruan në trotuar dhe pritën duke biseduar e duke qeshur me njëri-tjetrin. Njerëzit filluan të grumbulloheshin. Tani duhej të vinte edhe urbandi. Pas pak ai u duk në fund të rrugës së gjerë. Iliri kapi Anën për dorë dhe iu afrua edhe më stacionit. Pikërisht në atë çast dëgjoji pas kraheve emrin e tij. Ktheu kokën dhe pa pas vetes një djalë të ri, rreth 20 vjeç.

— Ç'ka ndodhur, Genci? — pyeti me nxitim Iliri.

Genci, si i zënë në faj, i buzëqeshi me druajtje Anës dhe i tha:

— Ana, më fal, po do ta shkëput pak Ilirin.

Ajo në fillim u vrenjt, por vetëm për një kohë fare të shkurtër, sa të dy djemtë nuk e vunë re, pastaj i zgjati dorën Gencit dhe i tha:

— Si jo, po pres këtu, — dhe me bisht të syrit pa urbanin që u nis. Genci e tërhoqi pak më tej Ilirin dhe nisën të bisedonin.

— Ka ardhur një radiogram nga Tirana. Shefi po të pret në zyrë. Do të jetë ndonjë çështje shumë urgjente.

— Po çfarë? Nuk tha gjë shefi? — pyeti i interesuar Iliri.

— Dëgjova vetëm se bëhej fjalë për sondën detare «SD-1».

— Ashtu? Prit pak sa të ndahem me Anën.

Sapo u kthye, sytë i zunë Anën, e cila kish-te vënë buzën në gaz. E kishte kuptuar se plani për të kaluar mbrëmjen në Currila do të lihej për njëherë tjetër.

Edhe Iliri qeshi. Ata të dy e kuptonin mirë njëri-tjetrin.

— Shko, — tha Ana, — unë po shëtit një copë herë e po kthehem në shtëpi.

Iliri i shtrëngoi dorën dhe u largua. Genci e përshëndeti prej së largu të fejuarën e shokut. Ata të dy hipën në një veturë dhe u nisën me shpejtësi.

Shefi po e priste. Sapo hyri Iliri brenda, ai i zgjati një copë letër, ku ishte shkruar: «Në fund të javës do të inaugurohet sonda speciale për nxjerrjen e naftës nga deti. Sipas një informate të sigurt, për këtë sondë speciale po interesohehet edhe zbulimi i një shteti imperialist. Ngarkoheni me sigurimin e sondës. Merrni masa të menjëhershme. Me këtë detyrë të ngarkohet Ilir Meta; të lirohet nga të gjitha detyrat e tjera».

Iliri u ul. Pas pak, pasi e lexoi edhe një herë, ngriti sytë drejt shefit. Edhe ai po e shihte.

— Si thua? — pyeti shefi.

— Ne jemi të gatshëm, — iu përgjigj Iliri, — nesër do t'ju raportoj për masat e para.

— Mirë, — tha shefi dhe i zgjati dorën.

Iliri, pasi doli, u mbyll në zyrë së bashku me Arbenin dhe Besnikun. Të dy këta shokë ishin caktuar të punonin me të. Vetëm ndaj të gdhirë u kujtuan se duhej të flinin. Të tre ishin të lodhur.

*

* * *

Vonë në mbrëmje, pasi u kthye nga shëtitja në liqenin artificial të Tiranës, Adi kërkoi në videofon shtëpinë e Gjergjit.

— Po ku humbe? — iu shkreh Adi. — Të kam kërkuar disa herë.

— Mirëmbrema, Adi. Kam shëtitur disa dyqane. Nuk isha fare i përgatitur për këtë udhëtim në plazh.

— Se mos do të rrimë me muaj atje! Mos u ngarko me shumë plaçka. Si thua, a marrim edhe aktualanget?

— Patjetër, do të zhytemi në Currila. Është shumë bukur.

— Do të shkojmë me trenin që niset në ora 7.00, — tha Adi.

— Po xhaxhi Agroni?

— Bashkë do të shkojmë.

— Natën e mirë dhe mirupafshim.

— Natën e mirë. — Adi mbylli videofonin dhe u ul pranë të atit. Sinjali i videofonit u dëgjua përsëri. Adi shtypi butonin. Nga rrjeti interurban kërkonin inxhinier Agronin.

— Baba, të kërkojnë!

Agroni u ngrit.

— Urdhëroni, ju dëgjon Agron Kovaçi.

Në ekran u duk një burrë mbi të pesëdhjetat. Në fytyrë ishte ca i vrenjtur.

— Mirëmbrema, Agron. Si kaloi e diela?

— Fare mirë, — u përgjigj Agroni, — por ç'ka ndodhur, shoku drejtor?

— Asgjë, asgjë, veçse duhet të nisesh sa më parë.

— Ka ndodhur gjë në sondë? — u shqetësua Agroni.

— Jo, por duhet të nisesh; të pres në zyrë.
Kur vjen treni nga Tirana?

Agroni hapi bllokun.

— Shpejt do të jem në stacionin e Durrësit.

— Nisu pra! — tha drejtori dhe fytyra e tij u zhduk nga ekrani.

— Ç'ka ndodhur? — pyeti Adi.

— Nga ta di unë! Diçka duhet të ketë ndodhur. Ti me Gjergjin nisuni nesër në mëngjes. Do t'ju pres në stacion. Natën e mirë!

Ai u përshëndet me njerëzit e shtëpisë dhe iku. Te stacioni i trenit arriti një minutë para nisjes. Sapo u ul në sedilje, treni u shkëput me shpejtësi.

Agronit i kaluan në mendje shumë gjëra. Mbi të gjitha i trembej ndonjë defekti në sondë. Kantieri i tyre ishte specializuar prej vitesh për nxjerrjen e naftës në det, por sonda e re ndryshonte krejt nga të tjerat. Mënyra e nxjerrjes së naftës këtë radhë ishte krejt e re. Sesi iu kujtuan fjalët e ministrit të Naftës atë ditë që do të fillonin punën për herë të parë:

«Ju kemi zgjedhur ju si specialistë më të zotë. Detyra është tepër e vështirë. Ka të dhëna të sigurta, shkencore, se aty ka rezerva shumë të mëdha naftë. Kjo naftë i duhet në një afat sa më të shkurtër shoqërisë sonë socialiste. E dyta, mundësitë e një shpërthimi janë më të mëdha se çdo herë, prandaj bëni shumë kujdes. Nuk lejohet as gabimi më i vogël, përndryshe do të ishte një katastrofë: nafta do të humbiste në det, bregdeti deri në brigjet e Vlorës do të ndotej e do të ngordhte çdo gjë e gjallë, dhe, kryesorja, çdo

shpërthim mund të rrezikonte jetën e njerëzve. Prandaj ju porosit edhe një herë: ecni me kujdes, me siguri!»

Agroni, duke kujtuar këto fjalë, sesi u drodh. Megjithatë e bindi veten se nuk kishte ndodhur asgjë e tillë.

Te dera e stacionit e priste vetura e kantierit të tyre.

Pas pak mbërritën në kantier. Në zyrën e drejtorit ndodheshin edhe dy persona, që nuk i kishte njohur më parë.

— Dy specialistë nafte, — ndërhyri drejtori. — Njihuni, do të punoni bashkë.

— Kujtim Vraka, — tha njëri, — inxhinier në drejtorinë e Jonit.

— Naim Dylja, — tha tjetri, — nga Shëngjini.

Pak ditë më parë, drejtorit të kantierit i kishte ardhur njoftimi se do të dërgoheshin dy specialistë të zotë për të ndihmuar punimet në sondë. Emrat e tyre nuk ishin të padëgjuar, ndaj ai u gëzua shumë. Ata, së bashku me Agronin, do të kapërcenin patjetër çdo vështirësi.

Të dy këto drejtori për nxjerrjen e naftës nga deti kishin përvojë, ndaj Agronit i erdhi mirë që do të punonte me ta.

Ai ia nguli sytë shokut nga Shëngjini, Naimit. Kishte një fytyrë të gjerë, me ca sy tepër të gjallë e të lëvizshëm.

Naim Dylja kishte qenë një ndër të parët naftëtarë të vendit që ishte zhytur poshtë, në thellësi të detit, për të ndrequr një defekt të son-

dës, pa e ngritur kokën e saj në sipërfaqe. Kjo gjë kishte kursyer dy javë punë. Më vonë, Agroni kishte dëgjuar përsëri për një tjetër shpikje të tij dhe gjithnjë i shtoej dëshira të njëjtoj me të.

Para disa vjetësh e kishte parë fotografinë e tij në gazetën «Zëri i popullit». Kishte dalë midis shokëve, veshur me uniformën e naftëtarëve. Poshtë fotografisë kishte lexuar: «Heroi i Punës Socialiste Naim Dylja me brigadën». Titullin e lartë e kishte marrë në prag të 100-vjetorit të themelimit të Partisë së Punës të Shqipërisë.

Kur kishte lexuar se Naimi ishte naftëtar, Agroni ishte çuditur dhe u kishte thënë shokëve: «E shikoni, naftëtar tjetri dhe ka bërë një shpikje, që do të nderonte edhe inxhinierin më të zot».

«Këto ditë do të kem fatin të njihem më mirë me Naimin, — tha me vete Agroni. — Shumë gjëra mund të mësohen nga Heroi i Punës Socialiste».

Përbri Naimit ishte ulur specialisti tjetër, Kujtimi, inxhinieri që vinte nga drejtoria e Jonit. Kishte dëgjuar se e mbanin për njeri të zot.

Drejtori mori një copë letër nga tryeza dhe nisi të lexonte:

— «Sipas programit të hartuar nga kolektivi punonjës i kantierit tuaj dhe të miratuar nga ministria, të shtunën duhet të fillojë nxjerrja e naftës nga pusi «SD-1». Të shtunën do të jem aty. Ju uroj suksese. Ministri».

Drejtori pushoi dhe u hodhi të gjithëve një vështrim. Askush nuk po fliste. Agroni ngriti pak kokën dhe pa nga drejtori.

— Urdhëro, Agron, fol, — i tha ai.

— Sikur thamë se do ta shtyjme dhe një javë, — tha me gjysmë zëri Agroni.

— Kërkova të shtyhet, por nuk pranohet. U binda dhe unë se mund ta arrijmë në afat zbatimin e detyrës.

— S'them se nuk bëhet, por më tepër për të qenë të sigurt.

— Shoku Agron, — e mori fjalën inxhinier Kujtimi, — të jeni të bindur se ne do të punojmë me të gjitha forcat, si një trup i vetëm, që të mbahet fjala e dhënë.

Agroni i qeshi atij dhe tha:

— Mirë, njoftoni se të shtunën do të jetë çdo gjë gati.

Të gjithë ishin në një mendje me Agronin.

— E mbyllim? — tha drejtori.

Kujtimi u ngrit nga vendi dhe i shtrëngoi dorën Agronit.

— Kam pasur gjithnjë dëshirë të njihem me ju. Kini besim se do të realizohet edhe kjo detyrë e vështirë. Një lule e bukur në prag të 100-vjetorit të qirimit, apo jo, shokë?

«Këto fjalë do t'i themi më mirë kur të bëhet inaugurimi», — mendoi Agroni dhe pastaj iu drejtua shokut nga Shëngjini, Naimit:

— Si ju duket ky zotim?

Naimi e pa një copë herë dhe pastaj tha:

— Duhet të kesh shpatulla që të mbash gjithë këtë barrë të rëndë.

— Vështirë, ë? — pyeti Agroni.

— Shumë, por që bëhet, — ndërhyri Naimi.

— E patë projektin?

— Tërë pasditen. Sikur ta shihnim edhe një herë daltën e sondës?

Agroni ngriti sytë me shpejtësi. E pa me vëmendje Naimin dhe vuri buzën në gaz.

«I paska rënë pikës, — mendoj. — Aty e kam edhe unë dyshimin». Dhe pati një dëshirë të madhe të diskutonte me të. U larguan pak nga të tjerët dhe aty, në një qoshe të tryezës, Agroni filloi të vizatonte diçka në një copë letër.

— Kujtim, — thirri Naimi, — eja këtu, po diskutojmë për sondën.

— Ne jemi si nxënësit para mësuesit, — tha duke qeshur Kujtimi kur u afrua.

— Çfarë? — ngriti kokën Agroni.

— Pa hë, për çfarë po diskutonit? — ndërroi temë Kujtimi. — Unë e pashë me kujdes projektin.

— Dhe si t'u duk dalta e sondës? — pyeti Naimi.

— Fare në rregull, — u përgjigj Kujtimi.

Agroni e pa me vëmendje Kujtimin për të kuptuar në e kishte me gjithë mend, apo fliste ashtu kot, sa për të thënë diçka. Por në fytyrën e Kujtimit nuk mund të lexoje asgjë. Agroni tundi lehtë kokën dhe u përkul përsëri mbi projekt.

E HËNË 4 KORRIK 2044

Ata u ndodhën në stacion shumë minuta para nisjes. Nga padurimi ishin zgjuar herët dhe, pasi kishin biseduar në videofon, ishin takuar aty. Vetëm kur panë orën, vunë re se kishin ardhur shumë shpejt. Qeshën me njëri-tjetrin dhe u ulën në stol.

— Kemi për t'u kënaqur, ke për të parë, — tha Adi.

— Patjetër, — iu përgjigj Gjergji, — në bregdet nuk mërzitesh kurrë.

Bisedën ua ndërpreu zëri i folëses:

— Të përgatiten udhëtarët për në Durrës.

Të dy djemtë rrëmbyen çantat e tyre dhe u futën në vagon.

Agroni arriti në stacionin e Durrësit në një kohë me trenin. Zbriti nga vetura dhe u zgjat të dallonte diemtë në vargun e gjatë të njerëzve që vinin nga Tirana. I pa prej së largu dhe ua bëri me dorë. Adi e përshëndeti me buzë në gaz dhe iu afrua me vrap.

— Si jeni? — pyeti Agroni. — Jeni ngritur herët sot, apo jo? Mirë, ejani tani, nuk kam shumë kohë. Sa t'ju rregulloj në hotel dhe do të shkoj përsëri në punë.

— Babi, kaq shumë punë keni? — pyeti Adi.

— Punë ka gjithnjë, — qeshi i ati.

Pas pak, vetura u drejtua në perëndim të qytetit, në Currila.

— Do të pushoni në hotelin e naftëtarëve, në Currila, — u tha Agroni. — Aty, pranë dhomës suaj, është edhe dhoma ime.

Vetura u ndal te hyrja e hotelit me disa kate dhe ata të tre u ngjitën lart. Agroni u tregoi dhomën me dy shtretër dhe, pasi lëshoi çantat në dysheme, tha

— Unë po iki. Kini kujdes dhe mos u largoni shumë në det. Do të kthehem pasdite dhe dua t'ju gjej këtu. Kam marrë përsipër t'ju kënaq këtë javë dhe do ta mbaj premtimin. Mirupafshim.

Djemtë mbetën vetëm. Adi i hodhi një sy dhomës. Nga ballkoni hapej një pamje e mreku-

llueshme. Deti në këmbët e tyre, i kaltër, shumë i kaltër, sikur i ftonte në gjirin e tij.

Ai kishte qenë edhe herë të tjera në Currila dhe gjithmonë i kishte pëlqyer ky vend. Vilat ishin ndërtuar në dy rreshta paralelë, në një shesh që ngrihej si tarracë mbi bregun e mbushur me rërë. Poshtë tyre fillonte pasqyra e kaltër e ujit të detit. Zor se mund të gjendet në të gjithë bregun e Adriatikut një zonë kaq e qetë si në Currila. Është gjë e rrallë të ngrihen dallgë në këtë vend. Edhe atëherë kur në thellësi ngrihen dallgë të mëdha, në breg pothuajse nuk ndihen, përveç disa valëve të lehta, të cilat i japin edhe më bukuri bregut. Kjo e mirë i vjen Currilave nga brezi i drejtë dhe i gjatë i shkëmbinjve, që shtrihen paralel me bregun, 200-300 metra larg. Sikur të jenë vënë për atë qëllim, shkëmbinjtë presin dallgët, që mezi arrijnë deri në breg si valë të vogla e të lehta.

Adi, që nga ballkoni i hotelit, hodhi sytë larg, atje ku dalloheshin shkëmbinjtë. Ata nuk ngriheshin më shumë se një pëllëmbë mbi ujë, po, kur kishte zbatice, dukeshin më shumë. Në ato raste, mbi ta qëndronin për të bërë pushime të shkurtra pulëbardhat. Atë ditë, deti në thellësi ishte ca i trazuar e kjo bënte që te shkëmbinjtë të formohej një shkumë e bardhë.

— Gjergji, shiko sa bukur! — Dhe tregoi me dorë andej. — Ka mendime se ata shkëmbinj kanë qenë mure të vjetra të qytetit antik, Dyrrahut.

— E mo edhe ti njëherë, sikur kemi ardhur për shkëmbinjtë këtu, — qeshi Gjergji. — Unë mezi po pres të futem në ujë!

— Edhe unë, — tha Adi. — Nuk më durohet sa të futem në ujë. Mos harro mjetet.

U zhveshën, rrëmbyen akualanget dhe zbritën me shpejtësi shkallët e hotelit. Në breg kishite shumë njerëz. Si zakonisht, bashkë me pluhurin e rërës, ngrihej edhe një zhurmë zërash, ku dalloheshin më shumë ata të fëmijëve. Dielli i korrikut i ngrohu djemtë.

Adi ndryshonte shumë nga Gjergji. Ai ishte më i gjatë, gati një pëllëmbë, dhe nga kjo përfitonte e shpeshherë tallej me shokun, që vinte më i shkurtër. Nga trupi i kishte ngjarë të atit. Edhe ai, si Agroni, ishte i hollë. Kjo gjë binte në sy më tepër në plazh, kur zhvisheshin në breg të detit. Gjergji, ashtu i shkurtër e i shëndoshë, tip përherë gazmor, në këto raste gjente mundësinë për t'u tallur me Adin e për të marrë hak. «Kujdes gjymtyrët, — i thoshte, — mos të të këputen!»

Si bënë ca shaka me njëri-tjetrin, rregulluan pushkët pneumatike dhe u nisën drejt detit. Lopatat e mëdha në këmbë i pengonin të ecnin nëpër rërë, por, sapo u futën në ujë, ndjenë lehtësi. U mëshuan fort lopatave dhe rrëshqitën tutje. Adi notonte përpara. Kishte qenë edhe herë tjetër në këtë breg dhe pak a shumë e njihte. Futej pa frikë nëpërmjet algave dhe leshterikëve të gjatë, të cilët kishin formuar ishuj të vegjël nën ujë. Vizita e tyre, siç dukej, u kishte prishur qetësinë banorëve të nënujit, sepse herë pas here, para xhamit të maskave të tyre notonin me shpejtësi peshq të ndryshëm, të trembur.

«Gjithmonë të frikësuar këta peshq!» — tha

Adi me vete dhe iu vu prapa një barbuni të madh. Rrezet e diellit, që depërtonin deri aty, bënë që herë pas here të shkëlqenin luspat e peshqve.

Një barbun ishte fshehur midis algave, por Adit i tërhoqi vëmendjen një peshk i ndritshëm, me luspa shumë të bardha. Notoi drejt tij. Ishte spalcë me bark të gjerë.


«Edhe ti je shumë e shijshme», — tha Adi.

Ndjeu ta tërhiqnin nga këmba. Gjergji po ja bënte me dorë drejt një kaçubeje me alga. Notoi andej krahas shokut. Gjergji i tregoi me dorë një peshk, që kishte qëndruar midis algave. Dukej sikur ishte në pozicionin për t'u nisur me shpejtësi. Peshku i tërhoqi vëmendjen Adit. I bëri shenjë Gjergjit që ta qëllonte. Donte ta shihte nga afër këtë specie të panjohur për të.

«Ç'shije do të ketë?» — tha Adi me vete.

Në atë kohë shigjeta fluturoi nga pushka e Gjergjit. Te vendi ku kishte qëndruar peshku u bë një turbullirë e vogël. Por vetëm për pak çaste, se pastaj çdo gjë u kthjellua dhe ata panë peshkun të përpëlitej, të shpuar tejprtej nga shigjeta. E tërhoqën pranë. Nuk e kishin parë ndonjëherë. Gjergji e futi në çantën e vogël të brezit dhe të dy filluan të notonin pranë bregut. Kishin bërë një zhvendosje të vogël nga e djathta. Dolën në breg aty ku ndodheshin disa shkëmbinj të vegjël, tutje vendit ku laheshin njerëzit.

Zhveshën kostumet dhe u bënë gati të shtriheshin mbi shkëmbinj për t'u ngrohur. Adi hodhi sytë pas shkëmbit dhe aty pa një djalë mo-shatar me të. E vuri re edhe Gjergji. Ishte nxirë



nga rrezet e diellit. Qëndronte shtrirë në rërë. Siç duket flinte. Para vetes kishte lëshuar një trastë të lagur (me siguri plot me peshq) dhe më tutje një kostum aktualu fare të ri. Kostumi u bëri përshtypje djemve. Nuk ishte si të tjerët. Kishte edhe bombola me oksigjen.

— Ky duhet të jetë peshkatar i vërtetë, — tha Gjergji.

— Ka mundësi. Në Durrës, gati të gjithë fëmijët merren me sportin e zhytjes.

Diçka i tërhiqte drejt tij, por druhashin t'i afrohashin ashtu pa u njohur. Adi mori një gurë dhe e hodhi pranë djalit të shtrirë në rërë. Ai u ngrit me shpejtësi dhe pa nga shkëmbi.

Adi e përshëndeti me dorë.

— Tungjatjeja, — tha ai. — Ejani! Nga do lët këtu?

Ata i dhanë dorën njëri-tjetrit dhe u ulën pranë e pranë.

— Jemi nga Tirana, — tha Adi. — Sot kemi ardhur dhe u futëm menjëherë në ujë.

— Na pëlqen shumë sporti i zhytjes, — vazhdoi Gjergji, — po ti?

— Jam nga Durrësi, — u përgjigj ai. — Më quajnë Taulant.

Taulanti ishte moshatar me ta, por kishte diçka që e bënte të dukej pak më i madh. Ndoshta nga fytyra e tij, ku binin në sy vetullat e gjera, por ndoshta edhe nga krahët e fuqishëm tërë muskuj. Ai dukej si sportist me atë trup të rregullt e të drejtë.

Duhet të jetë notar i «Lokomotivës»! — mendoi Adi.

Flokët e verdhë, më tepër të zverdhur nga kripa e detit, ku ai kalonte një pjesë të mirë të ditës, i binin mbi ballë, dhe Taulanti herë pas here i ngrinte me një lëvizje të shpejtë.

— Në këtë vend unë zhytem çdo ditë, — tha Taulanti, — por jo për peshkim. Më pëlqen të notoj nën ujë. Sot kam gjuajtur edhe peshq. Po ju, vratë gjë?

— Nuk u futëm për gjueti, — u përgjigj Adi, — megjithatë, Gjergji e vrau një.

Gjergji e nxori nga çanta peshkun e vrarë. Ai u çudit kur Lanti gati ia rrëmbeu nga dora.

— Ç'është ky peshk? — pyeti Lanti. — S'e kam parë ndonjëherë.

— Në det ka aq shumë specie, saqë nuk mund t'i njohësh të gjithë, — tha Adi.

— Peshqit e bregut i njoh mirë.

— Mos ndoshta ka kaluar rastësisht këtej? — pyeti Gjergji.

— S'ka mundësi, do ta kisha ndeshur ndonjëherë.

Pastaj për disa çaste heshtën.

Adit i shkuan sytë tek akualangu i Taulantit.

— I ri është? — e pyeti me zili.

Lanti ishte përpirë nga pamja e peshkut dhe nuk i dëgjoji fjalët e Adit. Ai po e rrotullonte nga të gjitha anët, duke e parë me imtësi.

— Çfarë the? — pyeti pastaj.

Adi përsëriti pyetjen.

— Po, janë nga më të rejat. Të gjithë zhytesit e pallatit të pionierëve kështu i kanë. Janë me elike te këmbët. Ato ndihmojnë të ecësh shpejt. Në kufje kanë dhe radio.

— Bisedoni nën ujë? — pyeti me nxitim Gjergji.

— Posi, — ia ktheu Lanti, — provojeni, po të doni.

Nuk e zgjatën shumë, vunë kufjet dhe Lanti i mësoi të bisedonin me njëri-tjetrin. Pa zë, vetëm me anë të lëvizjeve të laringut, Adi bisedoi për mrekulli me Gjergjin. I hoqën kufjet dhe po i vështrënin me kënaqësi.

— Kam një lutje, — tha Lanti, duke mos e hequr vështrimin nga peshku.

Ata e panë me çudi.

— A mund të ma dhuroni mua këtë peshk?

— Posi jo, — tha Adi, — Ne e vramë ashtu, kot.

— Do ta vendosim në muzeun e pallatit të pionierëve, — tha Lanti.

Të tre djemtë pas pak u ngritën dhe u nisën drejt plazhit. Tërë rrugës Lanti e lëvizte peshkun nga të gjitha anët. Duke biseduar miqësisht me njëri-tjetrin, ishin futur kështu mes turmës së njerëzve të shtrirë në rërë. U dukej të treve sikur kishin shumë kohë që njiheshin. Ndërsa Lanti po u tregonte shokëve të rinj për aktivitetin e pionierëve të qytetit, për ihtiologët dhe arkeologët e nënujit, u dëgjua një zë, më tepër si britmë. Djemtë shtangën në vend. Drejt tyre po vinte me shpejtësi një burrë i moshuar, ndoshta i kishte kaluar të gjashtëdhjetat. Ai po afrohej dhe vazhdimisht fliste me zë të lartë, gati të çjerrë:

— Një Blenius me katër sy! Një Blenius!

Djemtë panë njëri-tjetrin të çuditur. Burri u afrua dhe, fare pa i përshëndetur, i rrëmbeu peshkun nga dora Lantit, u ul në rërë dhe nisi

ta vështronte, sikur para tij ndodhej ndonjë mre-
kulli e paparë. Lanti desh të ndërhynte. Si mund
ta lejonte ai një sjellje të tillë, gati të pahijshme!
Vetëm mosha e madhe nuk e lejoi t'i thoshte
ndonjë fjalë atij burri. Ku ishte parë të të rrëm-
bente tjetri gjënë nga dora? Por burri nuk u la
kohë të thoshin asnjë fjalë. U ngrit dhe iu drej-
tua Lantit:

— Ku e gjete, ku e more? — Ai gati bër-
tiste.

Të tjerët, anash, kujtuan se djali do të ki-
shte bërë ndonjë faj. Burri vazhdonte me të ti-
jën:

— Ku e gjete? Ky është një Blenius me ka-
tër sy!

— Po ai ka vetëm dy sy! — tha Adi me zë
të ulët dhe e vështroi edhe një herë peshkun.
Një kalimtar iu afrua Lantit dhe i tha me gjysmë
zëri:

— Nuk e njihni? Është përgjegjësi i qendrës
shkencore të peshkimit.

Vetëm atëherë u qetësua Lanti.

Profesori ngriti kokën dhe i pa djemtë me
radhë. Dukej ca i nevrikosur.

— Kam vite që e kërkoj të gjallë këtë peshk.
Është një specie e rrallë në Adriatik dhe po shkon
drejt zhdukjes. Ç'keni bërë kështu, ç'keni bërë?
E keni shkatërruar fare. Ti e vrave? — iu drej-
tua Lantit.

— Jo, unë, — u përgjigj Adi.

— Dhe e thua me mburrje, sikur kushedi se
ç'ke bërë! Ja ta them unë se ç'ke bërë ti: një
krim, po, po, tamam një krim, të rëndë bile.

Adi u skuq në fytyrë.

— Kam vite që e kërkoj një Blenius të gjallë dhe shkoni e dëmtoni pa ju vrrarë ndërgjegjja aspak.

Adi pa nga shokët pa ditur çfarë të thoshte.

— Profesor, po sikur të mos e kishim ndeshuar fare këtë peshk?

Profesori sikur e mblodhi veten. Adi pa përsëri nga shokët. Ata vunë buzën në gaz.

— Ashtu vërtet, ashtu, — tha si i hutuar profesori, — nuk më vajti mendja fare... mos ma vini re, u inatosa kot fare. Përkundrazi, unë duhet t'ju falënderoj.

— S'është nevoja, — tha Gjergji duke qeshur, — vetëm se... mos na bëni fajtorë.

— Po, më falni, u nxitova...

Profesori, pa ia ndarë sytë peshkut, u shtrëngoi duart djemve. Ata u bënë gati të largoheshin. Lanti zgjati dorën për të marrë Bleniusin.

— Djema, e di çfarë, — tha profesori si me druajtje, — a mund të ma dhuroni mua këtë peshk?

Lanti pa nga Adi.

— Këtë mund ta vendosë vetëm Lanti, — tha Adi.

Profesori u kthye nga Lanti.

— Epo ... merreni, profesor ... — pëshpëriti Lanti.

— Faleminderit shumë, — u entuziazhua ai.

— Po sikur t'ju gjejmë një të gjallë? — e pyeti Gjergji.

— Çfarë?! — tha profesori. — Kam tre Blenius në laborator, por asnjë të gjallë ...

— Ku ta dish, edhe mund ta gjejmë, — tha përsëri Gjergji me vendosmëri.

— O, atëherë ju do të jeni djemtë më të mirë që kam takuar ndonjëherë.

Djemtë qeshën, u përsëndetën edhe një herë me profesorin dhe u larguan. Lanti dukej që ishte mërziur ca, ngaqë i iku peshku nga dora. Adi dhe Gjergji e kishin harruar fare këtë histori dhe tani mendonin për ditët e tjera që do të kalonin në plazh.



Ndërsa djemtë po ndaheshin nga njëri-tjetri, në kantier vlonte puna. Agroni ishte mbuluar nga djersët. Kishte hyrë e kishte dalë disa herë në laborator, ku ishte ndërtuar në miniaturë sonda e nxjerrjes së naftës nga nëndeti. Naimi qëndronte në laborator dhe bënte prova të ndryshme.

— Ç'bën Kujtimi? — pyeti në një çast Naimi.

— Nuk flet asnjë fjalë. — iu përgjigj Agroni. — Ka qëndruar në platformë të sondës dhe vetëm shikon në thellësi të detit, sikur do të dalë që andej zgjidhja që kërkojmë!

— Kam dëgjuar për të. — tha Naimi. — Nuk flet shumë, por është i zoti. Shiko, ai ka për ta gjetur zgjidhjen e saktë.

— Mirë, mirë, — mërmëriti Agroni, — por nuk duhet harruar se të enjten do të bëhet prova.

— Ndoshta nuk është mësuar të punojë me këtë ritëm, — u mundua ta shfajësonte Naimi.

Nuk folën më, po u kërrusën mbi sondën e vogël dhe e vunë përsëri në punë.

Ishin hutuar pas punës dhe as që e ndjenë se Kujtimi hyri brenda dhe qëndroi pas shpinës së tyre.

— Kam një ide, — u dëgjua zëri i tij.

Vetëm atëherë Agroni dhe Naimi e vunë re dhe u ngritën. Kujtimit i qeshnin sytë.

— Kam një ide, — vazhdoi ai. — Të zëvendësojmë daltën e sondës.

— E pamundur! — thirri Agroni. — Do të duhen dy ditë të plota për të bërë këtë gjë, kurse e enjtja arriti.

— E përse dy ditë? — pyeti Kujtimi. — E montojmë pa e ngritur sondën.

— Pa e ngritur? — Këtë radhë ishte Naimi që u çudit.

— Zhytemi brenda nën ujë. Vetë uji do të na ndihmojë të lëvizim pa vështirësi peshën e rëndë dhe të vendosim pajisjen tjetër.

Agroni pa nga Naimi.

— Nuk thua keq, — ia ktheu ai pas pak, — por ...

— Nuk ka asnjë por, — ndërhyri edhe Naimi. — Është punë shumë e lehtë.

— S'e kam aty fjalën, por ti s'na the kryesoren. Çfarë pajisje do të jetë ajo? — Kujtimi u ul në karrige, pranë sondës së vogël të laboratorit. Mori një copë letër e një laps.

— Ja këtu, — tha, — është tërë rreziku. Nuk mund të përparojmë kaq shpejt sa kërkohet,

sepse ka rrezik të shpërthejë nafta dhe atëherë do të ndotet gjithë sipërfaqja e detit; veç kësaj, nafta do të shkojë dëm.

— Ky rrezik dihet, — tha Naimi.

— Shumë bukur, — vazhdoi Kujtimi, — atëherë vendosnim një pajisje të re, përshtatje e pajisjes që përdoret edhe në tokë.

Agroni iu afrua pranë. Ideja po e tërhiqte.

— Kjo pajisje dihet që sinjalizon për gjetjen e burimit disa metra më parë se të arrihet atje. Kështu që do të njoftohemi me anë të valëve ultra të shkurtra e do të marrim masa për çdo rrezik.

— Mrekulli, të lumtë, Kujtim! — u entuziaz-mua Naimi.

— Dale, dale, — tha Agroni duke folur me zë të ulët, — ideja është shumë e mirë, po në kushtet tona nuk mund të realizohet.

— Pse? — pyetën dy të tjerët me një zë.

— Në ujë, këto lloj valësh përhapen më me ngadalë se në tokë dhe kështu, kur të marrim sinjalin, ndoshta do të jetë vonë për të shmangur rrezikun.

Kujtimi ndjeu shqetësim. Sytë e tij nuk po përqendroheshin asgjëkund.

— Kjo nuk më shkoi ndër mend, — tha pas pak dhe lëshoi lapsin e letrën në tryezë.

— Mos u mërzit, Kujtim, — foli Naimi, — ti dhe një ide të bukur, e cila duhet të studiohet. Po sikur ... më duket e gjeta ... të shtojmë intensitetin e valëve të shkurtra në aparat, atëherë sinjalizimi do të jetë në kohë dhe i saktë.

— Po, po, tamam ashtu, kjo mund të bëhet.

Ta provojmë. — Agroni ishte i entuziazmuar këtë radhë. — Si thua ti, Kujtim?

Kujtimi vuri buzën në gaz dhe i shtrëngoi dorën Naimit:

— Tani e zgjidhëm plotësisht. Të fillojmë provat, — iu drejtua pastaj Agronit.

— Do ta mbajmë fjalën për të enjten, mos u merakos.

Agroni qeshi dhe i rrahu shpatullat shokut.

*

* * *

Pasditen e së hënës, Adi dhe Gjergji kishin dalë në ballkonin e dhomës dhe po shikonin nga deti.

Tutje, nga e majta e tyre, shfaqej madhështor porti i Durrësit. Elektrovinçat e fuqishëm, me qafat e tyre të gjata, ngjanin si lejlekë gjigantë. Ulnin e ngrinin qafat dhe aty ku duhej të ishte sqepi, lëkundeshin arka të mëdha, makineri të ndryshme.


Pas pak u dëgjua një fërshëllimë. Gjergji pa nga ballkoni. Nga poshtë po ua bënte me dorë Lanti.

— Erdhëm!

Në pallatin e pionierëve kishte gjallëri. Ata shkuan në rrethin e zhytësve.

— Dy shokë të rinj nga Tirana, — i tha Lanti instruktorit. — Kanë dëshirë të njihen me aktivitetin e rrethit tonë shkencor.

— Ashtu? — u gëzua instruktori. — Uluni! Keni ardhur në kohë. Sapo do të shfaqim filmin e fundit xhiruar nën ujë.



Ata zunë vend dhe në ekran nisën të dilnin pamjet e para. Në breg, disa pionierë duke u veshur me kostumet e nënujit.

Pamjet e filmit të çonin nën ujë, midis algave dhe shkëmbinjve të ndryshëm të Currilave. Dëgjohej zëri i folësit:

«Në bregdetin e Currilave janë mbytur, gjatë shekujve, shumë anije, për arsye nga më të ndryshmet. Disa prej tyre shihen akoma gjysmë të shkatërruara. Por ka edhe shumë anije të tjera të mbytura shekuj më parë, të cilat ndoshta janë

mbuluar plotësisht. Ekspedita e zhytësve të ujit të pallatit të pionierëve, në këtë ekskursion, kish-te si qëllim të zbulonte pikërisht ndonjë nga kë-to anije. Zbulimi i anijes «Delfini», mbytur në fillim të shekullit të 19-të, ishte një sukses për këtë ekspeditë».

Në ekran u duk një anije e vogël druri, ga-ti e shkatërruar. Sipas historianëve, ajo duhet të ketë qenë anije transporti, që lidhte Durrësin me Shëngjinin.

«Në këtë anije mund të dallohen qartë tradi-tat e ndërtimit të anijeve shqiptare. Pas një she-kulli, ky tip anijeje u zhduk plotësisht dhe ven-din e saj e zunë anijet metalike. Por sa e sa anije fshihen në gjirin e detit. Historia na njeh me fak-te të ndryshme. Ka shumë anije të mbytura në këtë bregdet. Të tilla janë dy anijet romake «Zeu-si» e «Zeta», të mbytura në shekullin e dytë të erës së re. Këto anije ishin ngarkuar me objekte arti të kulturës ilire, të grabitura në Dyrrah dhe Apolloni. Ato u mbytën si pasojë e një sulmi detar të bërë nga anijet ilire, të cilat nuk lejuan që pasuritë e kombit tonë të shkonin në dhe të huaj. Ku do të jenë fshehur vallë? Pionierët e ekspeditës këtë qëllim i kanë vënë vetes. Ju uroj-më sukses».

Në ekran dukeshin pamje të ndryshme, lloj-lloj peshqish. Në një vend u duk Lanti duke ndjekur një peshk të madh. Lanti qeshi.

— E dini ç'ndodhi atë çast? — iu drejtua Lanti të dy shokëve. — E qëllova peshkun, por ai ishte shumë i madh. Megjithëse i plagosur, pati forcë të largohej. Më tërhoqi mua me vete. E

lëshova shtizën dhe peshku u zhduk bashkë me të.

— Dhe nuk e gjetët më peshkun? — pyeti Gjergji.

— Me siguri ka ngordhur; do të jetë strukur poshtë ndonjë shkëmbi bashkë me shtizën në kurriz. Jam zhytur disa herë për ta gjetur, por më kot. Ato ditë, ekspeditën tonë e quajtëm «Në kërkim të anijeve të mbytura dhe të shtizave të humbura».

Djemtë qeshën. Kur dolën nga salla, ishte në të ngrysur. Ata nxituan për në shtëpinë e Lantit. Kaluan dy orë shumë të këndshme. Do të kishin qëndruar edhe më shumë, por nëna e Lantit erdhi e i tha Adit:

— Të kërkojnë në videofon.

— Mua? — u çudit ai. — Kush mund të më kërkojë?

Kur u afrua në videofon, pa në ekran të atin dhe u kujtua se nuk e kishte pritur siç e kishin lënë fjalën.

— Baba, si më gjete? — pyeti Adi.

— Fare lehtë. Qendra e informacionit nuk e pati të vështirë të gjejë dy djem që nuk e mbajnë fjalën.

Adi uli kokën.

— Jam në hotel, — vazhdoi babai. — Ejani shpejt.

Adi me Gjergjin u përshëndetën me njerëzit e familjes së Lantit dhe u larguan.

Agronin e gjetën të ulur në restorant. Kishte porositur edhe për djemtë. Filluan të hanin në qetësi.

— Përsëri do të shkosh, baba? — pyeti Adi.

— Po, kemi shumë punë këto ditë.

— Çfarë pune bëhet atje? — pyeti Gjergji.

— Shëët, — vuri gishtin në buzë Adi. —

Sekret!

Agroni qeshi.

— Mos u tall me babanë, — tha ai. — Shumë gjëra janë sekret. Aq më tepër puna jonë e tanishme. Megjithatë, disa gjëra mund t'jua them. Ne po punojmë për të nxjerrë naftë nga fundi i detit. Kjo nuk është ndonjë gjë e re. E rëndësishme është se kemi zbuluar një rezervë të madhe nafte dhe do ta nxjerrim me një teknikë e mënyrë të re. Ka vite që në botë ka një uri të madhe për energji dhe nafta siguron akoma pjesën më të madhe të saj. Shtete imperialiste mundohen t'ua rrëmbejnë këtë naftë të tjerëve deri edhe me agresion ushtarak.

Po ju e dini, Shqipëria nuk i ka nderur dorën askujt. Më 29 Nëntor të këtij viti do të festojmë 100-vjetorin e Çlirimit dhe të fitores së revolucionit popullor. Punonjësit e naftës do ta presin festën me suksese. Armiqtë e kanë halë në sy Shqipërinë socialiste. Ata përpiqen që ne të mos i shtojmë burimet tona të naftës.

Agroni heshti dhe hodhi sytë tek ora e murit të restorantit.

— Më duhet të iki, — tha. — Bëni një shëtitje të vogël në breg të detit dhe shtrihuni. Dueni që jeni të lodhur. Natën e mirë.

U ngrit e doli nga restoranti. Te dera e hotelit e priste vetura.

Atë mbrëmje, sapo ora tingëlloi 20.00, mister Xhoni ndjeu një dhembje koke. Ditët e fundit, dhembja e kokës po e shqetësonte shpesh. E kishte nga telashet që ishin shtuar mjaft. Nuk mjaftonte kjo, por të nesërmen duhej të paraqitej te drejtoria e institutit dhe të raportonte me hollësi çdo gjë. Ai u ngrit dhe bëri një shëtitje të shkurtër nëpër kabinetin e tij të madh. Pastaj u ul në poltronë. Pas një ore do të vinin të gjithë ata që kishin përgatitur dhe punonin për realizimin e operacionit «Gjarpri i detit». Mbi tryezë ndodhej një bllok i trashë, i zi. Ishte një ditar i gjyshit të mister Xhonit. Edhe atë e quanin Johan, si gjyshin, por emri i tij ishte transformuar dhe tani e thërrisnin Xhon. Meqë jetonte jashtë Gjermanisë, një emër gjerman as që mund t'i hynte në punë. Iu përfytyrua gjyshi i veshur me uniformë naziste në bregdetin e Shqipërisë në vitin 1944. Sa herë e kishte lexuar atë ditar! E hapi diku me hamendje dhe lexoi: «... përndim të qytetit të Durrësit kemi ngritur një pikë sekrete. Megjithëse kam gradën e majorit, nën urdhrat e mia janë vetëm pesë veta. Shokët e mi në frontin e Rusisë mund të komandojnë tani edhe një brigadë. Por këta të pestë nuk janë njerëz do-sido, por shkencëtarë të njohur, të veshur si ushtarë të prapavijës...»

«... sot jam i gëzuar. Të gjitha shenjat këtu tregojnë se ka naftë. Shqiptarët as që e marrin me

mend këtë gjë. Ata akoma nuk kanë mësuar ta nxjerrin naftën nga toka e jo nga deti...»

«...Nuk ka asnjë dyshim. Sot u binda përfundimisht. Përcaktuam mjaft mirë vendndodhjen e burimit. Duhet njoftuar komanda për të marrë masa më të forta sigurimi.»

Mister Xhoni shfletoi disa fletë nga fundi i bllokut. Sa herë që lexonte faqet e fundit, i hip-te gjaku në kokë dhe nuk përtonte aspak ta shante gjyshin e vet.

«...as që mund ta merrja me mend se do të ndodhte kështu. Çdo gjë u zhduk brenda pak çasteve, gjithë ajo punë, gjithë ato kërkime. Po mirë që mbeta gjallë. Bashkëpunëtorët e mi nuk janë më...»

Mister Xhoni e la bllokun në tryezë. Nuk mund të lexonte më tutje. Vetëm një çetë partizane e kishte hedhur në erë laboratorin, ndërsa gjyshi i tij dhe komanda gjermane nuk kishin marrë asnjë masë mbrojtjeje. Çfarë mbeti tani nga ajo punë?

«Tërë munda yt. — iu drejtua ai me mend gjyshit. — përmblihet vetëm në një fakt: në përfundim të qytetit të Durrësit bregdeti ka naftë. Kaq. Po ku, në çfarë koordinatash... të gjitha këto u hodhën në erë». Ai u ngrit, vriu diçka dhe u mbështet përsëri në poltronë. Megjithatë ruante njëfarë respekti për gjyshin. Ishte pikërisht kjo informatë. që kishte bërë t'i kushtojë mister Xhoni operacionit «Gjarpri i detit» dhe të paguhej me një shumë të majme. Ai tani njihej në Institutin e Kërkimeve Ndërkombëtare me detyrën «Shefi i sektorit të zbulimit të naftës». Përdore-

shin emërtime shkencore për t'i prerë rrugën çdo dyshimi. Në të vërtetë, Instituti i Kërkimeve Ndërkombëtare nuk kishte të bënte fare me shkencën. Ai institut merrej vetëm me spiunazh e sabotime në vendet ku kishte fituar revolucionin popullor e po ndërtohej socializmi. Mister Xhoni ishte ngarkuar me Shqipërinë, me organizimin e spiunazhit e të sabotimeve në këtë kështjellë të socializmit në brigjet e Adriatikut. Mister Xhoni pa orën. Po shkante 21.00.

«Tani duhet të vijmë», — mendoi.

Pas pak u dëgjua një trokitje në derë dhe në kabinet u futën disa burra. Mister Xhoni i ftoi të uleshin në poltrona dhe vetë shkoi e u ul në tryezë. Që andej zotëronte krejt kabinetin. Kishin ardhur të gjithë. Ai nisi të fliste:

— Nesër do të jem në raport te drejtori. Operacioni «Gjarpri i detit» duhet të hyjë në veprim.

I bëri shenjë njerit. Ai u ngrit dhe nisi të fliste:

— Faza e parë e operacionit do të përfundojë brenda pak ditëve. Në qoftë se nuk do të pengohen punimet, atëherë nga agjenti ynë do të ndërhyhet për një sabotim: të shpërthejë nafta dhe të ndotet deti. Kjo është faza e dytë. Çdo gjë është menduar me hollësi!

— Po sikur faza e dytë të mos realizohet me sukses? — pyeti me të egër mister Xhoni.

— S'ka asnjë arsye, — nguli këmbë tjetri.

— Po sikur... — gati bërtiti Xhoni, — sigurimi shqiptar nuk fle gjumë!

— Atëherë do të hyjë në veprim faza e tretë, — tha ai që ishte në këmbë dhe u ul.

U ngrit një tjetër. Mister Xhoni e pa me vëmendje.

— Foll! — i tha.

— Në qoftë se do të dështojmë me fazën e dytë, atëherë do ta hedhim sondën në erë. Ky sabotim e shtyn realizimin e projektit shqiptar për më vonë.

— E kush do ta bëjë këtë sabotim? — pyeti mister Xhoni dhe picërroi sytë.

— Ne, — tha tjetri.

— Si? — Mister Xhoni nuk po duronte më.

— Do të dërgojmë agjentë të nënujit me pajisje speciale, të cilët do të hyjnë në ujërat territoriale të Shqipërisë.

Mister Xhoni përplasi fort duart në tryezë dhe u ngrit me vrull në këmbë.

— Ju jeni syleshë, idiotë, — thirri ai me të madhe. — Më vini këtu me projekte absurde. Nuk e dini se kufiri detar i Shqipërisë është i pakalueshëm?

Ai iu afrua fare pranë burrit që ishte ngritur në këmbë. Tjetri nuk u spraps fare.

— Ishte, — tha ai qetë, — por nuk është më. Specialistët tanë e gjetën sekretin e kësaj shpikjeje. Provat e bëra sot treguan se ne mund ta kalojmë rrjetën valore të detit.

Ai u ul në poltronë. Mister Xhoni nuk po u besonte veshëve. Po të ishte arritur kjo, atëherë çdo gjë ishte shumë e thjeshtë.

— Vërtet e gjetët?

Ai u ul në poltronë pranë të tjerëve.

— Si është ajo? — pyeti pastaj me zë të shtruar e të qetë.

Tjetri nisi të fliste pa u ngritur.

— Shqiptarët, me anë të aparaturave të vendosura në pika të caktuara të kufirit të tyre detar, lëshojnë disa valë specifike, të cilat formojnë një rrjetë të pakalueshme. Nëpër të mund të kalojnë pa u ndier vetëm peshqit, por asgjë tjetër, pavarësisht nga materiali i përdorur. Kështu, agjentët zbulohen, sepse nën ujë ata do ta kenë patjetër ndonjë material të papranueshëm, qoftë vetëm veshja. Sapo një njeri me kostum nënujor kalon, valët japin sinjale alarmi dhe shqiptarët vihen në gadishmëri.

— Po, po, — tha mister Xhoni, — këto dihen.

— Shkencëtarët tanë, — vazhdoi tjetri, — e zbuluan natyrën e këtyre valëve. Kjo rrjetë e vendosur nga shqiptarët, valët që përdoren, nuk janë aspak të panjohura për ne, por e veçanta është kjo: atyre u ra ndër mend që t'i përdorin valët në rrjetën kufitare. Tani ato mund t'i përdorim edhe ne. Gjetëm se me anën e disa bombardimeve, që krijojnë valë të kundërta nëpër rrjetë, mund të kalohet. Krijohet kështu një tunel, por kjo gjë vetëm për një kohë të shkurtër. Brenda disa minutave mund të kalojnë njerëz me çdo lloj materiali, edhe me lëndë shpërthyese.

Ai heshti. Nuk po fliste askush. Sa vite kishin që punonin shumë shtete për të kuptuar e zbuluar këtë rrjetë të shqiptarëve dhe vetëm tani ajo ishte gjetur.

— Tani ajo nuk është më e pakalueshme, —

tha mister Xhoni, por mund ta përdorim edhe ne ku të duam. Për këtë duhet t'i falënderojmë shqiptarët, — qeshi ai.

* *
* *

Donte edhe pak minuta të vinte mesnata.

«Minutat e fundit të ditës së hënë, — mendoi Kujtimi. — Pse më është bërë zakon këto ditë që të vlerësoj edhe minutat?»

Ai ngriti kokën nga aparatura dhe pa shokët. Agroni dhe Naimi po mbërthenin një detal shumë të imët në aparaturë.

— Me kujdes, — porositi Agroni. — Nuk duhet të lëvizë as të dhjetën e milimetrit.

Naimi pohoi me kokë.

— Po dal në ajër të pastër, — tha Kujtimi. — Sikur më dhemb koka.

Të tjerët nuk folën. Ai doli jashtë dhe pa qiellin. Ishte plot yje. Mori frymë thellë. Sytë i vajtën te klubi. Ishte mbyllur. Sa me kënaqësi do ta pinte një gotë birrë! Nisi të ecte kuturu nëpër kantier. U drejtua nga sonda. Prej së largu pa rojet e armatosura, që kontrollonin bregun e detit. Njëri prej tyre e vuri re dhe qëndroi në vend. Kujtimi u afrua.

— Si shkon shërbimi? — pyeti ai.

— Çdo gjë në rregull, shoku Kujtim, — u përgjigj roja.

Kujtimi hodhi sytë nga thellësia e detit. Atje nxinte çdo gjë.

— Andej, — drejtoi dorën nga thellësia, — andej hapini sytë. Nga ajo errësirë mundohen të na afrohen armiqtë.

— Duhet ruajtur edhe bregu, — tha roja. — Nga deti jemi të sigurt. Ata nuk mund ta çajnë rrjetën tonë detare.

— Ah, duhet të jemi më vigjilentë. Ata kanë mjete moderne dhe mund të afrohen. Nga bregu ruajmë ne. Thuaju edhe shokëve, më tepër kujdes në thellësi.

— Si urdhëron, shoku Kujtim, — tha roja. Te dera e laboratorit takoi Agronin dhe Naimin. Po pinin cigare.

— Si shkoi? — pyeti ai.


— Shumë në rregull, — tha Agroni.

Dukej i gëzuar. Pagjumësia nuk e shqetëson-te. Kujtimi e pa me vëmendje një copë herë.

— A flemë tani? — propozoi Naimi. — Na duhen forca për nesër.

— Po fle edhe unë në kantier, — tha Agroni. — Hoteli është larg.

Të tre u nisën drejt fjetores. Pas pak do të fillonte e marta.



E MARTË 5 KORRIK 2044

Kishte kaluar ora 24.00 e ditës së hënë dhe kishte filluar e marta. Mister Xhoni qëndronte ende në kabinetin e tij, i përkulur mbi dosjet e shumta.

— Mjaft punova. Duhet të pushoj pak, — mendoi dhe u ngrit. Mbylli kabinetin dhe iu drejtua ashensorit. Mendja po i rrinte në të njëjtin vend. Shqipëria po e shqetësonte vazhdimisht.

«Pse më qëlloi mua pikërisht ky sektor?» — mendoi me vete. Gjithnjë telashe kishte pasur me Shqipërinë. Përherë vërejtje merrte nga epro-

rët. Dështimet ishin të panumërta. I kalonin ato para syve dhe inatosej me veten.

«Këtë radhë keni për të më parë», — tha me vete dhe doli nga ashensori. Rrugët ishin plot dritë. Veturat e shumta lëviznin me shpejtësi të madhe. Duke ecur në trotuar, ai mendonte se kishte bërë mirë që nuk kishte marrë makinën. Kishte nevojë për ajër të freskët. Por në këtë qytet të madh, të zhurmshëm, ajri i freskët po-thuajse mungonte.

«Këtë radhë keni për të më parë», — tha përsëri me vete.

Kujt i drejtohej? Shefave të tij, apo shqiptarëve, të cilët po i kërcënonte që nga ai qytet i largët. Në thelb të shpirtit nuk donte t'i kërcënonte para kohe shqiptarët. E dinte nga përvoja se projektet dështonin sa herë që kishin të bënin me Shqipërinë.

«Këtë radhë keni për të më parë».

Dëgjoi anash një melodi orkestrale. Më tej ishte një klub nate. U fut brenda dhe u ul në një qoshe. Pas melodisë, orkestra mori një ritëm të shpejtë. Disa çifte u ngritën dhe nisën të kërcënin me vrull, si të çmendur. Mister Xhoni po i shihte me vëmendje. Ishin të gjithë të rinj.

«Kushedi në cilin klub është duke kërcyer Henri?» — mendoi.

Henri ishte djali i tij i vetëm. Kishte ditë pa e parë.

«16-vjeçar është, — pëshpëriti, — por tepër i shkathët».

Mister Xhoni pa edhe një herë të dehurit e shumë nëpër tryeza, ktheu me vrull gotën me

pije dhe u ngrit. E ndiente se kishte nevojë për gjumë. Mjedisi gjithë tym dhe i zhurmshëm i klubit e trullosi. Pas pak, jo më shumë se dy orë, në këtë klub do të bëhej rrëmujë, i shkoi në mend. Zakonisht kështu mbylleshin këto klube afër mëngjesit. Me rrahje, me vrasje, me dhunime. Kur kishte qenë i ri, e kishte frekuentuar më shpesh. Por tani kishte nevojë për dëfrime më të qeta.

«Le të dëfrejë rinia, — tha, — unë po shkoj të fle».

Në shtëpi, te dera, e priste e shoqja, e cila sapo e pa, vuri kujën.

— Ç'është, çfarë ka ndodhur? — pyeti i shqetësuar Xhoni.

— Henri, — thirri ajo, — Henri është zhdukur!

— Pse e prish gjakun? Do të kthehet pas disa ditësh. Nuk është hera e parë, apo jo?

— Ka vrrarë një njeri! — klithi e shoqja.

— Si?! — Xhoni u ul në poltronë i dërrmuar.

— Ka vrrarë një njeri, — vazhdoi e shoqja duke qarë. — Ka marrë revolverin tënd, ka hapur kasafortën dhe është zhdukur bashkë me dollarët.

Xhoni sikur i ra pika. Deri këtu të kishte arritur?!

— Po pse, pse? — pëshpëriti me vete.

— Fare kot, duke bërë shaka me shokët. Bënin garë kush do të qëllonte më shpejt një njeri në rrugë. E qëlloi Henri ynë!

Xhoni e mblodhi veten. Kërkonte një gotë pi-

je dhe u ngrit. Shtypi butonin e videofonit dhe priti. Në ekran doli një burrë moshatar me Xhonnin.

— Hello Smith, ti qenke sonte me shërbim?

— Po, — u përgjigj tjetri. — Pse kjo urgjencë?

— Ka ndodhur diçka me djalin tim, Henrin. Ka vrarë një njeri.

— Henri paska qenë? Sapo më njoftuan për vrasjen, — tha ai.

— Po, po, — tha Xhoni, — si rregullohet kjo punë?

— Si të them, — u përgjigj Smithi. — Është ca e vështirë!

— Dëgjo, Smith, ti e di që unë kam mundësi...

— Nuk them se nuk rregullohet, jo, — tha Smithi, — por takohemi më mirë në mëngjes. Si thua?

— Mirë, — dhe Xhoni mbylli videofonin. Gruaja po e priste me ankth.

— Mos u mërzit. Djalin s'ka për ta gjetur gjë.

— Duhet kërkuar, — tha e shoqja.

— Në mëngjes. Tani është vonë. Shtrihemi, — dhe u ngrit me përtesë.

*

* * *

Dielli kishte dalë mbi Currila dhe plazhi po fillonte të mbushej me njerëz. Ishte ngritur çadra e parë. Disa qenë hedhur edhe në ujë.

Adi dhe Gjergji zbritën në breg dhe u ulën. Pritnin me padurim Lantin. Do të zhyteshin të tre. Ai do të sillte me vete edhe dy kostume akua-langu, si të vetat, me elike dhe radio. Me ato kostume mund të rrinin edhe dy orë nën ujë. I pari e pa Adi.

— Erdhi, — tha dhe nxitoi t'i dilte përpara. Nxitoi edhe Gjergji.

Pasi u përshëndetën, nisën të visheshin.

— Deti mbrëmë ka qenë i shqetësuar, — tha Lanti.

Në sytë e tij dukej njëfarë gëzimi. Adi e pa me vëmëndje.

— Kur ka dallgë, sidomos kur bën stuhi, — vazhdoi Lanti, — për zhytësit e nënujit ka shumë të papritura. Objekte të shumta lëvizin nën det, peshq të ndryshëm i afrohen bregut. Shumë objekte arkeologjike kështu janë gjetur, pas stuhive.

Më së fundi ishin gati.

— Të zhytemi, — tha Lanti. — Unë do të jem i pari, pas meje Adi, pastaj Gjergji. Në det kërkohet rregull. Gati pushkët!

Lanti u fut i pari dhe pas tij të tjerët. Lanti mori djathtas, duke u nisur mes algave të shumta, të cilat herë-herë arrinin edhe dy metra mbi rërë. Ai hynte me guxim mes algave dhe shokët e ndiqnin nga pas.

— Kini kujdes se mos takojmë ndonjë Ble-nius, — foli Lanti në radio.

Ata duhej të zinin dy copë. Njërin ia kishin premtuar profesorit. Notuan edhe pak, duke vësh-truar algat dhe peshqit e shumtë.

— Lanti, Lanti, — u dëgjua zëri i Adit në kufje. — Shikoj diçka nga e majta, diçka të zezë.

— Afrohemi, — tha Lanti dhe u nis. Kur u afruan, u dëgjua e qeshura e Adit.

— Një shkëmb qenka! M'u duk si tjetër gjë.

Lanti u afrua edhe më. Nxori nga brezi thikën dhe filloi të gërryente në shkëmb. Thika hyri thellë në myshk. Ndeshi në gur.

— Më mirë kthehemi, — propozoi Lanti. — Ditët e tjera mund të shkojmë edhe më larg.

Lanti mori majtas dhe notoi përpara. Pas tij Adi. Sa kishte notuar disa metra, Adit i zuri syri një peshk të madh, që notonte me përtesë.

«Sikur ta qëlloj!» — mendoi dhe i drejtoi peshkën. Pas pak peshku përpëlitej në shigjetë.

Gjatë kthimit, ata notonin me shpejtësi. Megjithëse tani ishin zhvendosur shumë metra majtas, nën ujë dukej po ajo pamje, po ata peshq.

«Nesër me siguri do të futemi në një zonë tjetër», — mendoi Adi, kur papritur sytë i zunë një peshk të vogël. Iu duk si Blenius. Deshi t'i afrohej edhe më, por peshku çau shpejt dhe u largua më tej.

— Lanti, Lanti, — tha në radio, — e sheh atë peshk atje? Nuk të duket...

— Mos e ke fjalën për Bleniusin? — iu pergjigj me të shpejt Lanti.

Ai hodhi vështrimin andej nga tregonte Adi me dorë. Edhe atij i zunë sytë një peshk të vogël, që dukej sikur kishte qëndruar në vend dhe nuk lëvizte fare.

— Lanti nisi të lëvizte me shumë kujdes. Kishin notuar disa metra, kur fare papritur Gjergji thirri:

— Është Blenius, Blenius, e pashë fare mirë,
— dhe, pa marrë pëlqimin e shokëve, u nis me
shpejtësi drejt tij me pushkën ngrehur.

— Mos e qëllo! — thirri tërë ankth Lanti.

Peshku i vogël, sikur ta kishte ndier rrezikun
që e kërcënonte, çau si shigjetë përpara. Djemtë
iu vunë prapa.

— Bobo, — tha Lanti, — do të na zhduket
pas masivit të algave dhe nuk kemi për ta gjetur.

Disa metra më tutje ngrihej një masiv i errët,
i lartë, i cili edhe dy të tjerëve iu duk në fillim si
një masiv algash. Por nuk ishin të tilla. Masivi
ishte tepër i lartë, disa metra, dhe rreth e qark e
mbulonte errësira. Edhe peshku, siç duket, e
dinte se atje ishte shpëtimi i tij, ndaj notoi me
shpejtësi dhe në atë errësirë as që u pa se ku
u fut.

— Iku, — u dëgjua Lanti. — U zhduk midis al-
gave.

— Nuk më duken si alga, — tha Adi. — Më
shumë ngjan si një shkëmb i madh.

— Shkëmb është, — thirri Gjergji, që kish-
te arritur para tyre dhe po e prekte me dorë.

— Prej teje na iku, — iu shkreh Lanti Gjer-
gjit.

— Pse mo, mua ma hodhët fajin!

— Ti nxitove dhe peshku u largua prej zhur-
mës, — vazhdoi Adi.

— Epo, ai në gjumë nuk ishte, — tha Gjer-
gji, pa i bërë fare përshtypje mërzia e shokëve.
— Afrohuni, afrohuni. Këtu qenka një koloni me
pina.

Ata u afruan dhe vështruan rrëzë shkëmbit,

ku midis bimësisë së shkurtër të nëndetit, nxinin pinat e shumta. Nguleshin me fundin e tyre në rërë dhe aty qëndronin gjatë gjithë kohës. Hapnin fare pak guackën, sa për t'u futur uji brenda me planktonet, me të cilat ushqeheshin, dhe ishin tepër të vëmendshme për të mos u zhdukur nga armiqtë. Sa ndienin kërcënimin më të vogël, e mbyllnin fort guackën dhe atëherë ishte krejt e pamundur ta hapje. Mishi i tyre ishte tepër i shijshëm dhe më mirë se kushdo tjetër këtë gjë e dinte oktapodi, i cili kishte mënyrën e tij për t'i sulmuar pinat.

Adi kishte dëgjuar se oktapodët ishin armiqtë më të rrezikshëm të pinave dhe se ishte interesante ta shihje atë kur i gjuante; por asnjëherë nuk e kishte parë një skenë të tillë. Si padashur i shkuan sytë më lart, në faqe të shkëmbinjve, se mos shihje ndonjë oktapod, por nuk pa asnjë.

«Siç duket nuk e kanë zbuluar ende këtë koloni pinash», — mendoi ai.

U tregoi shokëve me pak fjalë për dinakërinë e oktapodit. Edhe ata u bënë shumë kureshtarë.

Ndoshta na qëllon ndonjëherë tjetër të ndeshemi me oktapodin në këtë vend, — tha Lanti. — Tani është mirë të dalim në breg.

— Dale, — thirri Gjergji, — marrim ca pina. Janë të bukura, në faqet e brendshme të guackës mund të bëhen vizatime të bukura.

— Lëri tani, — tha Adi, — marrim ndonjëherë tjetër.

— Ë mo dhe ju njëherë, sikur na u ftoh supa në breg. Një do ta marr patjetër.

Ai u zhyt më poshtë dhe shkuli me të dy duart, jo fare lehtësisht, një pinë të madhe.

— Oj, shiko, shiko, — u dëgjua zëri i Gjergjit. — Shkëmbi paska një dalje tjetër; duken rrezet e diellit! — Dhe, pa pritur fjalën e shokëve, u fut nën shkëmb dhe u zhduk.

Pas tij, tepër kureshtarë, u futën edhe Adi me Lantin. Ishte një tunel. Djemtë shihnin herë pas here, shumë turbullt, në faqet anësore të tij, të çara të mëdha, që kushedi ku të nxirrnin.

«Në këtë labirint ne deshëm të kapnim Ble-niusin!» — qeshi me vete Lanti. Megjithatë, ky tunel i errët nuk ishte i pabanuar. Zhurma e shkaktuar nga këta vizitorë të paftuar siç duket u kishte prishur qetësinë banorëve të errësirës, ndaj ata nisën të lëviznin të shqetësuar e të përplase-shin me trupat e akualangistëve të vegjël.

— Ua prishëm rehatin, — qeshi Adi.

— Janë peshq guri, i quajnë edhe rufio, — tha Lanti. — Këtu e gjejnë kënaqësinë e tyre, në errësirë, rrëzë gurëve, midis myshqeve të dendura.

Ndërkaq, rrethi i ndritshëm i daljes së tunelit po zgjerohëj. Matanë kishte dritë e poshtë tyre vetëm rërë. Guva të shumta e rrethonin shkëmbin nga të katër anët. Disa ishin të thella e të ngushta, disa të tjera ishin më të gjera, por nuk shkonin deri në zemër të shkëmbit, i cili dukej më shumë si një copë e madhe mali, e hedhur ashtu pa kujdes në mes të fushës. Djemtë, sikush në dëshirën e vet, ishin shpërndarë dhe po vërenin me kujdes.

— Gjergji, Lanti, — u dëgjua pas pak zëri i

Adit.. — Ejani shpejt këtu, kam gjetur një spirancë anijeje.

Ata notuan me shpejtësi dhe u gjendën pranë Adit, i cili po u tregonte një spirancë të ngulur në rërë dhe një zinxhir hekuri, që mbaronte pak metra më tutje. Pikërisht aty ku mbaronte zinxhiri, fillonte një shpellë e madhe dhe e thellë. Errësi-
ra nuk të linte të shihje brenda. Lanti preku spirancën. Provoi ta ngrinte, por ishte e pamundur. Provuam të tre së bashku , por pa sukses.

Lanti e la atë punë dhe u fut disa metra në thellësi të shpellës. Tani diçka dukej nga afër. Duke notuar me kujdes, këmba i ngeci diku. U ul shesh në rërë dhe pa se kishte ngecur në një tra të madh; pak më tej i zunë sytë një grumbull dërrasash. I preku lehtë me këmbë dhe dy prej tyre u rrëzuan sikur të ishin prej letre.

«Duhet të jenë shumë të vjetra, — mendoj Lanti dhe ndjeu një gëzim të brendshëm. — Mos kemi rënë në gjurmë të ndonjë anijeje të vjetër?» Thirri shpejt shokët dhe vazhdoi të notonte më tej, duke i prekur pjesët e ndryshme me dorë.

Nuk kishte asnjë dyshim. Ishin mbeturinat e një anijeje.

Sikur të kishin zbuluar ndonjë mrekulli, ata u sulën mbi anijen. Nuk ishte tamam një anije, por vetëm një pjesë e saj. Vetëm bashi i dukej mirë mbi rërë, pjesa tjetër ndodhej nën rërë.

— Një anije, duhet të jetë e pazbuluar! — thirri Lanti. U afrua edhe më pranë dhe me thikën e tij nisi të gërryente në dërrasë. — Këtu ka disa shkronja, — tha. — Mund të jetë shkruar emri i anijes.

Të tre nisën të gërryenin në atë vend ku tregoi Lanti. Nën myshk mundën të zbulonin vetëm një shkronjë — «Z». Shkronja të tjera nuk dukeshin.

Ajo pjesë anijeje ishte rreth pesë metra e gjatë. Në mes një gropë e thellë: me siguri do të kishte qenë hambari. Adi u shty pak më tutje, nga ana e pasme e anijes. Sytë i zunë një derë të mbërthyer mirë me një lloz të trashë. U thirri shokëve.

Provuan të hapnin llozin, por ai nuk lëvizte, se ishte i ndryshkur.

— Ta heqim me thika, — tha Gjergji.

Nisën të punonin me vrull. Kaloi ndoshta gjysmë ore, por dera nuk po hapej.

— Nuk hapet, — tha Adi. — Ndryshku mund të jetë shekullor dhe me thika nuk kemi për të bërë gjë.

— Si t'ia bëjmë? pyeti Gjergji.

— Dalim në breg dhe atje bisedojmë, — tha Lanti. — Po bëhet më shumë se një orë që jemi nën ujë. Zhytemi përsëri pasdreke.

Ata notuan drejt bregut.

* * *

Mbi platformë ndodheshin të gjithë, punëtorë dhe inxhinierë. Sonda punonte me shpejtësi dhe nxirrte kampione të ndryshme për të bërë analizat e duhura.

— Pas 30 minutave duhet të vendosim pajtjetër aparaturën me mikrovalë, — tha Naimi.

— Sigurisht, — pohoi Agroni. — Aty do të fillojë zona shpërthyesë.

Nuk e kishte mbaruar ende këtë bisedë, kur në sondë u ndie një krismë.

— Ç'ndodhi? — pyeti Agroni.

— U thye dalta! — tha një punëtor.

— Tani e gjeti?! — tha edhe Naimi me inat dhe nxori nga arka një daltë tjetër.

— Më sillni akualangun! — thirri Agroni.

Ia sollën menjëherë. Ai u vesh, rrëmbeu daltën dhe u zhyt në ujë. Doli pas pesë minutash.

— Jepi! — i thirri kryesondistit dhe nisi të zhvishej.

Sonda bëri dy rrotullime dhe përsëri u ndie një krismë e fortë.

— Ma jep mua, — tha Kujtimi.

U zhvesh dhe u zhyt me daltën tjetër në dorë. Por edhe ajo u thye. Katër dalta rresht pësuan të njëjtin fat.

Agroni shihte tepër i mërzitur copën e shkëmbit që kishte në dorë.

«Ç'të jetë ky material? — Mendoi. — Nuk na ka ndodhur të na thyhen kështu pesë dalta brenda një kohe të shkurtër! Dhe nuk kemi përparuar as dy metra!

Kujtimi që ulur pak më tej. Ishte lodhur. Tri herë kishte hyrë deri në thellësi për të montuar daltën.

— Duhet dërguar në laboratorin qendror në Tiranë, — tha Naimi.

— Po sot? — pyeti Agroni.

— Sot do të bëjmë pushim, — tha Kujtimi.
— Çfarë mund të bëjmë tjetër? Do të presim të nesërmen, pasi të na njoftojnë nga Tirana.

Komandanti i urës vigane, që lidhte të dy brigjet e Gjibraltarit, mori receptorin.

— Urdhëroni, kush më kërkon?

— Jam shefi i shërbimit, — u dëgjua një zë.

— Njëpër ngushticë duket sikur kalon një nëndetëse.

— Duket, apo kalon me të vërtetë? — pyeti komandanti.

— Aparaturat japin shenjë se diçka kaloi, — u përgjigj zëri, — por nuk shihet asgjë.

— Lidhuni me satelitin vëzhgues!

— U lidhëm. Që andej njoftohet se s'ka kaluar asnjë lloj nëndetëseje.

— Atëherë kontrolloni aparaturat se mos janë me defekt, — tha komandanti dhe uli receptorin.

Mister Xhoni vuri buzën në gaz, kur dëgjoi këtë bisedë në kufje. Ishte i sigurt që anijen e tij të nënujshme nuk mund ta zbulonte askush, as me aparaturat që kapin valë të ndryshme. As satelitet vëzhgues. Ajo nuk lëshonte asnjë valë dhe nuk e zbulonte asnjë aparat. Anija e mister Xhonit kaloi Gjibraltarin dhe u fut në Mesdhe. Pas pak do të gjendej në Adriatik.

— Çdo gjë gati? — pyeti mister Xhoni.

— Si urdhëroni! — iu përgjigj kapiteni i anijes. — Po lundrojnë drejt brigjeve të Shqipërisë.

— Qëndroni përballë qytetit të Durrësit, te pika e caktuar në hartë.

— Ai ishte i gëzuar atë mëngjes. Bashkëpunëtorët e tij e kishin bindur se ekspedita do të dilte me

sukses. Dhe nuk kishte pse të dështonte. Ishin bërë gjithë ato prova. Shqiptarët as që do të dyshonin se rrjeta e tyre ishte çarë. Kështu ata mund të hynin e të dilnin në ujërat territoriale të Shqipërisë kur të donin, ditën dhe natën.

— Këtë radhë, sonda shqiptare «SD-1» na e mori të keqen! — mendoi i kënaqur mister Xhoni.

U dëgjua sinjali. Mister Xhoni iu afrua mikrofoni.

— Po!

— Arritën në vendin e caktuar... presim urdhrat!

— Erdha:

Ai doli nga kabina e tij dhe shkoi në sallën ku ishin agjentët e përgatitur.

— Dy agjentët që do të kalojnë kufirin, — nisi të fliste kapiteni i anijes, — të futen te dhoma me presion dhe të bëhen gati. Bombardimi do të fillojë pas 10 minutash. Gjithë të tjerët nëpër vendet e tyre. Sapo të dëgjohet sinjali, të gjithë të kryejnë detyrën, pa pritur asnjë urdher. Çdo gjë do të kryhet brenda pak minutave. Kërkohet kujdes i madh. Një pakujdesi bën të dështojë i gjithë plani. Shqiptarët në asnjë mënyrë nuk duhet të marrin vesh se është çarë rrjeta e tyre. Qartë!

Askush nuk foli. Ata kishin bërë kaq prova dhe tani punonin gati si makina.

— Ju të dy, — iu drejtua mister Xhoni agjentëve, — do të kaloni me shpejtësi matanë sapo të hapet dera. Afrojuni bregut me kujdes. Detyra për sot është vëzhgimi. Do të ktheheni përsëri te ky

vend në orën e caktuar. Mbani lidhje me radio për çdo gjë. Nisuni!

U ngritën të gjithë dhe zunë vendet e tyre. Mister Xhoni dhe kapiteni shkuan në dhomën e komandimit dhe qëndruan para ekraneve për të vëzhguar. Çdo vend pune pasqyrohej aty në ekrane të veçanta. Në një ekran dukej vetëm ujë. Ishte pikërisht vendi ku do të kalonin agjentët.

«Tuneli artificial», — mendoi me vete Xhoni.


Pa orën. Po afrohej koha e caktuar. Ai u tërhoq ca në një anë dhe i la vend kapitenit që do të jepte sinjalin. Të dy po ndiqnin akrepat e orës. Kapiteni pa edhe një herë nga mister Xhoni. Ai tundi kokën. Kapiteni ngriti dorën, e mbajti pak sekonda pezull dhe pastaj shtypi një buton. Në anije u ndie një sinjal i hollë, që të shponte veshin e të ngrinte nervat. Ekranet u gjallëruan. Njerëzit filluan të lëviznin. Mister Xhoni i mbante sytë tek ekрани ku duhej të dukej «tuneli», Pas pak pa dy agjentët që notonin me shpejtësi.

Mbeteshin edhe disa metra. Ata notuan dhe u zhdukën tutje. Mister Xhoni u ul i qetësuar në poltronë. Nuk kishte ndodhur asgjë. Më së fundi rrjeta ishte çarë! Ai ndezi një puro dhe nisi ta pinte me kënaqësi. Nga mendimet e shkëputi sinjali. Agjentët ishin lidhur me radio me anijen. Mister Xhoni rrëmbeu receptorin.

— Vëzhgoni bregun me kujdes! — urdhëroi.

— Po i drejtohem! Shpellës së Peshkaqenit, — tha një nga agjentët. — Në këtë zonë nuk shohim të lëvizin akualangistë.

— Mirë. Nga ana perëndimore e shkëmbit të nënujshëm fillon shpella. Sipas skicës, në të hyrë



të saj, nga ana e majtë, ndodhet një e çarë. Pikërisht aty duhet ta vendosni kutinë me udhëzime për agjentin. Studiojeni mirë krejt vendin dhe kthehuni përsëri në bazë, — urdhëroi mister Xhoni.

— Sikur të kalonim njëherë edhe nga sonda, — kërkoi leje njëri nga agjentët.

Mister Xhoni i hipi gjaku në kokë.

— Veproni si ju thashë! Nuk keni dalë për shëtitje!

— Si urdhëron! — dëgjoi në kufje dhe mbylli receptorin.

Mister Xhoni iu kthye kapitenit:

— Kujtojnë se janë të padukshëm, meqë ndodhen nën ujë. Një hap i gabuar mund të na rrezikojë tërë planin.

— Duhet instruktuar vazhdimisht, — ndërhyri kapiteni, — dhe duhen mbajtur në fre. Secili nga njerëzit tanë digjet për ta hedhur në erë vetë sondën e të marrë kështu gjithë shpërblimin.

— S'do të ketë shpërblim të veçantë, — tha mister Xhoni. — Në qoftë se aksioni do të dalë me sukses, do të shpërblehemi të gjithë, dhe jo pak.

Të dyve iu pasqyrua një buzëqeshje në fytyrë, duke menduar shumë e majme që do të merrnin pas këtij sabotimi në Shqipëri.

Ndërkaq, në ekran ishte ndezur sinjali i kuq. Agjentët kërkonin lidhje. Mister Xhoni kërcëu tek ekrani dhe me një ndjenjë frike dhe alarmi pyeti:

— Çfarë ka?

— Asgjë, mister, — u përgjigj agjenti. — Çdo gjë në rregull, mund të kthehemi?

— Po.

Agjentët dolën nga shpella duke notuar me-

ngadalë. Rreth tyre mbretëronte qetësia. Nën ta, poshtë në rërë, midis algave dhe myshqeve të shumta nxinin pinat.

*
* *

Rreth orës 16.00, tre djemtë iu afruan muzeut arkeologjik të qytetit. Lanti u kishte treguar shokëve të tij të rinj se ky ishte një nga muzetë më të pasur të Ballkanit. Dhe kuptohej pse. Qyteti i Durrësit ishte një nga qytetet më të vjetra dhe i kishte «dhuruar» pasuri të madhe arkeologjisë. Profesor Dorian Koçiu ishte i dëgjuar për zbulimet dhe studimet e tij mbi prejardhjen e popullit shqiptar nga fiset ilire. Ai ishte ilirologu më i njohur në të gjithë botën.

Adi dhe Gjergji seç kishin një padurim të takoheshin me të sa më parë.

— A do të na presë vallë? — pyeti Adi.

— Unë e njoh, — tha Lanti. — Është shumë i dashur. Veç në është i zënë me punë!

— Vijmë përsëri nesër, — tha Gjergji.

— Jo, — ia ktheu Lanti, — po të jetë aty, do të na presë.

Ai shtypi butonin e ziles dhe dera u hap vetiu. Djemtë u ngjitën në katin e dytë dhe në derën e tretë dhathtas lexuan: «Profesor Dorian Koçiu».

Lanti i ra ziles. E hapi vetë profesori. Ishte një burrë i vjetër, pak i thinjur, rreth të shtatëdhjetave.

— Hyni, pionierë, hyni! — tha profesori me një zë të fortë, që ushtoi në korridor.

Ata u ulën përballë tryezës së profesorit. Dhoma ishte mbushur me objekte arkeologjike të gjetura nën ujë. Në të kishte shënime të ndryshme. Një bibliotekë e madhe zinte gati gjithë faqen e murit.

— Urdhëroni. Me se mund t'ju shërbej? — i përmendi ata zëri i profesorit.

— Jemi zhytës amatorë, — nisi të fliste Lanti. — Unë jam i rrethit të arkeologëve të nënujit të pallatit të pionierëve, shokët janë nga Tirana.

— Gëzohem shumë, — tha profesori, — më bëhet qejfi që ju pëlqen sporti i zhytjes.

— Kemi ardhur t'ju pyesim, profesor, për anijet e mbytura në brigjet tona në fillim të erës së re.

— Në bregun tonë janë mbytur shumë të tilla, — tha profesori.

Lanti nxori nga xhepi një copë letër, ku ishte vizatuar me kujdes një pjesë e një anijeje.

— Kjo është skica e një anijeje të vjetër. Materiali i përdorur, kalbëzimi i saj e të tjera na bëjnë të mendojmë se mund të jetë ndonjë anije romake.

— Shumë interesant, — tha profesori. — Pa ta shikojmë skicën!

— Veç kësaj, — ndërhyri Gjergji, — aty ku duhej të ishte emri i anijes, ka mbetur vetëm një shkronjë — «Z».

— Ta shikojmë, ta shikojmë, — tha me gjysmë zëri profesori dhe shtypi një buton.

— Më sillni, ju lutem, librin «Anije të mbytura në bregdetin e Durrësit».

Pas pak, një vajzë e re hyri në dhomë dhe la mbi tryezë një libër.

— Faleminderit, — tha profesori dhe nisi të shfletonte me nxitim.

— Anije të mbytura në kohën e pushtimit romak... po... anije mallrash... jo, udhëtarësh... Jo, ja tek është... objekte arti të grabitura!

Të tre pionierët u përkulën mbi libër.

— Anija «Zeta». E gjetëm! — thirri profesori.

Të gjithë u gëzuan, por gëzimi i tyre nuk zgjati. Profesori tha:

— Sipas vizatimit nuk duhet të jetë ajo. Skica qenka fare ndryshe. E keni vizatuar mirë?

— Afërsisht, — u përgjigj Gjergji.

Profesori shfletoi përsëri duke mermëritur:

— Ze... Ze... Zeus! Të shohim çfarë thotë këtu: «Anije romake, mbytur në shekullin e parë të erës sonë. Ngarkuar me objekte arti të grabitura në muzeun e qytetit Epidamnus. Mbytur për shkak të një sulmi të bërë nga ilirët në pjesën perëndimore të Currilave.»

Profesori ngriti kokën.

— Ndoshta është kjo; por duhet të vërtetohet. Do të zhyteni përsëri?

— Po, nesër paradite.

— Ejani më njoftoni për çdo gjë. Do të jem shumë i kënaqur.

— Do të vijmë patjetër, profesor.

Ata u ndanë me profesorin dhe u nisën drejt shtëpisë së Lantit. Nëna e Lantit i kishte ftuar të provonin ëmbëlsirën që përgatiste me alga e de-

tit. Ishte errësuar kur po ktheheshin në hotel. Prej së largu dalluan Agronin.

— Paska ardhur babai! — tha Adi.

Vrapuan drejt hotelit. Atje gjetën edhe Kujtimin me Naimin.

— Si po kalojnë pushimet? — i pyeti Naimi djemtë.

— Mirë, — u përgjigj Adi, — megjithëse jo ashtu si e kishim planifikuar!

— Pse? — pyetën me një zë Kujtimi dhe Naimi.

— Po ja, i kishim planifikuar t'i kalonim me babanë, — tha Adi. Ata qeshën.

— Shoku Agron, më shumë kujdes për fëmijët, — ndërhyri Kujtimi. — Ata janë e ardhmja.

— Kemi njohur një shok durrsak, — tha Gjergji, — me të zhytëmi nën ujë. E njeh bregun për mrekulli.

— Zhytëmi nën ujë? — u interesua Kujtimi, — Po mua a më pranoni?

— Posi jo, do të vini me ne?

— Patjetër, por jo këto ditë, më vonë.

— Jua kam dhënë fjalën, do të zhytem edhe unë një ditë me ju, — tha Agroni. Ata ndenjën edhe një copë herë duke biseduar për mrekullitë e nënujit. Pas pak, Naimi me Kujtimin u larguan.

— Si shkon sonda, baba? — pyeti Adi.

— Mirë, mirë, — tha si pa qejf Agroni dhe ndërroi bisedë. Djemtë i treguan për shokun e ri, Lantin.

— Kam dëshirë ta njoh edhe unë, — tha Agroni, — ta falënderoj.

— Pse? — u çuditën ata.

— Që më zëvendësoi mua pranë jush. Ndryshe do të ishit mërziur.

— Kemi zbuluar dhe një anije, — tha Gjergji.
— Është që prej 20 shekujsh.

— E zbuluat ju?

— Po, sot pasdite. Njoftuam edhe në muzeun arkeologjik.

— Duhet të mblidhni shumë fakte që të arri-
ni në një përfundim të saktë.

— Do të zhytemi përsëri, baba!

— Shumë mirë, — tha Agroni dhe nuk e zgja-
ti më. Adit i bëri përshtypje. Babai, në raste të
tjera, ishte interesuar më shumë për çdo gjë që
bënte i biri. Kurse sonte se çfarë kishte një shqet-
ësim.

«Kushedi si shkon puna në sondë!» — mendoi
Adi.

*

* *

Po afronte mesnata. Rojat në sondë lëviznin me qetësi dhe në çdo hap kontrollonin detin: ngulnin sytë në thellësi dhe mundoheshin të kapnin edhe lëvizjen më të vogël. Ata e dinin shumë mirë rëndësinë e kësaj sonde, ndaj ishin tërë vigjilencë. Pas shpinës së rojës, një hije po lëvizte me kujdes të jashtëzakonshëm. Hija iu afrua bre-
gut disa metra larg sondës dhe nisi të zhytej nën ujë. Ishte veshur me akualang. Pas disa sekondash u zhdruk plotësisht nën ujë. Rojat lëviznin menga-
dalë, pa ia ndarë sytë thellësisë.

E MËRKURË 6 KORRIK 2044

Akoma pa dalë dielli mirë, në kantier kish-te gjallëri. Drejtori kishte ardhur herët dhe po organizonte punën. I kishin thënë se të mërkurën do të vinte një ekip nga ministria për të parë provat. Analizat e laboratorit kishin përcaktuar mirë se çfarë dalje duhej përdorur për të shpuar shkëmbin e fortë nën ujë.

Drejtori kaloi nën dritaren e dhomës ku flinte Kujtimi dhe trokiti në xham.

— Zgjohu, Kujtim! Kemi kohë për të fjetur!
— i thirri ai.

Kujtimi doli në dritare.

— Tërë natën nuk kam fjetur, — tha, — më dhimbte koka dhe kisha temperaturë.

— Ashtu? — u interesua drejtori. — Po tani si je?

— Diçka më mirë. Erdha!

Në platformë ishin mbledhur shumë vetë. Kujtimi iu afrua Naimit, i cili po shihte me shumë vëmendje një projekt, dhe qëndroi aty pa folur. Nuk binte shumë në sy nga grupi i njerëzve. Agroni kishte hipur në platformë dhe po u shpjegonte diçka shokëve të ministrisë.

— Gati, djema! — foli drejtori. — Është tamam koha për të filluar.

Të gjithë u shpërndanë nëpër vendet e tyre.

— Gati dalta? — pyeti Agroni.

— Gati, — tha Naimi dhe tregoi daltën, që e kishte lëshuar te këmbët e tij.

— Kush do të zhytet? — pyeti një shok i ekipit.

— Unë, — tha Kujtimi dhe nisi të zhvishej.

— Në asnjë mënyrë. Ti, Kujtim, nuk do të zhytesh!

Ishte drejtori që e ngriti zërin i shqetësuar. Të tjerët u çuditën.

— E pse jo? — tha me habi Kujtimi.

— Ti tërë natën ke qenë me temperaturë, nuk bën.

— Ashtu, — tha Agroni, — pse nuk thua? Do të zhytem unë!

— Gjë pa rëndësi, — vazhdoi Kujtimi duke u zhveshur. — Po të trembemi edhe nga pak ethe...

— Jo, — nguli këmbë Agroni, — do të zhytem unë.

Kujtimi u tërhoq. Pas pak, Agroni ishte gati. Mori daltën në dorë dhe filloi të zhytej në ujë. Pranë platformës tani ishin mbledhur shumë vetë. Naimi ishte afruar dhe mundohej të depërtonte me vështrimin e tij në thellësi të ujit, ku nuk dukej asgjë. Pas shpinës së tij u afrua edhe Iliri.

— Shoku Naim, nuk duket gjë, — tha me shaka ai. Naimi ngriti kokën.

— Ashtu vërtet, por, nga padurimi, më dukej sikur po e shihja Agronin duke montuar daltën.

— A janë të sakta analizat? — pyeti Iliri.

— Shumë të sakta. Laboratori qendror në Tiranë s'ka gabuar kurrë.

— Atëherë edhe kjo pengesë do të kalohet sot, — tha Iliri.

— Kështu mendoj edhe unë, — ia ktheu Naimi. — Pas disa minutash çdo gjë do të shkojë normalisht.

Ata heshtën kur mbi ujë dolën flluskat e para me oksigjen. Agroni po dilte në sipërfaqe. Shokët e ndihmuan të hiqte akualangun.

— Merre, — i tha Kujtimin, — është akualangut yt. Punon shumë mirë.

Kujtimi vuri buzën në gaz. Agroni u shty pak më tutje dhe i bëri shenjë me dorë kryesondistit. Ky shtypi butonin dhe sonda zuri të lëvizte. Në fillim ngadalë, por pastaj nisi të rrotullohej me vrull. Të gjithë mezi pritnin që dalta të përparonte, por s'kaloi shumë e u dëgjua një krismë dhe

sonda nisi të rrotullohej bosh. Të gjithë shtangën.

— U thye? — thiri me të madhe Agroni.

— Jo, — u përgjigj kryesohdisti. — Është këputur dalta me gjithë korpus.

— Si ka mundësi? — pyeti Kujtimi. — Kjo nuk mund të ndodhë.

Askush nuk po fliste. Kujtimi iu kthye Agronit dhe e pa një copë herë me një vështrim gati armiqësor. Sytë e tij të gjelbër kishin marrë një shkëlqim të lig.

— E montove mirë? — pyeti me zë pak të trashë. — E montove ashtu si duhet?

Agroni u hutua. Pa nga të tjerët. Edhe ata po e shikonin me njëfarë dyshimi.

— E pse duhet të dyshohet për montimin? — tha pas pak me gjysmë zëri.

— Sepse mund ta kesh lënë të lirë dhe kështu ke thyer korpusin, — u nxeh Kujtimi. — Ja ç'na bëre! Një daltë e tillë do tri ditë të bëhet përsëri.

Agroni ndjeu t'i kërcente gjaku në fytyrë. Por nuk bëri asnjë lëvizje. Vetëm foli me zë të ulët:

— E montova shumë mirë. Defektin nuk di ta shpjegoj.

— Pas kësaj që ndodhi, nuk mund ta marrim vesh në e montove mirë, apo jo, — i tha Kujtimi. — Po ç'rëndësi ka. Tani duhet të mendojmë si t'ia bëjmë.

Mbi platformë ra një heshtje e rëndë. Dëgjoheshin vetëm valëzat e ujit, që përhapeshin lehtë në shtyllat e platformës. Iliri, pak më tutje, ua kishte ngulur sytë dy inxhinierëve.

Pas pak, në zyrën e drejtorit ishin mbledhur

shokët e ministrisë dhe këshilli teknik i ndërmarrjes. Drejtori rrinte në këmbë.

— Prova tjetër mund të bëhet vetëm pas dy ditësh, — tha i ngrysur.

— Mund të bëhet edhe nesër pasdite, — foli një nga shokët e ministrisë.

— E pamundur, nuk kemi daltë tjetër. —

— Shokët e uzinës do të punojnë edhe natën, vetëm të bëhet dalta, të jesh i sigurt, — tha përsëri shoku nga Tirana..

*

*

*

Derisa të vinte dalta tjetër, sonda do të qëndronte ashtu, e heshtur, si e lënë mënjanë. Agroni deshi të futej përsëri në ujë, ta shihte me sytë e tij korpusin e këputur, po drejtori e kishte dërguar bashkë me Kujtimin në sondën detare Nr. 2 për të ndihmuar atje.

Me sytë të ngulur te sonda, drejtori, që nga dritarja e zyrës së tij, dukej tepër i shqetësuar. Ai, një naftëtar i vjetër, që tërë jetën e kishte kaluar nëpër pusë naftë, tani kishte merak se nuk do ta mbante fjalën e dhënë. E kishte shtruar për diskutim në kolektiv detyrën që u ishte ngarkuar, dhe atje, duke dëgjuar mendimet e guximshme të punëtorëve, kishte premtuar se çdo gjë do të kryhej në kohën e caktuar.

«Kurse tani... a kam unë sy e faqe të justifikohem...»

U hap dera dhe në zyrë u fut Iliri.

— Erdhe? — tha drejtori. — Tani duhet të vijë edhe Naimi.

Atë çast, në derë u duk Naimi. Ata të tre u ulën.

— Ngjarja e sotme ishte e rëndë, — tha Iliri. — Më duhet të vërtetoj diçka.

— Çfarë? — u tregua i gatshëm drejtori.

— Më duhet patjetër ndihma e shokut Naim!

— Imja?! — tha Naimi. — Urdhëro, fol!

— Ju, shoku Naim, jeni punëtor, komunist i vjetër. Ne të tre mund të bisedojmë hapur. Si specialist mund të më ndihmoni të vërtetoj se çfarë ndodhi sot, ishte një defekt, apo...

— Apo... — Drejtori ishte ngritur në këmbë.

— Le të mos flasim për dyshimet, — tha Iliri.

— Pasi të zhytem në sondë bashkë me shokun Naim, do të flasim përsëri.

Dy të tjerët shtangën.

— Shkojmë, — tha Naimi dhe u ngrit në këmbë.

— Dale, ti e ke të ndaluar nga mjeku, — ia ktheu drejtori.

— E kam të ndaluar të zhytem shpesh, por një herë... dhe në një rast si ky!...

Ai i futi krahun Ilirit dhe shkuan të merrnin akualanget. Drejtori nxitoi te sonda. Pas pak erdhën edhe ata. Drejtori, tepër i shqetësuar, bënte ecejake nëpër platformë.

Dy të tjerët u zhdukën nën ujë. Naimi notoi përpara.

— Këtu duhet parë, këtu, — i tha Iliri Naimit, kur arritën te korpusi.

Naimi u afrua edhe më. Poshtë tij kishte vetëm

baltë. I nguli sytë aty ku duhej të ishte dalta. Në çast, nga habia, iu zmadhuan sytë. Nuk po i besonte vetes. Filloi ta prekte vendin me dorë dhe menjëherë u kthye me vrull nga Iliri e foli me një zë tepër të shqetësuar:

— Nuk është thyerje!

— Po çfarë? — pyeti me nxitim Iliri.

— Prerje, e kanë prerë!

Iliri e kapi për krahu.

— A je i sigurt?

Naimi e preku edhe një herë vendin e tha me vendosmëri:

— S'kam asnjë dyshim. Dikush e ka prerë korpusin deri afër fundit. Në rrotullimin e parë është thyer lehtësisht.

Iliri hodhi sytë poshtë këmbëve të tij, te balta.

— Atje nuk mund të gjendet asgjë, balta është disa metra e thellë, — tha Naimi.

— Dalim, — tha Iliri dhe nisi të notonte.

Në platformë i priste drejtori.

— Hë, — pyeti ai me padurim, — e gjetët daltën?

— As që është nevoja, — tha Naimi dhe i tregoi për prerjen.

— Kush ka leje të zhytet, veç Agronit dhe Kujtimit? — pyeti Iliri.

— Askush tjetër, — u përgjigj drejtori pasi i kaloi hutimi i parë.

Ata heshtën një copë herë.

— Falemnderit, shoku Naim, — tha Iliri, — unë po shkoj. Ky fakt tani për tani përbën sekret.

Drejtori bëri një lëvizje me dorë sikur desh

të thoshte «As që duhet të na kujtosh për këtë gjë».

Iliri përshkoi i menduar tërë territorin e kantierit dhe po bëhej gati të dilte në rrugë, kur dëgjoi pas vetes një zë:

— Shoku Ilir!

Ishte një sondist i vjetër. Iliri e njihte si një nga punëtorët më të dalluar të kantierit.

— Urdhëro! — i tha Iliri dhe i zgjati dorën.

— Më falni, po dua t'ju them diçka. Jam i bindur se korpusi nuk është thyer. Zhurmat nuk mund të më ngatërrohen lehtë mua. Veshi im më thotë se dalta dhe korpusi u shkëputën shumë lehtë. Ndoshta është bërë ndonjë gjë me qëllim.

Iliri e pa me vëmendje.

— Veç kësaj, — vazhdoi sondisti, — akualangu i Agronit u gjend i lagur.

— Kjo kuptohet, — tha Iliri, — ai u zhyt para pak kohësh nën ujë!

— Sot ai u zhyt me akualangun e Kujtimit, — nguli këmbë sondisti.

— Ashtu! — u çudit Iliri. — Falemnderit për këtë që më the!

Naftëtari u largua dhe Iliri e ndoqi një copë herë me sy.

*

* * *

Ndërsa në sondë shqetësimi kishte arritur kulmin, në breg të Currilave kishte gjallëri të madhe. Jo më shumë se dhjetë minuta më parë, nga bre-

gu i Currilave ishin zhytur nën ujë dhe ishin zhdukur drejt thellësisë tre akualangistë të rinj. Ishin tre heronjtë tanë, të cilët këtë radhë ishin pajisur me të gjitha mjetet e duhura. Adi kishte biseduar me të atin dhe kishte siguruar një solucion për heqjen e ndryshkut nën ujë. Kishin marrë me vete dhe një levë të vogël e një litar. Kushedi, mund t'u hynin në punë.

Në krye notonte Lanti, i cili orientohej shumë mirë me busullën e vogël të dorës. Nuk u interesonte atë ditë asnjë nga bukuritë e detit, as peshqit e shumtë. Madje nuk kishin marrë me vete as pushkët.

Shkëmbi u duk si një hije prej së largu. Djemtë notuan më fort dhe iu afruan me shpejtësi.

Me thikat e tyre nisën të gërryenin me kujdes vendin pas shkronjës «Z». Jo fill pas saj, por pak më tutje nisën të dukeshin gjurmët e një shkronje. Më tepër ishte një njollë.

— Më ngjan si «U», — tha Gjergji.

— Po tamam, U është, — pohoi Lanti. — Më duket se kemi të bëjmë pikërisht me anijen «Zeus».

— Shikojmë më tej, më tej, — tha Adi. — Duhet të jetë shkronja «S».

Shkronja tjetër nuk ngjante si «S». Ishin gjurmë shumë të zbehta. Por të kthyerat lart dhe poshtë ta jepnin përshtypjen se ishte vërtet shkronja që kërkonin.

— Ajo është, nuk ka asnjë dyshim, — nguli këmbë Adi. — Është tamam «Zeusi».

— Po, po, «Zeusi» është, — tha edhe Lanti. — Të shikojmë te dera. Solucioni që kemi me vete duhet të tregojë tani aftësinë e tij.

Ata notuan nga ana ku ndodhej dera e mbyllur.

*
* *
*

Ndërsa djemtë po i afroheshin derës, përballë qytetit të Durrësit, tutje ujërave territoriale të Shqipërisë, qëndroi anija e mister Xhonit. Pikërisht në atë vend ku u hap një ditë më parë edhe tuneli artificial, siç e quajti ai. Në kabinën e tij ndodheshin kapiteni dhe dy agjentët që do të çanin përsëri rrjetën valore.

Mister Xhoni i pa një copë herë me vëmendje të tjerët dhe tha:

— Agjenti ynë «SD-1» në Shqipëri e di mirë si duhet të veprojë. Ai tashmë, pas një heshtjeje prej disa vitesh, filloi veprimtarinë e tij. Gjithë këto vite ka ndenjur në pritje dhe është përpjekur të fitojë besimin e shefave të tij në punë. Ne e kemi ruajtur atë vetëm për këtë ditë, kur të paraqitej nevoja për një aksion me rëndësi tepër të madhe. Dhe koha erdhi. Agjenti ynë punon në kantierin e sondës detare «SD-1». Çarja e rrjetës valore të shqiptarëve ishte një fat i madh për ne, ndryshe, agjenti do të vepronte fare vetëm. Tani kemi mundësi t'i dërgojmë për ndihmë agjentë të tjerë, sidomos kur të vijë momenti i duhur. Ai, sipas udhëzimeve të dërguara shumë kohë më parë, e di se për ndërlikime do të përdoren disa pika të caktuara. Njëra prej tyre do të jetë Shpella e Peshkagenit. Në atë shpellë të nënujshme do t'i lëmë udhëzimet. Qartë!

Kapiteni u ngrit e dha në mikrofon urdhrin:

— Gati për çarjen e rrjetës, të gjithë nëpër vende!

Mister Xhoni iu afrua ekranit, ku pasqyrohej zona ku do të kalonin të dy agjentët. Megjithëse një ditë më parë rrjeta ishte çarë me sukses, ai përsëri kishte frikë se mos shqiptarët kishin nuhatur gjë dhe kishin ndërruar natyrën e valëve. U dëgjua sinjali dhe pas disa çasteve dy agjentët u dukën të notonin drej ujërave të Shqipërisë. Mister Xhoni ndjeu t'i rrihte zemra me forcë. Ata kaluan dhe ai mori frymë i lehtësuar.

— Mbani lidhje me radio, — urdhëroi mister Xhoni në mikrofoni dhe u ul. Nisi të dremiste. Një natë më parë nuk kishte fjetur mirë. Henri po e shqetësonte shumë prej kohësh. Që kur kishte bërë vrasjen, të cilën mister Xhoni e kishte mbyllur pas shumë ndërhyrjeve dhe pasi kishte harxhuar një shumë të mirë dollarësh, Henri nuk ishte dukur në shtëpi. Bile nuk kishte asnjë lajm prej tij.

«Mos ndoshta e kanë vrarë edhe atë!» — mendonte ai dhe i dridhej i tërë trupi. Ishte djali i tij i vetëm dhe nuk donte në asnjë mënyrë të përfundonte kështu kjo çështje. Kishte pyetur kudo, në të gjitha rajonet e policisë së shtetit, por asnjë përgjigje. Mbetej vetëm një mundësi: ndoshta ai ishte larguar me ndonjë grup gangsterësh, narkomanësh dhe bridhte fushave e maleve si dikur njerëzit e egër.

*

*

*

Adin, Lantin dhe Gjergjin i kishte përpirë puna për hapjen e derës së kabinës.

Adi nxori nga një qese që e mbante lidhur në

brez, një shishe të vogël dhe ia dha shokut. Lanti e mori dhe e afroi të mbyllur te llozi i derës. Do ta haptë grykën e shishes pikërisht mbi të, që solucioni të mos shpërndahej në ujë. Një lëng i trashë u shtri mbi lloz. Atëherë të tre nisën ta shtrijnë me duar nëpër të gjithë llozin. Lanti e kapi llozin dhe filloi ta rrotullonte. Gjergji mbështeti në të levën dhe nisi ta shtynte.

— Po lëviz, më duket, — tha Lanti. — Jepi më fort!

Ata i dhanë me të gjitha forcat dhe më në fund llozi u lirua. E tërhoqën pak dhe dera u hap. Të tre u futën njëherësh në kabinë. Kudo errësirë. Me vete nuk kishin as elektrik dore. Drita e dëllit nuk depërtonte brenda në kabinë, kështu që ata nuk vunë re asgjë.

— U pa puna, duhet të vijmë pasdite, — tha Adi. — Pa elektrik dore nuk mund të shohim asgjë këtu.

— Po, ke të drejtë, — tha Lanti, — vijmë pasdite. Gjergj, lëre levën brenda në kabinë; ndoshta mund të na duhet pasdite.

Gjergji e lëshoi levën në të hyrë të kabinës. Ata e mbyllën me kujdes derën dhe i vunë llozin.

*

* *

Ata e kishin lënë të takoheshin pas buke. Në orën 14.00 ishte koha që në plazh nuk qarkullonin shumë veta dhe nuk do t'i shqetësonte kush. Kishin

filluar t'i bezdisnin shumë fëmijët e vegjël, të cilët, sapo shihnin se tre djemtë bëheshin gati të zhyteshin, afroheshin e bënin rrëmujë. Le që as të dilte koha t'u përgjigjeshe të gjitha pyetjeve të tyre! Disa kërkonin të vinin me ta nën ujë!

Adi me Gjergjin kishin ngrënë drekë dhe po qëndronin në holl të hotelit për të pushuar pak derisa të vinte Lanti. U hap dera dhe në holl u duk inxhinier Kujtimi.

— Shoku Kujtim, — tha Adi dhe u ngrit në këmbë, — nuk erdhi babai?

— Oho, — qeshi Kujtimi, — miqtë e mi të vegjël, si jeni? Babai nuk do të vijë. Më tha t'ju porosit që pasdite të shkoni tek ai në sondë. Ju fton për vizitë.

— Ç'mrekulli! — Djemtë u hodhën përpjetë nga gëzimi.

— Po ju? — pyeti Adi. — Tani erdhët?

— Ka pak kohë. Isha ca i lodhur dhe vendosa të bëj pushim.

— Sa keq! — tha Gjergji. — Mund të vinit me ne!

— Ku kështu? — pyeti i çuditur Kujtimi.

— Do të zhytemi. Kemi zbuluar një anije të mbytur, — tha Adi.

— Sa mirë, sa mirë, po ju nuk e dini se unë prandaj kam ardhur këtu. Kisha në plan të zhytesha për gjueti, sepse zhytja më heq lodhjen. Po vij me ju.

Kujtimi u ul pranë tyre dhe nisi t'u tregonte shumë gjëra interesante nga fundi i detit.

Lanti nuk vonoi të vinte. Pas pak, të katër ishin gati për t'u zhytur.

— Futi pra, Lanti, — tha Kujtimi, — unë sot do të jem nën komandën tuaj. Po zhytem vetëm për shplodhje. Kam edhe unë kureshtje të shoh anijen tuaj.

— Ta paskan treguar! — tha Lanti. — Mirë pra, unë do të jem i pari, pastaj me radhë, Adi me Gjergjin dhe në fund shoku Kujtim. Na ruani krahët! — qeshi Lanti.

— Si urdhëron, shoku komandant! — tha Kujtimi.

Ata u zhdukën nën ujë. Lanti notonte me shpejtësi përpara.

— E dini me saktësi drejtimin? — pyeti në radio Kujtimi.

— Po, po, — tha Lanti e dha koordinatat.

Kujtimi pa sahatin. Nuk ishte sahat, por busull që përdoret në ujë. Në tokë vlen si sahat. Adi ktheu kokën dhe qëndroi pak. I kapi dorën dhe vështroi me zili busullën e tij.

— Mirë e ke drejtimin, — tha Kujtimi, pasi vështroi një copë herë akrepat e busullës. — Vazhdo po ashtu.

U ndodhën shpejt pranë anijes. Djemtë i treguan Kujtimit vendin ku ishte shkruar emri i anijes.

— Shikoni gjurmët, — tha Adi. — Nuk duhet të jetë pikërisht «Zeusi»?

Djemtë vazhduan të gërryenin përsëri aty. Donin që të dukej sa më qartë emri i anijes. Kujtimi notoi më tej për të parë më me imtësi anijen. Pas pak foli në radio:

— Djema, këtu është një derë, afrohuni.

— Po, po, e dimë, — tha Lanti dhe u afrua te kabina.

Atë çast Kujtimi po dilte prej saj.

— Ta shikojmë brenda, — tha Adi, — prandaj kemi marrë edhe elektrikët e dorës.

— Nuk kishte asgjë interesante, — tha Kujtimi. — Unë po shoh andej nga hambari.

Djemtë u futën në kabinë dhe me elektrikët e dorës kontrolluan çdo qoshe. Aty nuk kishte asnjë objekt. Pas pak dolën jashtë të mërzitur. Pritnin të gjenin ndonjë gjë të rrallë në kabinë. Kur dolën, panë të afrohej pranë tyre Kujtimi me diçka në dorë.

— Çfarë është kjo? — pyeti Adi me kureshtje.

— Një amforë, e gjeta në hambar. Është pak e thyer, por mund të vlejë.

Djemtë e rrethuan dhe nisën ta vështronin me vëmëndje.

— Do ta shohim mirë kur të dalim në breg, — tha Kujtimi. — Shkojmë tani.

— Mirë, — pranoi Lanti. — Përsëri do të notojmë sipas radhës së caktuar.

Amforën e mbajti Kujtimi, se ishte e rëndë. Ajo ishte rënduar edhe nga guacka të shumta që kishin veshur anët e jashtme të saj.

Sapo bënë metrat e parë, u dëgjua thirrja e Gjergjit:

— Daleni, daleni, diçka pashë!

— Çfarë, çfarë pe? — pyeti i alarmuar Kujtimi.

— Më duket se pashë një Blenius, — tha Gjergji.

— Ku e pe, nga shkoi? — Lanti pyeti me shumë padurim.

Kujtimi mori frymë i lehtësuar.

— U fut në atë algen atje, — dhe Gjergji tregoi me dorë.

— Mos lëvizni! — tha Lanti. — Po afrohem unë.

Ai nxori nga brezi një qese të madhe plastmasi dhe iu afrua algave. Notonte me shumë kujdes, tamam si gjahtari kur kërkon gjahun. Lanti u zhduk pas pak midis algave. Të tjerët nuk po lëviznin fare.

— E kapa, e kapa!

Adi dhe Gjergji notuan me shpejtësi andej nga ishte zhdukur Lanti. Pas tyre shkoi edhe Kujtimi.

— Ndonjë gjë e rrallë? — pyeti Kujtimi.

— Shumë e rrallë. Këtë peshk për herë të parë do ta kemi të gjallë në muze.

— Mirë, tani, djema, dalim, — tha Kujtimi.

— Nuk dua të vonohem në punë.

Ata filluan të notonin. Herë pas here Adi dhe Gjergji i afroreshin Lantit dhe, pasi i merrnin qesen nga dora, e vështronin me një dashuri të jashtëzakonshme Bleniusin.

Kur dolën në breg, u zhveshën dhe u shtrinë në rërë për t'u ngrohur. Bleniusin, brenda në qese, e mbante Lanti, i cili i shihte tamam si një shkencëtar.

— Shoku Kujtim, — iu drejtua Adi. — Ku e

keni marrë këtë busull? Qenka e mrekullueshme!

— Ma ka dhuruar një shok, — iu përgjigj Kujtimi. — Nuk është vetëm busull, por tregon edhe kohën.

Djemtë e morën me radhë në dorë dhe e panë me shumë kureshtje. Nuk kishin parë ndonjëherë një të tillë. Gati të gjitha ngjyrat e ylberit gjendeshin në fushën e saj. Kujtimi e vendosi përsëri në dorë dhe u ngrit.

— Më falni mua, — tha. — U kënaqa shumë sot. Ndonjëherë tjetër do të zhytem përsëri me ju. Mirupafshim!

Djemtë qëndruan edhe një copë herë.

— Duhet dërguar amfora në muzeun arkeologjik dhe Bleniusi te profesori ihtiolog.

Lanti u ngrit.

— Do të vijmë edhe ne në qytet, — tha Adi, — do të shkojmë në kantier; na ka ftuar babai për të parë sondën. Mund të vish edhe ti, Lanti.

— Kam shumë dëshirë, — u gëzua Lanti.

Në muzeun arkeologjik nuk e gjetën profesor Dorian Koçiun. Amforën dhe një copë letër të shkruar shpejt e shpejt ia lanë nëpunësit të rojes. Të nesërmen do të gjenin mundësi ta takonin vetë profesorin. Donin të bisedonin më shumë me të. Kishin shumë gjëra për të pyetur.

Në qëndrën shkencore të peshkimit u thanë të pritnin sa të njoftohej profesori. Djemtë qëndruan në korridor dhe pritën.

Më së fundi dera u hap dhe që andej doli profesori.

Lanti nuk duroi, por i zgjati qesen profesori.

rit. Ai e rrëmbeu. Zuri ta shihte me vëmëndje.

— Po, po, tamam Blenius. Sa i mrekullueshëm! Djema, më gëzuat shumë, — dhe e rrotullonte qesen nga të gjitha anët. — Megjithëse ka dy sy, i thonë Blenius me katër sy. Ky qe keni sjellë ju quhet Blenius galeatica; është shumë dembel. E lë veten të ngrihet nga dallgët. Nuk e keni parë kur del në tokë e ushqehet!

— Del në tokë? — u çuditën fëmijët.

— Posi, ushqehet me kafshë shumë të vogla që sjellin dallgët nëpër shkëmbinj, pastaj, fare pa u përpjekur, pret të vijë dallga tjetër dhe futet përsëri në ujë me të. Ju thashë, është shumë dembel. Në ishujt Galapagos jeton një tjetër Blenius; edhe atij i thonë me katër sy, megjithëse ka vetëm dy. Ai kalon në tokë gati gjysmën e kohës, bile ngjitet edhe mbi shkëmbinj e hidhet pastaj që andej, kur sheh ndonjë rrezik.

Djemtë po e dëgjonin me vëmëndje profesorin.

— Do të ma lini mua? — pyeti pas pak profesori dhe e pa Lantin drejt e në sy.

— Sigurisht, ndaj kemi ardhur.

— Shumë faleminderit! Nuk do ta harroj kurrë këtë nder!

— Profesor, — tha Lanti, — mund të na vini javën tjetër në pallatin e pionierit? Ne do t'ju dëgjonim me kënaqësi, kur të na flisnit për Bleniusin dhe peshqit e tjerë të Adriatikut:

— Posi, patjetër.

Profesori i përcolli djemtë deri te dera dhe, kur u ndanë, i falënderoi përsëri.

*

* *

Agroni pa orën e dorës. Donte edhe disa minuta të shkante 18.00.

«Tani duhet të vijmë», — tha me vete.

U ngrit, mbylli dosjet dhe doli nga zyra. Jashtë ishte më freskët se brenda. I pëlqenin shumë pasditet e verës. Dielli sapo merrte të fshihej pas malit dhe hija mbulonte krejt zonën. Atëherë Agroni donte të ulej diku, mbi ndonjë gur ose trung, dhe të vështronte detin, zakonisht të qetë në atë orë.

Te sonda nuk kishte njeri. Iu kujtua se të nesërmen do të vinte dalta e re dhe sonda do të gjallërohej. Dalta e këputur në mëngjes nuk i hiqej nga mendja. Ai e mbante mend fort mirë të gjithë zhytjen në mëngjes. Pas montimit, e provoi me kujdes se mos lëvizte dalta. Ishte i bindur se e kishte montuar mirë. Megjithatë, ajo ishte thyer bashkë me korpusin. Nuk mund ta merrte me mend se ç'kishte ndodhur nën ujë, kur kishte filluar të rrotullohej sonda.

«Megjithëse nuk lejohet, nesër do të qëndrojë nën ujë, pranë daltës, kur të vihet në punë sonda, — mendoi. — Po qe se do të ketë defekt përsëri, atëherë nuk kam sy e faqe të dal para shokëve dhe para ministrit që do të vijë për inaugurimin».

Agroni as që e pa një punëtor që qëndroi para tij.

— Shoku Agron, ju kërkoni te porta, — tha ai. Agroni ngriti kokën, pa orën. Ishte plot 18.00.

Iu kujtua se do të kishte ardhur Adi me Gjergjin.

Prej së largu pa bashkë me të dy djemtë edhe një tjetër.

«Me siguri do të jetë Lanti», — mendoi.

U njoh me Lantin dhe i mori të tre me vete. Në fillim vizituan sondën. U ngjitën në platformë dhe e panë me shumë vëmëndje. Bënin pyetje të shumta dhe Agroni nuk kishte kohë t'u përgjigjej të gjithave.

— Ju doni të dini gjithçka sikur nesër do të punoni në sondë, — qeshi Agroni. — Do t'i mësoni, në qoftë se ndonjëri prej jush do të bëhet inxhinier naftë.

— Ku ta dish, — tha Lanti. — Megjithëse mua do të më pëlqente të studioja më tepër historinë ose edhe zoologjinë.

Pastaj ata u futën në laborator, ku ishte ndër-tuar sonda në miniaturë. Mbi tryezë ndodheshin disa dosje dhe mbi të gjitha shkruhej «SD-1».

— Babi, ç'është «SD-1»? — pyeti Adi.

— Sonda pra, — tha Agroni. — Sonda detare Nr. 1.

— Po ditën e inaugurimit, do të na lejojnë të vijmë? — pyeti Gjergji.

— Besoj se po. Ditën e inaugurimit këtu mund të vijmë shumë njerëz nga qyteti. Si në çdo inaugurim, si në çdo festë.

Kur dolën nga kantieri, ishte ngrysur. Ata hipën në veturën që drejtonte Agroni, dhe u nisën për në qytet.

Në Currila ishin ndezur të gjitha dritat dhe dukej aq bukur. Ata u ngjitën lart, në pistë, dhe

kërkuan ndonjë tryezë të lirë, por ishin të gjitha të zëna.

— Agron, Agron, — u dëgjua një zë nga mesi i pistës.

Agroni u zgjat dhe pa në një tryezë Ilirin dhe Anën.

Ata shkuan atje dhe pas pak të gjashtë ishin ulur pak shtrënguar rreth tryezës.

Ana ishte shumë e qeshur dhe u mundua që djemtë të kënaqeshin sa më shumë. Iliri ishte përkulur pak dhe diçka po bisedonte me Agronin, i cili ishte bërë serioz në fytyrë dhe po dëgjonte shumë i përqendruar.

— Mos u mërzit, — tha Iliri. — Nesër të jesh i sigurt për suksesin.

— Vetëm nesër mund të flas, pas provës.

— Dëgjomë mua. Nuk ka asnjë dyshim. Ajo që ndodhi sot nuk do të ndodhë më. Djemtë si po i kalojnë pushimet? — pyeti pas pak me zë të lartë.

Ana dhe tre djemtë, që po bisedonin për muzeun zoologjik të pallatit të pionierëve, kthyen kokat kur dëgjuan këtë pyetje.

— Pyeti vetë, — i tha Agroni. — Duken të kënaqur. Për këtë duhet të falënderojnë Lantin. Ndoshta do të ishin mërzitur pa një shoqëruar. Unë u premtova, por nuk e plotësova këtë detyrë.

— Shoku Ilir, po e kalojmë shumë mirë, — tha Adi. — Lanti e njeh fundin e detit për mrekulli.

— Zhyteni nën ujë, — pyeti Iliri i interesuar, — dhe nuk keni frikë?

— E pse të kemi frikë? — u çudit Gjergji.
— Kush do të na trembë, peshqit?

— Në det nuk ka vetëm peshq, — tha si i menduar Iliri.

— E ç'mund të ketë tjetër? — pyeti Lanti. — Peshq dhe anije të mbytura.

— U afroheni anijeve të mbytura? — pyeti me kureshtje Ana. — Sa dëshirë kam të zhytem një herë e të shoh si duken ato nën ujë! Kur lundrojnë mbi ujë më duken madhështore.

— Po të doni, ejani me ne, — tha Gjergji. — Do të kënaqeni vërtet. Tek anija jonë mund të gjeni edhe ndonjë objekt të bukur arkeologjik. Sot shoku Kujtim gjeti një amforë të mrekullueshme.

— Kush? — pyeti Iliri me nxitim.

Pyetja i kishte dalë si padashur. Agroni e pa me çudi, por fëmijët nuk vunë re gjë.

— Shoku Kujtim, — tha Adi, — u zhyt sot me ne. Erdhi deri tek anija e mbytur. Dhe ishte një notar i mrekullueshëm. Dukej si akualangist profesionist.

— Në ç'orë u zhytët? — pyeti Iliri.

— Pasdreke, rreth orës 14.00.

— Sa kohë qëndruat nën ujë?

— Rreth dy orë.

Iliri e vuri re se djemtë po çuditeshin nga pyetjet e tij ndaj shtoi:

— Dhe për dy orë zbuluat vetëm një amforë!
— tha pastaj me buzë në gaz.

— Amfora nuk ishte gjë përpara Bleniusit me katër sy, — vazhdoi Lanti.

— Çfarë, çfarë? Blenius me katër sy?! — pyeti e çuditur Ana. — E ku ka peshk me katër sy?

— Kështu i thonë, — ndërhyri Gjergji, — por dy sy ka si gjithë të tjerët. Është nga peshqit më të rrallë të Adriatikut. Ia dhuruam profesorit ihtiolog të laboratorit qendror të peshkimit.

— Mirë keni bërë, — tha Agroni. — I duhet për studim.

Iliri nuk po fliste fare. Ana vazhdonte pyetjet për peshkun e rrallë dhe djemtë nuk përtonin t'i përgjigjeshin.

Iliri u përkul nga Agroni dhe i pëshpëriti:

— Kujtimi sot ka qenë me temperaturë, apo jo?

— Posi, ndaj dhe nuk e lamë të zhytet në mëngjes.

— Megjithatë qenka zhytur plot dy orë me fëmijët pasdreke.

Agroni ngriti supet.

Djemtë hëngrën darkë, morën edhe nga një akulllore dhe po rrinin pak si të lodhur. Si qëndruan edhe ca, u ngritën.

— Do të zhyteni përsëri nesër? — pyeti përsëri Iliri.

— Posi, mund të zhytemi edhe dy herë. Duhet të gjejmë edhe objekte të tjera arkeologjike, — tha Gjergji.

— Ashtu, — tha Iliri, — keni të drejtë. Nga gjërat e vogla shpesh dalin zbulime të mëdha. Po çfarë armësh merrni me vete? — pyeti ai.

— Pushkë pneumatike për të vrrarë ndonjë peshk, — iu përgjigj Lanti.

— Shumë mirë, ato ju duhen. Po pllaka mbrojtëse nuk merrni?

— Çfarë pllakash? — u interesua Adi.

— Janë disa pllaka të vogla që montohen në akualang, — sqaroi Iliri. — Ato kanë veti të kthejnë prapa çdo goditje, qoftë edhe me armë me lazer.

— E ç'na duhen neve? Ne nuk përdorim armë me lazer.

— I përdorin të tjerët, — tha Iliri, — të mriturit. Gabimisht mund të ndodhë ndonjë aksident, ndaj nesër në mëngjes ti, Lanti, eja nga zyra imë. Kam unë të tilla pllaka.

— Mirë.

Kur mbetën vetëm, Ana i tha Ilirit:

— Pse i Trembe fëmijët? Çfarë e keqe mund t'i gjejë ata?

— Asgjë, asgjë, — tha Iliri. — Po nuk është keq të jenë më të kujdesshëm. Nëndet është dhe ku ta dish çfarë ndodh. Se mos janë mbi tokë!

Ana tundi kokën pa kuptuar asgjë.

* * *

Në kabinetin e mister Xhonit gati të gjithë pinin cigare dhe tymi po u shkaktonte dhembje koke. Mister Xhoni u ngrit dhe, pasi bëri disa hapja nëpër dhomë, tha:

— Domethënë, nesër dalta do të punojë dhe ata mund të arrijnë te burimi i naftës. Pra nuk

mbetet gjë tjetër veçse të fillojë faza e tretë. Nesër në mëngjes, nëpër tunelin artificial të dërgoni porosinë për fillimin e fazës së tretë. Në ditën dhe në orën që do të caktojë drejtori i institutit, do të bëhet shpërthimi. Agjenti ynë «SD-1» të presë në atë orë te Shpella e Peshkaqenit me dy agjentët e tjerë. Të tre së bashku do t'i afrohen sondës, do të vendosin lëndën dhe do të largohen drejt tunelit artificial. Edhe agjenti «SD-1» do të vijë me të tjerët. Me kaq përfundon misioni i tij në Shqipëri. Të gjitha këto njoftojani agjentit tonë. Kërkoni prej tij koordinatat e sakta të sondës dhe rrugën që duhet bërë për t'iu afruar asaj.

Bashkëpunëtorët e tij pohuan me kokë. Ata ishin të lodhur. Pritnin t'u jepte leje shefi dhe të shkonin të pushonin. Ndërkohë ra sinjali i videofonit. Mister Xhoni shtypi butonin. Në ekran u duk gruaja e tij.

— Ç'është? — pyeti ai. — Çfarë ka ndodhur?

— Asgjë, i dashur, asgjë, desha të të them se Henri u gjet.

— Ashtu? Ku është tani? — pyeti me padurim Xhoni.

— Në spitalin e qytetit.

— Përse në spital?

— Është gjetur plotësisht i narkotizuar. Mjekët kanë shpresë se do të shpëtojë. Po s'e kam hallin këtu. Ndoshta tani që u gjet, mos fillon e interesohet policia.

— Nuk besoj. Kjo çështje u mbyll. Megjithatë, po lidhem edhe një herë me miqtë e mi.

Ai mbylli videofonin dhe u ngrit.

— Pra, çdo gjë është e qartë, — tha. — Tani mund të shkoni.

Një bashkëpunëtor qëndroi në vend.

— Më falni, — tha, — po që se faza e tretë nuk do të dalë me sukses...

— Duhet të dalë patjetër, — bërtiti me të madhe mister Xhoni. — Nuk do të ketë fazë të katërt. Në qoftë se ndodh kjo që thoni ju, atëherë lëndën shpërthyesë vendoseni në anijen tonë speciale dhe...

Ishte tepër e qartë. Nuk që nevoja të fliste më. Ata dolën një nga një nga kabineti dhe e lanë shefin fare vetëm.

E ENJTE 7 KORRIK 2044

Lanti erdhi në orën e caktuar. Adi dhe Gjergji po e pritnin në hollin e hotelit.

— I more pllakat? — e pyeti Gjergji.

— Jo vetëm pllakat, — tha Lanti, — por edhe kostume të reja. M'i dha shoku Ilir. Këto pllaka mund të montohen vetëm në kostume të reja.

Kostumet kishin pothuaj atë ngjyrë që kishte uji i detit në thellësi. Me to nuk dukesh fare nën ujë.

— Adi, — tha Lanti, — nuk t'u duk pak i çuditshëm mbrëmë Iliri?

— Po vërtet. Bënte ca pyetje ai...

— E mo dhe ju njëherë. Kështu e ka Iliri. Është tepër i kujdeshëm, aq më tepër kur është fjala për jetën e njerëzve.

— Po pse, çfarë mund të na gjejë nën ujë? — pyeti Adi. — Unë kam dëgjuar se asnjë njeri nuk mund të futet në ujërat tona pa u diktuar.

— Nuk është vetëm ajo, por mund të ndodhë edhe ndonjë aksident. Ndonjë amator gjuan për peshq me pushkë me rreze dhe të godet ty. Këto pllaka vetëm të mira kanë, apo jo? — tha Lanti.

— Bëmë mirë që i morëm, jemi më të sigurt, — ndërhyri Gjergji.

— Megjithatë, Iliri kishte një shqetësim. E patë si bisedonte me babanë? Gjithë fshehtësi, — vazhdoi Adi.

— Ata i shqetëson çështja e sondës, — tha Gjergji. — Prova duhet të bëhet sot e të dalë patjetër me sukses.

Fëmijët morën kostumet dhe iu afruan bregut. Kur i shihje për së largu, dukeshin si gjeologë ose alpinistë. Kjo përshtypje të krijohej nga veglat që kishin marrë me vete: çekiçë, litarë etj. Këto u duheshin po qe se do të gjenin ndonjë amforë të rëndë, ose ndonjë derë të mbyllur në hambar. Këtë radhë kishin vendosur ta kontrollonin mirë hambarin. Aty me siguri do të kishte objekte interesante.

Ata u zhdukën nën ujë. Si gjithnjë, në krye notonte Lanti.

— Më shpejt, Lanti! — foli në radio Adi. — Nuk më durohet sa të arrijmë në anije.

— Një Blenius, një Blenius! — thirri Lanti.

Ata lanë çdo bisedë dhe notuan me shpejtësi andej nga tregonte Lanti. Por nuk ishte Blenius.

— Nuk besoj të shohim ndonjë tjetër, — tha Adi, — kur qenkan kaq të rrallë.

— Ku ta dish, — ia ktheu Lanti dhe vështroi busullën e tij të dorës.

— Jemi larguar shumë? — pyeti Gjergji.

— Fare pak, — u përgjigj Lanti. — Ejani pas meje. Ja, po duket shkëmbi!

Pas pak notuan mbi kuvertën e shkatërruar. Nëpër të çarat e shumta të dërrasave, rrezet e elektrikëve të dorës hynin mirë, por syri nuk po u zinte asgjë të veçantë. Ishin shpërndarë të tre dhe mundoheshin mos gjenin ndonjë derë ose të çarë më të madhe për t'u futur në brendësi të anijes. Nuk flisnin fare. Ndihej vetëm zhurma e lehtë e ujit, që përplasej në anët e anijes.

Mes kësaj qetësie u dëgjua një krismë dhe një si rënkim.

— Oh!

— Ç'është? — pyeti Lanti.

— Dëgjova zhurmë, — tha Adi dhe iu afrua Lantit.

— Po Gjergji nga shkoi?

Panë anash. Gjergji ishte zhdukur sikur ta kishin përpirë.

— Ku është Gjergji? — thirri Adi.

— Nuk e shoh gjekundi!

Ata notuan me shpejtësi rreth anijes, por Gjer-

gjin nuk e panë. Adi ndjeu ta mbulonin djersë të ftohta, sikur po i merreshin mendtë. Mblodhi veten dhe thirri:

— Gjergji, Gjergji!

Po kështu bëri edhe Lanti.

— E mo edhe ju njëherë. Pse bërtitni kaq fort?

— Ku je, çfarë ndodhi? — pyeti Adi.

— Pse nuk përgjigjesh? — u nxeh Lanti.

— Po fërkoja gjurin, — u përgjigj Gjergji. — Më është dërrmuar keq.

— Ç'pate, ku je tani? — Adi nuk po duronte sa ta shihte shokun e tij.

— Jam këtu, në një gropë. U thye një dërrasë dhe rashë brenda.

Adi dhe Lanti notuan andej nga vinte zëri, por gropën nuk po e gjenin dot.

— Na trego drejtimin! — thirri Lanti.

— Këtej, në bash të anijes.

Ata notuan andej. Me elektrikët e dorës ndriçuan gropën, në fund të së cilës rrinte ulur Gjergji, duke fërkuar gjurin. Adit i erdhi për të qeshur.

— Na trembe! Kujtuam se çfarë ndodhi, — dhe u futën në gropë dhe e ndihmuan Gjergjin të ngrihej.

— Pe gjë këtej anash? — pyeti Lanti.


— Aty e kisha mendjen unë, te zbulimet!

Adi ndriçoi me elektrik nga të gjitha anët. Nuk pa gjë dhe u mat të kthehej.

— Dale, dale, — u tha Lanti. — Diçka ka atje.

— Një statujë, një statujë! — thirri Gjergji.

Kur e ngritën, panë se ishte vetëm trupi i një statuje të vogël.



— Mungojnë koka dhe gjymtyrët, — tha Lanti. — Sa keq!

— Edhe kështu ia vlen, apo jo? — iu drejtua Gjergji.

— Patjetër, edhe kështu ia vlen shumë.
Ata u ngjitën pas pak mbi kuvertë.

*
*
*

Mister Xhoni pa orën e madhe në kabinën e anijes. Ajo shënonte 9.00.

— Tani, — urdhëroi kapitenin, — duhet të nisen.

Kapiteni doli dhe shkoi në sallën ku po e pritnin agjentët.

— Gati për nisje! — foli kapiteni. — Porositë i keni të qarta. Vendosni udhëzimet në vendin e caktuar dhe kthehuni shpejt. Kujdes në çdo vepër. Dyshimi më i vogël që mund t'u lindë shqiptarëve, e prish gjithë punën. Mbani lidhje me radio. Në qoftë se ndokush do t'ju pengojë për kryerjen e misionit, asgjësojeni dhe mos harroni të merrni kufomën me vete. E lëshojmë më mirë në Mesdhe!

Agjentët u ngritën dhe u futën në dhomën e nisjes. U ndie sinjali dhe të gjitha aparaturat nisën të punonin. Mister Xhoni rrinte i përqendruar para ekranit. Pas pak u dukën dy agjentët aktualë duke notuar. Ata u zhdukën nëpër tunelin artificial dhe çdo gjë ra në qetësi. Ai u ul në poltronë, afroi pranë vetes mikrofonin dhe priti.

— Gjë pa rëndësi, — vazhdoi Kujtimi duke u zhveshur. — Po të trembemi edhe nga pak ethe...

— Jo, — nguli këmbë Agroni, — do të zhytem unë.

Kujtimi u tërhoq. Pas pak, Agroni ishte gati. Mori daltën në dorë dhe filloi të zhytej në ujë. Pranë platformës tani ishin mbledhur shumë vetë. Naimi ishte afruar dhe mundahej të depërtonte me vështrimin e tij në thellësi të ujit, ku nuk dukej asgjë. Pas shpinës së tij u afrua edhe Iliri.

— Shoku Naim, nuk duket gjë, — tha me shaka ai. Naimi ngriti kokën.

— Ashtu vërtet, por, nga padurimi, më dukej sikur po e shihja Agronin duke montuar daltën.

— A janë të sakta analizat? — pyeti Iliri.

— Shumë të sakta. Laboratori qendror në Tiranë s'ka gabuar kurrë.

— Atëherë edhe kjo pengesë do të kalohet sot, — tha Iliri.

— Kështu mendoj edhe unë, — ia ktheu Naimi. — Pas disa minutash çdo gjë do të shkojë normalisht.

Ata heshtën kur mbi ujë dolën flluskat e para me oksigjen. Agroni po dilte në sipërfaqe. Shokët e ndihmuan të hiqte akualangun.

— Merre, — i tha Kujtimit, — është akualangut yt. Punon shumë mirë.

Kujtimi vuri buzën në gaz. Agroni u shty pak më tutje dhe i bëri shenjë me dorë kryesondistit. Ky shtypi butonin dhe sonda zuri të lëvizte. Në fillim ngadalë, por pastaj nisi të rrotullohej me vrull. Të gjithë mezi pritnin që dalta të përparonte, por s'kaloi shumë e u dëgjua një krismë dhe

sonda nisi të rrotullohej bosh. Të gjithë shtangën.

— U thye? — thirri me të madhe Agroni.

— Jo, — u përgjigj kryesondisti. — Është këputur dalta me gjithë korpus.

— Si ka mundësi? — pyeti Kujtimi. — Kjo nuk mund të ndodhë.

Askush nuk po fliste. Kujtimi iu kthye Agronit dhe e pa një copë herë me një vështrim gati armiqësor. Sytë e tij të gjelbër kishin marrë një shkëlqim të lig.

— E montove mirë? — pyeti me zë pak të trashë. — E montove ashtu si duhet?

Agroni u hutua. Pa nga të tjerët. Edhe ata po e shikonin me njëfarë dyshimi.

— E pse duhet të dyshohet për montimin? — tha pas pak me gjysmë zëri.

— Sepse mund ta kesh lënë të lirë dhe kështu ke thyer korpusin, — u nxeh Kujtimi. — Ja ç'na bëre! Një daltë e tillë do tri ditë të bëhet përsëri.

Agroni ndjeu t'i kërcente gjaku në fytyrë. Por nuk bëri asnjë lëvizje. Vetëm foli me zë të ulët:

— E montova shumë mirë. Defektin nuk di ta shpjegoj.

— Pas kësaj që ndodhi, nuk mund ta marrim vesh në e montove mirë, apo jo, — i tha Kujtimi. — Po ç'rëndësi ka. Tani duhet të mendojmë si t'ia bëjmë.

Mbi platformë ra një heshtje e rëndë. Dëgjo-heshin vetëm valëzat e ujit, që përhapeshin lehtë në shtyllat e platformës. Iliri, pak më tutje, ua kishte ngulur sytë dy inxhinierëve.

Pas pak, në zyrën e drejtorit ishin mbledhur

shokët e ministrisë dhe këshilli teknik i ndërmarrjes. Drejtori rrinte në këmbë.

— Prova tjetër mund të bëhet vetëm pas dy ditësh, — tha i ngrysur.

— Mund të bëhet edhe nesër pasdite, — foli një nga shokët e ministrisë.

— E pamundur, nuk kemi daltë tjetër.

— Shokët e uzinës do të punojnë edhe natën, vetëm të bëhet dalta, të jesh i sigurt, — tha përsëri shoku nga Tirana..

*

* *

Derisa të vinte dalta tjetër, sonda do të qëndronte ashtu, e heshtur, si e lënë mënjanë. Agroni deshi të futej përsëri në ujë, ta shihte me sytë e tij korpusin e këputur, po drejtori e kishte dërguar bashkë me Kujtimin në sondën detare Nr. 2 për të ndihmuar atje.

Me sytë të ngulur te sonda, drejtori, që nga dritarja e zyrës së tij, dukej tepër i shqetësuar. Ai, një naftëtar i vjetër, që tërë jetën e kishte kaluar nëpër puse naftë, tani kishte merak se nuk do ta mbante fjalën e dhënë. E kishte shtruar për diskutim në kolektiv detyrën që u ishte ngarkuar, dhe atje, duke dëgjuar mendimet e guximshme të punëtorëve, kishte premtuar se çdo gjë do të kryhej në kohën e caktuar.

«Kurse tani... a kam unë sy e faqe të justifikohem...»

U hap dera dhe në zyrë u fut Iliri.

— Erdhe? — tha drejtori. — Tani duhet të vijë edhe Naimi.

Atë çast, në derë u duk Naimi. Ata të tre u ulën.

— Ngjarja e sotme ishte e rëndë, — tha Iliri.
— Më duhet të vërtetoj diçka.

— Çfarë? — u tregua i gatshëm drejtori.

— Më duhet patjetër ndihma e shokut Naim!

— Imja?! — tha Naimi. — Urdhëro, fol!

— Ju, shoku Naim, jeni punëtor, komunist i vjetër. Ne të tre mund të bisedojmë hapur. Si specialist mund të më ndihmoni të vërtetoj se çfarë ndodhi sot, ishte një defekt, apo...

— Apo... — Drejtori ishte ngritur në këmbë.

— Le të mos flasim për dyshimet, — tha Iliri.

— Pasi të zhytem në sondë bashkë me shokun Naim, do të flasim përsëri.

Dy të tjerët shtangën.

— Shkojmë, — tha Naimi dhe u ngrit në këmbë.

— Dale, ti e ke të ndaluar nga mjeku, — ia ktheu drejtori.

— E kam të ndaluar të zhytem shpesh, por një herë... dhe në një rast si ky!...

Ai i futi krahun Ilirit dhe shkuan të merrnin akualanget. Drejtori nxitoi te sonda. Pas pak erdhën edhe ata. Drejtori, tepër i shqetësuar, bënte ecejake nëpër platformë.

Dy të tjerët u zhdukën nën ujë. Naimi notoi përpara.

— Këtu duhet parë, këtu, — i tha Iliri Naimit, kur arritën te korpusi.

Naimi u afrua edhe më. Poshtë tij kishte vetëm

baltë. I nguli sytë aty ku duhej të ishte dalta. Në çast, nga habia, iu zmadhuan sytë. Nuk po i besonte vetes. Filloi ta prekte vendin me dorë dhe menjëherë u kthye me vrull nga Iliri e foli me një zë tepër të shqetësuar:

— Nuk është thyerje!

— Po çfarë? — pyeti me nxitim Iliri.

— Prerje, e kanë prerë!

Iliri e kapi për krahu.

— A je i sigurt?

Naimi e preku edhe një herë vendin e tha me vendosmëri:

— S'kam asnjë dyshim. Dikush e ka prerë kompusin deri afër fundit. Në rrotullimin e parë është thyer lehtësisht.

Iliri hodhi sytë poshtë këmbëve të tij, te balta.

— Atje nuk mund të gjendet asgjë, balta është disa metra e thellë, — tha Naimi.

— Dalim, — tha Iliri dhe nisi të notonte.

Në platformë i priste drejtori.

— Hë, — pyeti ai me padurim, — e gjetët daltën?

— As që është nevoja, — tha Naimi dhe i tregoi për prerjen.

— Kush ka leje të zhytet, veç Agronit dhe Kujtimit? — pyeti Iliri.

— Askush tjetër, — u përgjigj drejtori pasi i kaloi hutimi i parë.

Ata heshtën një copë herë.

— Falemnderit, shoku Naim, — tha Iliri, — unë po shkoj. Ky fakt tani për tani përbën sekret.

Drejtori bëri një lëvizje me dorë sikur desh

të thoshte «As që duhet të na kujtosh për këtë gjë».

Iliri përshkoi i menduar tërë territorin e kantierit dhe po bëhej gati të dilte në rrugë, kur dëgjoi pas vetes një zë:

— Shoku Ilir!

Ishte një sondist i vjetër. Iliri e njihte si një nga punëtorët më të dalluar të kantierit.

— Urdhëro! — i tha Iliri dhe i zgjati dorën.

— Më falni, po dua t'ju them diçka. Jam i bindur se korpusi nuk është thyer. Zhurmat nuk mund të më ngatërrohen lehtë mua. Veshi im më thotë se dalta dhe korpusi u shképutën shumë lehtë. Ndoshta është bërë ndonjë gjë me qëllim.

Iliri e pa me vëmendje.

— Veç kësaj, — vazhdoi sondisti, — akualangu i Agronit u gjend i lagur.

— Kjo kuptohet, — tha Iliri, — ai u zhyt pak kohësh nën ujë!

— Sot ai u zhyt me akualangun e Kujtimit, — nguli këmbë sondisti.

— Ashtu! — u çudit Iliri. — Falemnderit për këtë që më the!

Naftëtari u largua dhe Iliri e ndoqi një copë herë me sy.

*

* * *

Ndërsa në sondë shqetësimi kishte arritur kulmin, në breg të Currilave kishte gjallëri të madhe. Jo më shumë se dhjetë minuta më parë, nga bre-

gu i Currilave ishin zhytur nën ujë dhe ishin zhdukur drejt thellësisë tre akualangistë të rinj. Ishin tre heronjtë tanë, të cilët këtë radhë ishin pajisur me të gjitha mjetet e duhura. Adi kishte biseduar me të atin dhe kishte siguruar një solucion për heqjen e ndryshkut nën ujë. Kishin marrë me vete dhe një levë të vogël e një litar. Kushedi, mund t'u hynin në punë.

Në krye notonte Lanti, i cili orientohej shumë mirë me busullën e vogël të dorës. Nuk u interesonte atë ditë asnjë nga bukuritë e detit, as peshqit e shumtë. Madje nuk kishin marrë me vete as pushkët.

Shkëmbi u duk si një hije prej së largu. Djem-të notuan më fort dhe iu afruan me shpejtësi.

Me thikat e tyre nisën të gërryenin me kujdes vendin pas shkronjës «Z». Jo fill pas saj, por pak më tutje nisën të dukeshin gjurmët e një shkronje. Më tepër ishte një njollë.

— Më ngjan si «U», — tha Gjergji.

— Po tamam, U është, — pohoi Lanti. — Më duket se kemi të bëjmë pikërisht me anijen «Zeus».

— Shikojmë më tej, më tej, — tha Adi. — Duhet të jetë shkronja «S».

Shkronja tjetër nuk ngjante si «S». Ishin gjurmë shumë të zbehta. Por të kthyerat lart dhe poshtë ta jepnin përshtypjen se ishte vërtet shkronja që kërkonin.

— Ajo është, nuk ka asnjë dyshim, — nguli këmbë Adi. — Është tamam «Zeusi».

— Po, po, «Zeusi» është, — tha edhe Lanti. — Të shikojmë te dera. Solucioni që kemi me vete duhet të tregojë tani aftësinë e tij.

Ata notuan nga ana ku ndodhej dera e mbyllur.

Ndërsa djemtë po i afroheshin derës, përballë qytetit të Durrësit, tutje ujërave territoriale të Shqipërisë, qëndroi anija e mister Xhonit. Pikërisht në atë vend ku u hap një ditë më parë edhe tuneli artificial, siç e quajti ai. Në kabinën e tij ndodheshin kapiteni dhe dy agjentët që do të çanin përsëri rrjetën valore.

Mister Xhoni i pa një copë herë me vëmendje të tjerët dhe tha:

— Agjenti ynë «SD-1» në Shqipëri e di mirë si duhet të veprojë. Ai tashmë, pas një heshtjeje prej disa vitesh, filloi veprimtarinë e tij. Gjithë këto vite ka ndenjtur në pritje dhe është përpjekur të fitojë besimin e shefave të tij në punë. Ne e kemi ruajtur atë vetëm për këtë ditë, kur të paraqitet nevoja për një aksion me rëndësi tepër të madhe. Dhe koha erdhi. Agjenti ynë punon në kantierin e sondës detare «SD-1». Çarja e rrjetës valore të shqiptarëve ishte një fat i madh për ne, ndryshe, agjenti do të vepronte fare vetëm. Tani kemi mundësi t'i dërgojmë për ndihmë agjentë të tjerë, sidomos kur të vijë momenti i duhur. Ai, sipas udhëzimeve të dërguara shumë kohë më parë, e di se për ndërlidhje do të përdoren disa pika të caktuara. Njëra prej tyre do të jetë Shpella e Peshkaqenit. Në atë shpellë të nënujshme do t'i lëmë udhëzimet. Qartë!

Kapiteni u ngrit e dha në mikrofon urdhrin:

— Gati për çarjen e rrjetës, të gjithë nëpër vende!

Mister Xhoni iu afrua ekranit, ku pasqyrohej zona ku do të kalonin të dy agjentët. Megjithëse një ditë më parë rrjeta ishte çarë me sukses, ai përsëri kishte frikë se mos shqiptarët kishin nuhatur gjë dhe kishin ndërruar natyrën e valëve. U dëgjua sinjali dhe pas disa çasteve dy agjentët u dukën të notonin drej ujërave të Shqipërisë. Mister Xhoni ndjeu t'i rrihte zemra me forcë. Ata kaluan dhe ai mori frymë i lehtësuar.

— Mbani lidhje me radio, — urdhëroi mister Xhoni në mikrofon dhe u ul. Nisi të dremiste. Një natë më parë nuk kishte fjetur mirë. Henri po e shqetësonte shumë prej kohësh. Që kur kishte bërë vrasjen, të cilën mister Xhoni e kishte mbyllur pas shumë ndërhyrjeve dhe pasi kishte harxhuar një shumë të mirë dollarësh, Henri nuk ishte dukur në shtëpi. Bile nuk kishte asnjë lajm prej tij.

«Mos ndoshta e kanë vranë edhe atë!» — mendonte ai dhe i dridhej i tërë trupi. Ishte djali i tij i vetëm dhe nuk donte në asnjë mënyrë të përfundonte kështu kjo çështje. Kishte pyetur kudo, në të gjitha rajonet e policisë së shtetit, por asnjë përgjigje. Mbetej vetëm një mundësi: ndoshta ai ishte larguar me ndonjë grup gangsterësh, narkomanësh dhe bridhte fushave e maleve si dikur njerëzit e egër.

*
* *
*

Adin, Lantin dhe Gjergjin i kishte përrpirë puna për hapjen e derës së kabinës.

Adi nxori nga një qese që e mbante lidhur në

brez, një shishe të vogël dhe ia dha shokut. Lanti e mori dhe e afroi të mbyllur te llozi i derës. Do ta hapte grykën e shishes pikërisht mbi të, që solutioni të mos shpërndahej në ujë. Një lëng i trashë u shtri mbi lloz. Atëherë të tre nisën ta shtrijnë me duar nëpër të gjithë llozin. Lanti e kapi llozin dhe filloi ta rrotullonte. Gjergji mbështeti në të levën dhe nisi ta shtynte.

— Po lëviz, më duket, — tha Lanti. — Jepi më fort!

Ata i dhanë me të gjitha forcat dhe më në fund llozi u lirua. E tërhoqën pak dhe dera u hap. Të tre u futën njëherësh në kabinë. Kudo errësirë. Me vete nuk kishin as elektrik dore. Drita e diellit nuk depërtonte brenda në kabinë, kështu që ata nuk vunë re asgjë.

— U pa puna, duhet të vijmë pasdite, — tha Adi. — Pa elektrik dore nuk mund të shohim asgjë këtu.

— Po, ke të drejtë, — tha Lanti, — vijmë pasdite. Gjergj, lëre levën brenda në kabinë; ndoshta mund të na duhet pasdite.

Gjergji e lëshoi levën në të hyrë të kabinës. Ata e mbyllën me kujdes derën dhe i vunë llozin.

*

* *

Ata e kishin lënë të takoheshin pas buke. Në orën 14.00 ishte koha që në plazh nuk qarkullonin shumë veta dhe nuk do t'i shqetësonte kush. Kishin

filluar t'i bezdisnin shumë fëmijët e vegjël, të cilët, sapo shihnin se tre djemtë bëheshin gati të zhyteshin, afroheshin e bënin rrëmujë. Le që as të dilte koha t'u përgjigjeshe të gjitha pyetjeve të tyre! Disa kërkonin të vinin me ta nën ujë!

Adi me Gjergjin kishin ngrënë drekë dhe po qëndronin në holl të hotelit për të pushuar pak derisa të vinte Lanti. U hap dera dhe në holl u duk inxhinier Kujtimi.

— Shoku Kujtim, — tha Adi dhe u ngrit në këmbë, — nuk erdhi babai?

— Oho, — qeshi Kujtimi, — miqtë e mi të vegjël, si jeni? Babai nuk do të vijë. Më tha t'ju porosit që pasdite të shkoni tek ai në sondë. Ju fton për vizitë.

— Ç'mrekulli! — Djemtë u hodhën përpjetë nga gëzimi.

— Po ju? — pyeti Adi. — Tani erdhët?

— Ka pak kohë. Isha ca i lodhur dhe vendosa të bëj pushim.

— Sa keq! — tha Gjergji. — Mund të vinit me ne!

— Ku kështu? — pyeti i çuditur Kujtimi.

— Do të zhytemi. Kemi zbuluar një anije të mbytur, — tha Adi.

— Sa mirë, sa mirë, po ju nuk e dani se unë prandaj kam ardhur këtu. Kisha në plan të zhytesha për gjueti, sepse zhytja më heq lodhjen. Po vij me ju.

Kujtimi u ul pranë tyre dhe nisi t'u tregonte shumë gjëra interesante nga fundi i detit.

Lanti nuk vonoi të vinte. Pas pak, të katër ishin gati për t'u zhytur.

— Futi pra, Lanti, — tha Kujtimi, — unë sot do të jem nën komandën tuaj. Po zhytem vetëm për shplodhje. Kam edhe unë kureshtje të shoh anijen tuaj.

— Ta paskan treguar! — tha Lanti. — Mirë pra, unë do të jem i pari, pastaj me radhë, Adi me Gjergjin dhe në fund shoku Kujtim. Na ruani krahët! — qeshi Lanti.

— Si urdhëron, shoku komandant! — tha Kujtimi.

Ata u zhdukën nën ujë. Lanti notonte me shpejtësi përpara.

— E dini me saktësi drejtimin? — pyeti në radio Kujtimi.

— Po, po, — tha Lanti e dha koordinatat.

Kujtimi pa sahatin. Nuk ishte sahat, por busull që përdoret në ujë. Në tokë vlen si sahat. Adi ktheu kokën dhe qëndroi pak. I kapi dorën dhe vështroi me zili busullën e tij.

— Mirë e ke drejtimin, — tha Kujtimi, pasi vështroi një copë herë akrepat e busullës. — Vazhdo po ashtu.

U ndodhën shpejt pranë anijes. Djemtë i treguan Kujtimit vendin ku ishte shkruar emri i anijes.

— Shikoni gjurmët, — tha Adi. — Nuk duhet të jetë pikërisht «Zeusi»?

Djemtë vazhduan të gërryenin përsëri aty. Donin që të dukej sa më qartë emri i anijes. Kujtimi notoi më tej për të parë më me imtësi anijen. Pas pak foli në radio:

— Djema, këtu është një derë, afrohuni.

— Po, po, e dimë, — tha Lanti dhe u afrua te kabina.

Atë çast Kujtimi po dilte prej saj.

— Ta shikojmë brenda, — tha Adi, — prandaj kemi marrë edhe elektrikët e dorës.

— Nuk kishte asgjë interesante, — tha Kujtimi. — Unë po shoh andej nga hambari.

Djemtë u futën në kabinë dhe me elektrikët e dorës kontrolluan çdo qoshe. Aty nuk kishte asnjë objekt. Pas pak dolën jashtë të mërzhitur. Pritnin të gjenin ndonjë gjë të rrallë në kabinë. Kur dolën, panë të afrohej pranë tyre Kujtimi me diçka në dorë.

— Çfarë është kjo? — pyeti Adi me kureshtje.

— Një amforë, e gjeta në hambar. Është pak e thyer, por mund të vlejë.

Djemtë e rrethuan dhe nisën ta vështronin me vëmëndje.

— Do ta shohim mirë kur të dalim në breg, — tha Kujtimi. — Shkojmë tani.

— Mirë, — pranoi Lanti. — Përsëri do të notojmë sipas radhës së caktuar.

Amforën e mbajti Kujtimi, se ishte e rëndë. Ajo ishte rënduar edhe nga guacka të shumta që kishin veshur anët e jashtme të saj.

Sapo bënë metrat e parë, u dëgjua thirrja e Gjergjit:

— Daleni, daleni, diçka pashë!

— Çfarë, çfarë pe? — pyeti i alarmuar Kujtimi.

— Më duket se pashë një Blenius, — tha Gjergji.

— Ku e pe, nga shkoi? — Lanti pyeti me shumë padurim.

Kujtimi mori frymë i lehtësuar.

— U fut në atë algen atje, — dhe Gjergji tregoi me dorë.

— Mos lëvizni! — tha Lanti. — Po afrohem unë.

Ai nxori nga brezi një qese të madhe plast-masi dhe iu afrua algave. Notonte me shumë kujdes, tamam si gjahtari kur kërkon gjahun. Lanti u zhduk pas pak midis algave. Të tjerët nuk po lëviznin fare.

— E kapa, e kapa!

Adi dhe Gjergji notuan me shpejtësi andej nga ishte zhdukur Lanti. Pas tyre shkoi edhe Kujtimi.

— Ndonjë gjë e rrallë? — pyeti Kujtimi.

— Shumë e rrallë. Këtë peshk për herë të parë do ta kemi të gjallë në muze.

— Mirë, tani, djema, dalim, — tha Kujtimi. — Nuk dua të vonohem në punë.

Ata filluan të notonin. Herë pas here Adi dhe Gjergji i afroreshin Lantit dhe, pasi i merrnin qesen nga dora, e vështronin me një dashuri të jashtëzakonshme Bleniusin.

Kur dolën në breg, u zhveshën dhe u shtrinë në rërë për t'u ngrohur. Bleniusin, brenda në qese, e mbante Lanti, i cili i shihte tamam si një shkencëtar.

— Shoku Kujtim, — iu drejtua Adi. — Ku e

keni marrë këtë busull? Qenka e mrekullueshme!

— Ma ka dhuruar një shok, — iu përgjigj Kujtimi. — Nuk është vetëm busull, por tregon edhe kohën.

Djemtë e morën me radhë në dorë dhe e panë me shumë kureshtje. Nuk kishin parë ndonjëherë një të tillë. Gati të gjitha ngjyrat e ylberit gjendeshin në fushën e saj. Kujtimi e vendosi përsëri në dorë dhe u ngrit.

— Më falni mua, — tha. — U kënaqa shumë sot. Ndonjëherë tjetër do të zhytem përsëri me ju. Mirupafshim!

Djemtë qëndruan edhe një copë herë.

— Duhet dërguar amfora në muzeun arkeologjik dhe Bleniusi te profesori ihtiolog.

Lanti u ngrit.

— Do të vijmë edhe ne në qytet, — tha Adi, — do të shkojmë në kantier; na ka ftuar babai për të parë sondën. Mund të vish edhe ti, Lanti.

— Kam shumë dëshirë, — u gëzua Lanti.

Në muzeun arkeologjik nuk e gjetën profesor Dorian Koçiun. Amforën dhe një copë letër të shkruar shpejt e shpejt ia lanë nëpunësit të rojes. Të nesërmen do të gjenin mundësi ta takonin vetë profesorin. Donin të bisedonin më shumë me të. Kishin shumë gjëra për të pyetur.

Në qëndrën shkencore të peshkimit u thanë të pritnin sa të njoftohej profesori. Djemtë qëndruan në korridor dhe pritën.

Më së fundi dera u hap dhe që andej doli profesori.

Lanti nuk duroi, por i zgjati qesen profesori.

rit. Ai e rrëmbeu. Zuri ta shihte me vëmëndje.

— Po, po, tamam Blenius. Sa i mrekullueshëm! Djema, më gëzuat shumë, — dhe e rrotullonte qesen nga të gjitha anët. — Megjithëse ka dy sy, i thonë Blenius me katër sy. Ky qe keni sjellë ju quhet Blenius galeatica; është shumë dembel. E lë veten të ngrihet nga dallgët. Nuk e keni parë kur del në tokë e ushqehet!

— Del në tokë? — u çuditën fëmijët.

— Posi, ushqehet me kafshë shumë të vogla që sjellin dallgët nëpër shkëmbinj, pastaj, fare pa u përpjekur, pret të vijë dallga tjetër dhe futet përsëri në ujë me të. Ju thashë, është shumë dembel. Në ishujt Galapagos jeton një tjetër Blenius; edhe atij i thonë me katër sy, megjithëse ka vetëm dy. Ai kalon në tokë gati gjysmën e kohës, bile ngjitet edhe mbi shkëmbinj e hidhet pastaj që andej, kur sheh ndonjë rrezik.

Djemtë po e dëgjonin me vëmëndje profesorin.

— Do të ma lini mua? — pyeti pas pak profesori dhe e pa Lantin drejt e në sy.

— Sigurisht, ndaj kemi ardhur.

— Shumë faleminderit! Nuk do ta harroj kurrë këtë nder!

— Profesor, — tha Lanti, — mund të na vini javën tjetër në pallatin e pionierit? Ne do t'ju dëgjonim me kënaqësi, kur të na flisnit për Bleniusin dhe peshqit e tjerë të Adriatikut:

— Posi, patjetër.

Profesori i përcolli djemtë deri te dera dhe, kur u ndanë, i falënderoi përsëri.

*

*

*

Agroni pa orën e dorës. Donte edhe disa minuta të shkonte 18.00.

«Tani duhet të vijmë», — tha me vete.

U ngrit, mbylli dosjet dhe doli nga zyra. Jashtë ishte më freskët se brenda. I pëlqenin shumë pasditet e verës. Dielli sapo merrte të fshihej pas malit dhe hija mbulonte krejt zonën. Atëherë Agroni donte të ulej diku, mbi ndonjë gur ose trung, dhe të vështronte detin, zakonisht të qetë në atë orë.

Te sonda nuk kishte njeri. Iu kujtua se të nesërmen do të vinte dalta e re dhe sonda do të gjallërohej. Dalta e këputur në mëngjes nuk i hiqej nga mendja. Ai e mbante mend fort mirë të gjithë zhytjen në mëngjes. Pas montimit, e provoi me kujdes se mos lëvizte dalta. Ishte i bindur se e kishte montuar mirë. Megjithatë, ajo ishte thyer bashkë me korpusin. Nuk mund ta merrte me mend se ç'kishte ndodhur nën ujë, kur kishte filluar të rrotullohej sonda.

«Megjithëse nuk lejohet, nesër do të qëndrojë nën ujë, pranë daltës, kur të vihet në punë sonda, — mendoi. — Po që se do të ketë defekt përsëri, atëherë nuk kam sy e faqe të dal para shokëve dhe para ministrit që do të vijë për inaugurimin».

Agroni as që e pa një punëtor që qëndroi para tij.

— Shoku Agron, ju kërkoni te porta, — tha ai. Agroni ngriti kokën, pa orën. Ishte plot 18.00.

Iu kujtua se do të kishte ardhur Adi me Gjergjin. Prej së largu pa bashkë me të dy djemtë edhe një tjetër.

«Me siguri do të jetë Lanti», — mendoi.

U njoh me Lantin dhe i mori të tre me vete. Në fillim vizituan sondën. U ngjitën në platformë dhe e panë me shumë vëmëndje. Bënin pyetje të shumta dhe Agroni nuk kishte kohë t'u përgjigjej të gjithave.

— Ju doni të dini gjithçka sikur nesër do të punoni në sondë, — qeshi Agroni. — Do t'i mësoni, në qoftë se ndonjëri prej jush do të bëhet inxhinier naftë.

— Ku ta dish, — tha Lanti. — Megjithëse mua do të më pëlqente të studioja më tepër historinë ose edhe zoologjinë.

Pastaj ata u futën në laborator, ku ishte ndër-tuar sonda në miniaturë. Mbi tryezë ndodheshin disa dosje dhe mbi të gjitha shkruhej «SD-1».

— Babi, ç'është «SD-1»? — pyeti Adi.

— Sonda pra, — tha Agroni. — Sonda detare Nr. 1.

— Po ditën e inaugurimit, do të na lejojnë të vijmë? — pyeti Gjergji.

— Besoj se po. Ditën e inaugurimit këtu mund të vijnë shumë njerëz nga qyteti. Si në çdo inaugurim, si në çdo festë.

Kur dolën nga kantieri, ishte ngrysur. Ata hipën në veturën që drejtonte Agroni, dhe u nisën për në qytet.

Në Currila ishin ndezur të gjitha dritat dhe dukej aq bukur. Ata u ngjitën lart, në pistë, dhe

kërkuan ndonjë tryezë të lirë, por ishin të gjitha të zëna.

— Agron, Agron, — u dëgjua një zë nga mesi i pistës.

Agroni u zgjat dhe pa në një tryezë Ilirin dhe Anën.

Ata shkuan atje dhe pas pak të gjashtë ishin ulur pak shtrënguar rreth tryezës.

Ana ishte shumë e qeshur dhe u mundua që djemtë të kënaqeshin sa më shumë. Iliri ishte përkulur pak dhe diçka po bisedonte me Agronin, i cili ishte bërë serioz në fytyrë dhe po dëgjonte shumë i përqendruar.

— Mos u mërzit, — tha Iliri. — Nesër të jesh i sigurt për suksesin.

— Vetëm nesër mund të flas, pas provës.

— Dëgjomë mua. Nuk ka asnjë dyshim. Ajo që ndodhi sot nuk do të ndodhë më. Djemtë si po i kalojnë pushimet? — pyeti pas pak me zë të lartë.

Ana dhe tre djemtë, që po bisedonin për muzeun zoologjik të pallatit të pionierëve, kthyen kokat kur dëgjuan këtë pyetje.

— Pyeti vetë, — i tha Agroni. — Duken të kënaqur. Për këtë duhet të falënderojnë Lantin. Ndoshta do të ishin mërzitur pa një shoqërues. Unë u premtova, por nuk e plotësova këtë detyrë.

— Shoku Ilir, po e kalojmë shumë mirë, — tha Adi. — Lanti e njeh fundin e detit për mre-kulli.

— Zhyteni nën ujë, — pyeti Iliri i interesuar, — dhe nuk keni frikë?

— E pse të kemi frikë? — u çudit Gjergji.
— Kush do të na trembë, peshqit?

— Në det nuk ka vetëm peshq, — tha si i menduar Iliri.

— E ç'mund të ketë tjetër? — pyeti Lanti. — Peshq dhe anije të mbytura.

— U afroheni anijeve të mbytura? — pyeti me kureshtje Ana. — Sa dëshirë kam të zhytem një herë e të shoh si duken ato nën ujë! Kur lundrojnë mbi ujë më duken madhështore.

— Po të doni, ejani me ne, — tha Gjergji. — Do të kënaqeni vërtet. Tek anija jonë mund të gjeni edhe ndonjë objekt të bukur arkeologjik. Sot shoku Kujtim gjeti një amforë të mrekullueshme.

— Kush? — pyeti Iliri me nxitim.

Pyetja i kishte dalë si padashur. Agroni e pa me çudi, por fëmijët nuk vunë re gjë.

— Shoku Kujtim, — tha Adi, — u zhyt sot me ne. Erdhi deri tek anija e mbytur. Dhe ishte një notar i mrekullueshëm. Dukej si aktualangist profesionist.

— Në ç'orë u zhytët? — pyeti Iliri.

— Padsdreke, rreth orës 14.00.

— Sa kohë qëndruat nën ujë?

— Rreth dy orë.

Iliri e vuri re se djemtë po çuditeshin nga pyetjet e tij ndaj shtoi:

— Dhe për dy orë zbuluat vetëm një amforë!
— tha pastaj me buzë në gaz.

— Amfora nuk ishte gjë përpara Bleniusit me katër sy, — vazhdoi Lanti.

— Çfarë, çfarë? Blenius me katër sy?! — pyeti e çuditur Ana. — E ku ka peshk me katër sy?

— Kështu i thonë, — ndërhyri Gjergji, — por dy sy ka si gjithë të tjerët. Është nga peshqit më të rrallë të Adriatikut. Ia dhuruam profesorit ihtiolog të laboratorit qendror të peshkimit.

— Mirë keni bërë, — tha Agroni. — I duhet për studim.

Iliri nuk po fliste fare. Ana vazhdonte pyetjet për peshkun e rrallë dhe djemtë nuk përtonin t'i përgjigjeshin.

Iliri u përkul nga Agroni dhe i pëshpëriti:

— Kujtimi sot ka qenë me temperaturë, apo jo?

— Posi, ndaj dhe nuk e lamë të zhytet në mëngjes.

— Megjithatë qenka zhytur plot dy orë me fëmijët pasdreke.

Agroni ngriti supet.

Djemtë hëngrën darkë, morën edhe nga një akulllore dhe po rrinin pak si të lodhur. Si qëndruan edhe ca, u ngritën.

— Do të zhyteni përsëri nesër? — pyeti përsëri Iliri.

— Posi, mund të zhytemi edhe dy herë. Duhet të gjejmë edhe objekte të tjera arkeologjike, — tha Gjergji.

— Ashtu, — tha Iliri, — keni të drejtë. Nga gjërat e vogla shpesh dalin zbulime të mëdha. Po çfarë armësh merrni me vete? — pyeti ai.

— Pushkë pneumatike për të vrarë ndonjë peshk, — iu përgjigj Lanti.

— Shumë mirë, ato ju duhen. Po pllaka mbrojtëse nuk merrni?

— Çfarë pllakash? — u interesua Adi.

— Janë disa pllaka të vogla që montohen në aktualang, — sqaroi Iliri. — Ato kanë veti të kthejnë prapa çdo goditje, qoftë edhe me armë me lazer.

— E ç'na duhen neve? Ne nuk përdorim armë me lazer.

— I përdorin të tjerët, — tha Iliri, — të rriturit. Gabimisht mund të ndodhë ndonjë aksident, ndaj nesër në mëngjes ti, Lanti, eja nga zyra ime. Kam unë të tilla pllaka.

— Mirë.

Kur mbetën vetëm, Ana i tha Ilirit:

— Pse i trembe fëmijët? Çfarë e keq mund t'i gjejë ata?

— Asgjë, asgjë, — tha Iliri. — Po nuk është keq të jenë më të kujdesshëm. Nëndet është dhe ku ta dish çfarë ndodh. Se mos janë mbi tokë!

Ana tundi kokën pa kuptuar asgjë.

*

* * *

Në kabinetin e mister Xhonit gati të gjithë pinin cigare dhe tymi po u shkaktonte dhembje koke. Mister Xhoni u ngrit dhe, pasi bëri disa hapa nëpër dhomë, tha:

— Domethënë, nesër dalta do të punojë dhe ata mund të arrijnë te burimi i naftës. Pra nuk

mbetet gjë tjetër veçse të fillojë faza e tretë. Nesër në mëngjes, nëpër tunelin artificial të dërgoni porosinë për fillimin e fazës së tretë. Në ditën dhe në orën që do të caktojë drejtori i institutit, do të bëhet shpërthimi. Agjenti ynë «SD-1» të presë në atë orë te Shpella e Peshkaqenit me dy agentët e tjerë. Të tre së bashku do t'i afrohen sondës, do të vendosin lëndën dhe do të largohen drejt tunelit artificial. Edhe agjenti «SD-1» do të vijë me të tjerët. Me kaq përfundon misioni i tij në Shqipëri. Të gjitha këto njoftojani agjentit tonë. Kërkoni prej tij koordinatat e sakta të sondës dhe rrugën që duhet bërë për t'iu afruar asaj.

Bashkëpunëtorët e tij pohuan me kokë. Ata ishin të lodhur. Pritnin t'u jepte leje shefi dhe të shkonin të pushonin. Ndërkohë ra sinjali i videofonit. Mister Xhoni shtypi butonin. Në ekran u duk gruaja e tij.

— Ç'është? — pyeti ai. — Çfarë ka ndodhur?

— Asgjë, i dashur, asgjë, desha të të them se Henri u gjet.

— Ashtu? Ku është tani? — pyeti me padurim Xhoni.

— Në spitalin e qytetit.

— Përse në spital?

— Është gjetur plotësisht i narkotizuar. Mjekët kanë shpresë se do të shpëtojë. Po s'e kam hallin këtu. Ndoshta tani që u gjet, mos fillon e interesohet policia.

— Nuk besoj. Kjo çështje u mbyll. Megjithatë, po lidhem edhe një herë me miqtë e mi.

Ai mbylli videofonin dhe u ngrit.

— Pra, çdo gjë është e qartë, — tha. — Tani mund të shkoni.

Një bashkëpunëtor qëndroi në vend.

— Më falni, — tha, — po qe se faza e tretë nuk do të dalë me sukses...

— Duhet të dalë patjetër, — bërtiti me të madhe mister Xhoni. — Nuk do të ketë fazë të katërt. Në qoftë se ndodh kjo që thoni ju, atëherë lëndën shpërthyese vendoseni në anijen tonë speciale dhe...

Ishte tepër e qartë. Nuk qe nevoja të fliste më. Ata dolën një nga një nga kabineti dhe e lanë shefin fare vetëm.

E ENJTE 7 KORRIK 2044

Lanti erdhi në orën e caktuar. Adi dhe Gjergji po e pritnin në hollin e hotelit.

— I more pllakat? — e pyeti Gjergji.

— Jo vetëm pllakat, — tha Lanti, — por edhe kostume të reja. M'i dha shoku Ilir. Këto pllaka mund të montohen vetëm në kostume të reja.

Kostumet kishin pothuaj atë ngjyrë që kishte uji i detit në thellësi. Me to nuk dukeshë fare nën ujë.

— Adi, — tha Lanti, — nuk t'u duk pak i çuditshëm mbrëmë Iliri?

— Po vërtet. Bënte ca pyetje ai...

— E mo dhe ju njëherë. Kështu e ka Iliri. Është tepër i kujdeshëm, aq më tepër kur është fjala për jetën e njerëzve.

— Po pse, çfarë mund të na gjejë nën ujë? — pyeti Adi. — Unë kam dëgjuar se asnjë njeri nuk mund të futet në ujërat tona pa u diktuar.

— Nuk është vetëm ajo, por mund të ndodhë edhe ndonjë aksident. Ndonjë amator gjuan për peshq me pushkë me rreze dhe të godet ty. Këto pllaka vetëm të mira kanë, apo jo? — tha Lanti.

— Bëmë mirë që i morëm, jemi më të sigurt, — ndërhyri Gjergji.

— Megjithatë, Iliri kishte një shqetësim. E patë si bisedonte me babanë? Gjithë fshehtësi, — vazhdoi Adi.

— Ata i shqetëson çështja e sondës, — tha Gjergji. — Prova duhet të bëhet sot e të dalë pajtjetër me sukses.

Fëmijët morën kostumet dhe iu afruan bregut. Kur i shihje për së largu, dukeshin si gjeologë ose alpinistë. Kjo përshtypje të krijohej nga veglat që kishin marrë me vete: çekiçë, litarë etj. Këto u duheshin po që se do të gjenin ndonjë amforë të rëndë, ose ndonjë derë të mbyllur në hambar. Këtë radhë kishin vendosur ta kontrollonin mirë hambarin. Aty me siguri do të kishte objekte interesante.

Ata u zhdukën nën ujë. Si gjithnjë, në krye notonte Lanti.

— Më shpejt, Lanti! — foli në radio Adi. — Nuk më durohet sa të arrijmë në anije.

— Një Blenius, një Blenius! — thirri Lanti.

Ata lanë çdo bisedë dhe notuan me shpejtësi andej nga tregonte Lanti. Por nuk ishte Blenius.

— Nuk besoj të shohim ndonjë tjetër, — tha Adi, — kur qenkan kaq të rrallë.

— Ku ta dish, — ia ktheu Lanti dhe vështroi busullën e tij të dorës.

— Jemi larguar shumë? — pyeti Gjergji.

— Fare pak, — u përgjigj Lanti. — Ejani pas meje. Ja, po duket shkëmbi!

Pas pak notuan mbi kuvertën e shkatërruar. Nëpër të çarat e shumta të dërrasave, rrezet e elektrikëve të dorës hynin mirë, por syri nuk po u zinte asgjë të veçantë. Ishin shpërndarë të tre dhe mundoheshin mos gjenin ndonjë derë ose të çarë më të madhe për t'u futur në brendësi të anijes. Nuk flisnin fare. Ndihej vetëm zhurma e lehtë e ujit, që përplasej në anët e anijes.

Mes kësaj qetësie u dëgjua një krismë dhe një si rënkim.

— Oh!

— Ç'është? — pyeti Lanti.

— Dëgjova zhurmë, — tha Adi dhe iu afrua Lantit.

— Po Gjergji nga shkoi?

Panë anash. Gjergji ishte zhdukur sikur ta kishin përrpirë.

— Ku është Gjergji? — thirri Adi.

— Nuk e shoh gjëkund!

Ata notuan me shpejtësi rreth anijes, por Gjer-

gjijn nuk e panë. Adi ndjeu ta mbulonin djersë të ftohta, sikur po i merreshin mendtë. Mblodhi veten dhe thirri:

— Gjergji, Gjergji!

Po kështu bëri edhe Lanti.

— E mo edhe ju njëherë. Pse bërtitni kaq fort?

— Ku je, çfarë ndodhi? — pyeti Adi.

— Pse nuk përgjigjesh? — u nxeh Lanti.

— Po fërkoja gjurin, — u përgjigj Gjergji. —

Më është dërrmuar keq.

— Ç'pate, ku je tani? — Adi nuk po duronte sa ta shihte shokun e tij.

— Jam këtu, në një gropë. U thye një dërrasë dhe rashë brenda.

Adi dhe Lanti notuan andej nga vinte zëri, por gropën nuk po e gjenin dot.

— Na trego drejtimin! — thirri Lanti.

— Këtej, në bash të anijes.

Ata notuan andej. Me elektrikët e dorës ndriçuan gropën, në fund të së cilës rrinte ulur Gjergji, duke fërkuar gjurin. Adit i erdhi për të qeshur.

— Na trembe! Kujtuam se çfarë ndodhi, — dhe u futën në gropë dhe e ndihmuan Gjergjin të ngrihej.

— Pe gjë këtej anash? — pyeti Lanti.


— Aty e kisha mendjen unë, te zbulimet!

Adi ndriçoi me elektrik nga të gjitha anët. Nuk pa gjë dhe u mat të kthehej.

— Dale, dale, — u tha Lanti. — Diçka ka atje.

— Një statujë, një statujë! — thirri Gjergji.

Kur e ngritën, panë se ishte vetëm trupi i një statuje të vogël.



— Mungojnë koka dhe gjymtyrët, — tha Lanti. — Sa keq!

— Edhe kështu ia vlen, apo jo? — iu drejtua Gjergji.

— Patjetër, edhe kështu ia vlen shumë.
Ata u ngjitën pas pak mbi kuvertë.

*
* *
*

Mister Xhoni pa orën e madhe në kabinën e anijes. Ajo shënonte 9.00.

— Tani, — urdhëroi kapitenin, — duhet të nisen.

Kapiteni doli dhe shkoi në sallën ku po e pritnin agjentët.

— Gati për nisje! — foli kapiteni. — Porositë i keni të qarta. Vendosni udhëzimet në vendin e caktuar dhe kthehuni shpejt. Kujdes në çdo vepër. Dyshimi më i vogël që mund t'u lindë shqiptarëve, e prish gjithë punën. Mbani lidhje me radio. Në qoftë se ndokush do t'ju pengojë për kryerjen e misionit, asgjësojeni dhe mos harroni të merrni kufomën me vete. E lëshojmë më mirë në Mesdhe!

Agjentët u ngritën dhe u futën në dhomën e nisjes. U ndie sinjali dhe të gjitha aparaturat nisën të punonin. Mister Xhoni rrinte i përqendruar para ekranit. Pas pak u dukën dy agjentët aktualistë duke notuar. Ata u zhdukën nëpër tunelin artificial dhe çdo gjë ra në qetësi. Ai u ul në poltronë, afroi pranë vetes mikrofonin dhe priti.

Dy agjentët notuan me shpejtësi. I pari mban-te gati pushkën me rreze lazer për çdo të papritur. Kishte tri ditë që futej në këto ujëra dhe asnjëhe-rë nuk e kishte provuar këtë armë. Kishte një dë-shirë të papërmbajtur për të qëlluar me të. Donte ta provonte në njerëz, se peshq kishte vrarë sa të duash. Tjetri notonte prapa dhe në dorë shtrëngonte kutinë ku ishte vendosur letra për agjentin «SD-I.»

— Ja t'k është shpella, — tha agjenti i parë. — Mbarojmë punë dhe kthehemi shpejt. Nuk e di, por nuk më pëlqen aspak të notoj në këto ujëra.

— Më kujdes tani, — tha agjenti i dytë, — po i afrohem. Mos luaj, qëndro aty, — vazhdoi pas pak. — Rreth shpellës paska aktualangistë.

— Ashtu! Janë shumë?

— Janë tre, duhet të jenë të vegjël.

— Ç'kërkojnë ata këtu?

— Si t'ia bëjmë?

— T'i vrasim, urdhri është i prerë!

— Ashtu vërtet, por ndoshta kanë kaluar kë-tej rastësisht.

Ata qëndruan në largësi dhe pritën.

— Eja, pra, shpejt, t'i vrasim sa nuk është vonë, — tha njëri nga agjentët.

Ata notuan drejt aktualangistëve të vegjël.

I pari e ndjeu goditjen Gjergji. Sikur dikush ia veshi me grusht në gjoks. Pa rreth vetes. Ishte qetësi.

«Ç'të jetë kjo goditje? Nuk ka as lëvizje të brendshme detil!» Pastaj foli në radio:

— Adi, Lanti, ndjetë gjë ju? Sikur më godi-ti dikush me grusht.

— Kështu të është dukur, — qeshi Adi dhe provoi të hapte derën e kabinës.

— Ndal! — thirri Lanti.

— Ç'është? — pyeti Adi dhe largoi dorën nga dera e kabinës.

— Edhe unë ndjeva një goditje të fort në gjoks. Adi u mat t'i afrohej edhe më Lantit, por në cast bërtiti:

— Oh, dikush më goditi!

Ata të tre panë të trembur anash. Nuk dukej asgjë e dyshimtë.

— Ç'të jetë kjo? — pyeti Gjergji.

— Pas meje! — dha urdhër Lanti dhe nisi të notonte me shpejtësi drejt bregut. Dy të tjerët iu vunë prapa.

— Ikën, — tha agjenti i parë.

— Si kështu? — pyeti tjetri. — Nuk i qëlluan dot!

— Nuk di ç'të them! Kjo pushka ime nuk më ka turpëruar kurrë! Po pse ikën ashtu të trembur?

— Ndoshta ashtu kot. Ata nuk vunë re gjë, — dhe u nis drejt vendit për të vendosur kutinë, ku ndodheshin porositë për agjentin «SD-1».

Pas pak edhe ata ishin drejtuar për tek anija e tyre e nënujshme. Ndërkaq djemtë kishin dalë në breg. Fytyrat e tyre tregonin habi.

— Më duket se u trembëm kot, — tha Gjergji dhe qeshi me vete.

— Si ta shpjegojmë këtë? — pyeti Adi.

— As unë nuk e di, — u përgjigj Lanti. — Në det ndodhin aq shumë dukuri të çuditshme. Ndo-

shta na ka goditur ndonjë burim valësh të panjohura.

— Mos ka qëlluar kush kundër nesh? — pyeti përsëri Adi.

Dy të tjerët qeshën.

— Ama dhe ky njëherë! E kush mund të qëllojë kundër nesh? Aty rrotull nuk vumë re asnjë akualangist.

— Mos shih ëndrra, Adi, — u tall edhe Lanti.

— Po, po, — tha Adi, ka shumë mundësi të ketë qenë ashtu. Po ç'do të bëjmë ne tani?

— Unë them të shtrihemi në rërë, të ngrohemi mirë dhe pastaj shohim e bëjmë.

— Futemi pas një ore, — tha Lanti. — Harruam të marrim edhe trupin e statujës.

Ata u zhveshën dhe u shtrinë në rërën e nxeh-të.

*

* * *

Agroni doli nga uji dhe, pasi zhveshi akualangun, i tha drejtorit:

— Gati, shoku drejtor. Dalta është montuar në rregull.

— Mirë, — ia ktheu drejtori. — Le të fillojmë provat. Nisu! — iu drejtua kryesondistit. Ndërkaq ishin mbledhur të gjithë aty. Ndodheshin edhe shokët e dërguar nga ministria. Naimi dhe Kujtimi qëndronin mbi platformë dhe po shihnin sondistët duke punuar.

— Unë them se këtë radhë çdo gjë do të dalë me sukses, — tha Naimi.

— Si the? — pyeti Kujtimi.

Ai dukej shumë i hutuar.

— Them se sot kam besim në fitore!

— Po, po, ashtu, edhe unë nuk dyshoj aspak, — foli me nxitim Kujtimi.

Sonda nisi të futej thellë e më thellë.

— Naim... tani... — dhe Agroni pa orën.

Edhe Naimi pa orën. Duheshin edhe disa sekonda që dalta të takonte te shkëmbi i fortë, që nuk çahej.

Sonda sikur u step ca, u dëgjua një sforcim në motor dhe pastaj nisi të bënte përsëri një zhurmë të zakonshme. Ajo u fut më tej.

— Kaloi, kaloi! — thirri Agroni dhe përqafoi fort Naimin.

Një «Urra!» e fortë u dëgjua në të gjitha anët. Ç'ishin aty nisën të përqafoheshin me njëri-tjetrin.

Kujtimi e mblodhi veten dhe iu afrua Agronit. I dha dorën:

— Të lumtë, fitove me këmbënguljen tënde.

— Duhej, Kujtim, patjetër. Por fitorja nuk më takon vetëm mua edhe ty, edhe Naimit, të gjithë shokëve punëtorë.

Kujtimi vuri paksa buzën në gaz dhe i shtriu dorën drejtorit, i cili po i uronte të gjithë me rëndësi.

Pas pak u shpërndanë një nga një. Mbi platformë mbetën dy inxhinierët dhe Naimi.

— Po tani? — pyeti Naimi.

— Tani mbetet faza përfundimtare: vendosja e aparaturës me valë për të sinjalizuar gjetjen e burimit të naftës. Ka mbetur, si të thuash, faza e tretë, — tha Agroni.

— Po, po, — foli si me vete Kujtimi, — ka mbetur tamam faza e tretë. Tani fillon ajo, dhe është më e rëndësishmja.

*
* *
*

— Tani fillon faza e tretë, — tha mister Xhoni, — dhe është kryesorja. Merrni të gjitha masat. Në mbrëmje, agjentët do të kalojnë tunelin artificial për të marrë letrën e agjentit «SD-1». Tani shkoni dhe pushoni.

Kur dolën ata, mister Xhoni u ul dhe nisi të shfletonte edhe një herë bllokun e tij të shënimeve. Mos ndoshta kishte harruar ndonjë gjë me rëndësi. I kontrolloi të gjitha shënimet me radhë. Nuk kishte harruar asgjë. Pas 24 orësh nuk do të ekzistonte më sonda detare Nr. 1. Dhe ai do të flinte të paktën një natë i qetë. Do të kishte mundësi të merrej edhe më shumë me të birin. Iu kujtua Henri, i cili ndodhej akoma në spital. E kishte shpëtuar nga çdo ndjekje e policisë, por tani duhej shpëtuar edhe nga drogat e shumta, që e kishin helmuar keq organizmin e tij. Rrëmbeu receptorin dhe formoi në videofon numrin e spitalit, Në ekran u duk mjeku.

— Mister Xhon, — tha mjeku, — mos u bëni merak. Jeta e djalit shpëtoi, vetëm se...

— Çfarë? — pyeti me frikë mister Xhoni.

— Vetëm se, ngaqë ka marrë shumë narkotikë, Henri yt nuk do të arrijë të shkëputet plotësisht prej tyre.

— Ashtu? — tha i menduar ai.

— Nuk është ndonjë gjë e madhe, — vazhdoi mjeku. — Te ne, shumica e të rinjve kështu janë: tërë kohën të narkotizuar.

— Gjene mirë, doktor, — tha më së fundi Xhoni. — Kjo është e keqja më e vogël. Faturën e shpenzimeve ma dërgoni në shtëpi.

Ai mbylli videofonin dhe u mbështet në kolltuk. Ishte shumë i lodhur.

* * *

— Sikur u dembelosëm, — tha Lanti dhe u ngrit në këmbë.

— Futemi, — ia ktheu Adi. — Kaloi mjaft kohë.

U veshën shpejt, e shpejt dhe u zhdukën nën ujë.

Notuan ngadalë. I erdhën rrotull anijes. Në kuvertë dalluan trupin e statujës. Nuk vunë re asgjë të dyshimtë në anije.

— Shkojmë te hambari, — tha Adi, — mos gjejmë ndonjë objekt tjetër.

Ata notuan drejt hambarit, por, megjithëse kërkuan gjatë, nuk gjetën gjë.

— Ndoshta ajo që gjetëm ka qenë e vetmja, — tha Adi.

— Nuk e besoj, — tha Lanti. — Ne ende nuk e kemi kontrolluar mirë tërë anijen.

Pak të mërzitur, ata u larguan nga hambari. Adi u drejtua te dera e kabinës. Pas tij shkuan edhe dy të tjerët.

— Më mirë të dalim, — tha disa herë Lanti. — Ku ta dish!

— Ja edhe pak, — foli Adi. — Të bëjmë një kontroll të imët.

— Mos harroni edhe porosinë e Anës, duhet t'i çojmë pinat që i kemi premtuar, — tha Lanti.

Gjergji, sikur të kishte marrë urdhër, u nis andej nga kolonia e pinave. Ai u afrua te shpella dhe në çast shtangu në vend.

— Adi, Lanti, ejani shpejt këtu. Jam te pinat! — thirri.

Ata notuan andej nga i thërriste Gjergji.

— Ç'pate, pse na thirre? — e pyeti Lanti, kur i shkuan pranë.

— Shikoni atje, — dhe Gjergji u tregoi pinat e shumta në faqen e majtë të shkëmbit.

Ata mbetën në vend të hutuar. Pak mbi pinat kishte qëndruar një goxha oktapod, i cili kishte hapur të tetë këmbët e tij dhe zinte kështu një hapësirë të madhe.

— Mos lëvizni! — tha Adi. — Tani do të shohim një gjë të mrekullueshme; me siguri oktapodi do të sulmojë ndonjë pinë.

— E çfarë do të ketë këtu të mrekullueshme? — pyeti Gjergji dhe bëri gati pushkën ta qëllonte oktapodin.

— Mos lëviz! — e ngriti zërin Adi. — Të tha-

shë prit; shiko njëherë, pastaj, po deshe, qëlloje.

Gjergji uli pushkën dhe të tre, ashtu pranë e pranë, nuk po ia ndanin sytë oktapodit. Nuk kaluan shumë sekonda dhe ajo kafshë e nëndetit shtriu dy nga tentakulat drejt shkëmbit dhe shkëputi fare lehtë prej faqes së tij një copë gur tërë myshk, pasi kontrolloi një pjesë të mirë të sipërfaqes. Gurin e shkëputi nga një e çarë shkëmbi aty pranë. Pasi e mbështolli mirë gurin në tentakulat e tij, i tërhoqi ato pranë vetes, poshtë trupit. Aty ku më parë ishte guri, u formua tani një e çarë. Dukej sikur ai gur ishte vënë aty për të mbyllur të çarën e shkëmbit nga ndonjë dorë njeriu.

— Ç'ka ndër mend të bëjë me atë gur? — pyeti me çudi Gjergji.

— Mos u tremb, se nuk do të na qëllojë ne, jo, — u tall Lanti.

— Hë mo dhe ti njëherë, pse flet kështu? Unë nuk u tremba.

— Jo, po mos kujtove se oktapodi mund të përdorë edhe armë, — vazhdoi Lanti me të tijën.

— Ai gur është tamam një armë për të, — ndërhyri Adi.

— E nga e di ti? — pyeti Lanti.

— Shikoni me kujdes, diçka kam dëgjuar për gjuetinë e oktapodit; atë gur nuk e ka marrë kot ai

Oktapodi, me gurin të mbërthyer, lëvizti fare pak dhe u gjend kështu mbi pinat e shumta. Ato, që as e parandienin se mbi to po vërtitej një rrezik vdekjeprurës, kishin hapur buzët e tyre dhe vazhdonin të ushqeheshin me planktonet e shumta, mikroorganizma pa mbarim, që jetojnë nën ujë.

Njëra nga pinat, ajo që ndodhej pikërisht nën trupin e oktapodit, ishte më e madhja dhe buzët e saj ishin hapur shumë. Siç dukej, asaj ia kishte vënë syrin edhe kafsha e detit.

Djemtë, duke vëzhguar lëvizjet e ngathëta, por të sakta, të oktapodit, po shihnin tepër të habitur. Në një çast oktapodi hapi tentakulat dhe guri që fshihej midis tyre u lëshua me shpejtësi nga lart drejt e te buzët e pinës dhe zuri vend ndërmjet tyre. Pina, sado që u mundua t'i mbyllte buzët, siç bënte sa herë ndiente rrezik, këtë radhë nuk ia arriti. Guri i hedhur me mjeshtëri nga oktapodi e pengonte. Pastaj u bë një turbullirë e vogël, që u kthjellua shpejt. Oktapodi, me të parë që pina nuk mund të mbyllej më, u sul dhe futi brenda butakut tentakulat e tij. Pas pak nxori që andej mishin e butë të pinës dhe, sa hap e mbyll sytë, e kullufiti të tërë. Pina tashmë nuk ishte veçse një guackë.

— Ah, egërsirë dinake! — thirri me inat Gjergji dhe qëlloi me pushkën pneumatike oktapodin.

Sikur të kishte qëlluar një shishe me bojë shkrimi dhe jo një kafshë, sa hap e mbyll sytë, gjithë ai vend erdh e mori një ngjyrë blu. Oktapodi, për të humbur gjurmët, kishte lëshuar lëngun që e mbronte nga armiqtë e shumtë. Por ky lëng nuk mund ta mbronte kurrsesi nga pushka e Gjergjit. Kur u kthjellua uji, Gjergji pa se oktapodi ishte goditur dhe po mundohej të futej me vështirësi në të çarën e shkëmbit, që e kishte hapur vetë, pasi kishte hequr gurin. Po nuk kishte ku të shkonte. Në trupin e tij, thellë, ishte futur shigjeta e Gjergjit, i cili nisi ta tërhiqte me forcë. Oktapodi, kur

i vendos tentakulat në shkëmb, nuk ka forcë që ta shkulë, por tani ai ishte i plagosur dhe nuk kishte fuqi për të bërë një gjë të tillë.

— Sa të shkul unë oktapodin, — tha Gjergji, — ju merrni pina për Anën. Mos harroni pinën e madhe, që gllabëroi kjo egërsirë.

Adi dhe Lanti u zhytën më poshtë dhe nisën të shkulnin pinat. Gjergji vazhdonte të tërhiqte me forcë shtizën. Oktapodi e lëshoi një këmbë nga shkëmbi, më pas një tjetër. Tani ishte dobësuar fare. Gjergji iu afrua edhe më dhe e tërhoqi me forcë. Kur oktapodi ngordhi, Gjergji futi dorën në të çarën e shkëmbit, e përmblodhi mirë dhe pastaj e nxori jashtë. Ishte një oktapod tepër i madh. Një të tillë Gjergji vetë nuk e kishte parë nën ujë.

Në atë faqe shkëmbi kishte shumë të çara të tilla, si ajo ku donte të fshihej oktapodi. Në to hynin e dilnin peshq të ndryshëm.

«Do ta shoh edhe në ëndërr atë peshk me katër sy», — tha me vete Gjergji sapo i ra ndër mend Bleniusi. Duke parë gjithë ato të çara në shkëmb, i shkoi ndër mend se mos aty fshihej ndonjë Blenius. Me elektrikun e dorës nisi të ndriçonte me radhë të çarat. Peshqit, të trembur, dilnin me shpejtësi ose futeshin më thellë në errësirë.

— Gjergj, eja. Do të dalim, — dëgjoi në kufje zërin e Adit.

— Erdha, — u përgjigj ai dhe ndriçoi edhe një të çarë tjetër. Rrezet e elektrikut të dorës reflektoan në diçka metalike. Futi thellë dorën dhe nxori prej andej, për çudinë e tij, një kuti të vogël.

— Këtu, këtu! — thirri Gjergji.

Adi me Lantin i shkuan pranë.

— Po kjo, ç'të jetë kjo? — pyeti me habi Lanti.

— Dhe qenka fare e re. Do të jetë lënë këto ditë, — vazhdoi Adi.

— Dalim, shokë, — tha Lanti. — Këtu është me rrezik të qëndrojmë më shumë.

Kur dolën në breg, u munduan ta hapnin kutinë. Mezi e hapën. Aty gjetën një letër.

— Hape, lexoje! — thirri gjithë padurim Gjergji.

Lanti u mundua ta lexonte, po nuk po merrte vesh asgjë. Ishte në gjuhë të huaj.

— Dale, dale, ma jepni mua.

Adi e pa një copë herë e pastaj tha me gjysmë zëri:

— Shokë, kjo letër duhet të jetë vënë nga ndonjë agjent i huaj!

— Nga e more vesh, çfarë lexove? — pyeti Gjergji.

— Nuk lexova asgjë, por shikoni me kujdes midis shifrave dhe shkronjave të pakuptueshme lexohet qartë tri herë «SD-1».

— SD-1?

— Po pra, a nuk është sonda detare Nr. 1, që pamë dje te babai?

— Pooo! Tamam ashtu është. Sonda qenka në rrezik, — tha Lanti. — Unë them të shkojmë te shoku Ilir. Ai e di vetë ç'bën pastaj.

Pas gjysmë ore ata ndodheshin te zyra e shokut Ilir. Ai lëvizte nëpër zyrë dhe shihte me vëmendje të tre djemtë fare pa folur. Fliste me vete:

«Ashtu pra... nuk ka asnjë dyshim... armiqtë synojnë të hedhin në erë sondën... Kjo informatë e re e forcon më shumë dyshimin tonë për këtë aksion të armiqve».

— Tani dëgjoni me kujdes. Deri në një urdhër të dytë, ju ndaloj rreptësisht të zhyteni tek anija e mbytur. Dhe e fundit: asnjë fjalë me asnjeri për këto gjëra.

— Mos kini dyshim, ju premtojmë, — tha me vendosmëri Adi.

— Po kur do të futemi përsëri te anija? — tha Lanti. — Të shtunën organizohet një takim i arkeologëve të nënujit dhe ne duam të raportojmë atje.

— Kini durim, do t'ju njoftoj shpejt. Do të vij edhe unë me Agronin me ju e do t'i marrim të gjitha amforat.

Ata u bënë gati të ngriheshin.

— Shkoni, shkoni, — tha Iliri dhe hodhi sytë te kutia që kishin gjetur fëmijët.

Iliri e mori në dorë dhe, pasi e pa një copë herë, hapi një sirtar dhe u mat ta fuste brenda. Nuk arriti ta vendoste mirë në sirtar, kur Adi kërceu menjëherë, sikur ta kishte pickuar ndokush.

— Shiko, shiko, edhe shoku Ilir paska orëbusull si e shokut Kujtim!

Lanti me Gjergjin u afruan dhe thanë me çudi:

— Qenka tamam si ajo.

Këtë radhë po i shikonte Iliri me çudi. Ai ishte ngritur nga vendi dhe, duke ia ngulur sytë Adit, pyeti:

— Si e kujt thatë, kush ka tjetër një busull të tillë?

— Shoku Kujtim, — tha Adi. — Ai kishte një të tillë atë ditë kur u zhýt me ne tek anija e mbytur.

— Po ne këtë busull... ne jse... domethënë kështu... — Iliri nisi të mendohej.

— Atë ditë që u zhytët me Kujtimin tek anija, — foli si i menduar Iliri, — tërë kohës me ju qëndroi ai?

— Po, — thanë të tre njëzëri.

— Nuk u largua asnjë çast?

Fëmijët u menduan.

— Posi, u largua, — tha Adi. — Disa minuta bile, pastaj na erdhi me një amforë të gjetur.

— Mirë, mirë, shkoni tani, — tha Iliri.

Djemtë u përshëndetën me Ilirin dhe u larguan. Ai mori letrën në gjuhën e huaj, e mbylli mirë në kutinë metalike që kishin gjetur fëmijët, dhe thirri një oficer.

— Këtë kuti, pasi ta fotografoni, duhet ta vendosni menjëherë atje ku e gjetën fëmijët. Djemtë kanë rënë rastësisht në gjurmë në po atë vend ku ne po ndjekim prej ditësh armiqët. Agjentët e huaj nuk duhet të kuptojmë se dikush ka qënë atje. Sa për busullën e gjetur në Shpellë, çdo gjë u sqarua. Dyshimi është i drejtë. Një orë të tillë ka pasur Kujtimi dhe tani nuk e ka më. Këtë e vërtetuan edhe fëmijët. Qartë?

— Po, — tha oficeri dhe doli.

Sapo ishte ngrysur. Errësira po mbulonte çdo gjë. Në breg të detit në plazh, ishin ndezur me kohë dritat. Në pistën e vallëzimit dëgjoheshin tingujt e gëzueshëm të një melodie. Në këtë kohë Iliri, Besniku dhe Arbeni kishin hipur në një motoskaf dhe lëviznin qetë-qetë në brigjet e Currilave. Dukeshin sikur kishin dalë për shëtitje. Besniku, gjatë gjithë kohës, mbante në vesh kufjet. Pas pak ora shkoi 20.00 dhe nuk kishte asnjë njoftim. Iliri hodhi sytë nga bregu. Nuk vuri re asgjë. Errësira nuk lejonte të shihje larg. Po të kishte mundësi të ndriçonte bregun, ai do të shihet, pak metra tutje plazhit, buzë një shkëmbi, një njeri veshur me kostum aktualangu të zhytej nën ujë. Por nuk dalloj gjë.

Pa orën dhe ia nguli sytë Besnikut. Ai mban-te me kujdes kufjet te veshi. Pas pak u ngrit.

— Shoku Ilir, doli, — tha:

Iliri rrëmbeu kufjet.

— Jam Iliri.

— Shoku Ilir, para pesë minutash një njeri me aktualang erdhi në shpellë dhe tani sapo u largua.

— E njohët? — pyeti Iliri.

— Ishte e pamundur, nuk mund të ndiznim projektorët.

— Mirë, — tha Iliri, — pritni edhe dhjetë minuta; në qoftë se nuk do të ketë lëvizje tjetër, futuni në shpellë, kërkoni dhe, po të gjeni gjë, ma sillni mua. Ndodhem mbi ju, me motoskaf!

— Si urdhëron, — u përgjigj zëri dhe lidhja u ndërpre.

Iliri ia dha kufjet Besnikut dhe vetë doli në kuvertë. Sytë ia nguli orës. Minutat po shkonin shumë ngadalë. Edhe pak çaste. Kur u mbushën plot njëmbëdhjetë minuta, mbi ujë, pranë motoskafit doli një njeri i veshur me akualang. U ngjit në kuvertë dhe i zgjati diçka Ilirit. Ai e hapi kutinë dhe brenda gjeti një letër tjetër. Pasi lexoi gjithçka, e fotografoi dhe e mbylli përsëri letrën në kuti. Ia dha akualangistit.

— Vendoseni përsëri aty ku e morët e pastaj ngjituni në motoskaf, Do të largohemi.

E PREMTE 8 KORRIK 2044

Iliri, së bashku me dy shokë, arriti në Akademinë e Shkencave sapo kishte filluar dita e re e punës. Ata u futën drejt e te kryetari.

— Shoku kryetar, kemi ardhur për rrjetën valore të kufirit detar.

— Pse, — pyeti kryetari, — mos ka ndodhur defekt?

— Jo, defekte nuk ka, por, — heshti pak e pastaj vazhdoi: — Por sekret i saj është zbuluar nga armiqtë, të cilën e kanë kaluar disa herë.

— Dhe aparaturat tona nuk kanë sinjalizuar?
— pyeti kryetari.

— Jo, — tha Iliri. — Kemi fakte të sigurta që ajo është kaluar.

Kryetari u mendua një çast.

— Domethënë ata kanë kaluar dhe do të kenë bërë ndonjë punë armiqësore, apo jo?

— Ende jo, — tha Iliri, — por puna është që ata të mos kalojnë përsëri.

Kryetari u mendua një copë herë. Iliri dhe të dy shokët po e shikonin me vëmendje. Kur ishte vendosur rrjeta valore, një shkencëtar kishte propozuar që të bëhej një rrjetë e dyfishtë, me kahje të kundërt. Kjo gjë iu kujtua kryetarit.

— Kështu pra, — tha, — ata e çanë rrjetën, por nuk do ta çajnë më. Ne do ta dyfishojmë. Aparatet janë gati prej kohësh, por koha, ajo na mungon, — shtoi kryetari, — kur ju duhet?

— Ndoshta nesër, ndoshta pasnesër!

— Që tani po jap urdhër. Do të përpiqemi ta bëjmë sa më shpejt.


Iliri me shokët u ngritën dhe, pasi u përshëndetën me kryetarin, dolën jashtë. Në rrugë i prishte vetura. Ata zunë vend dhe ajo u nis me shpejtësi për në Durrës.

Kur mbërritën në kantierin e sondës detare, Iliri u fut me nxitim në zyrën e drejtorit.

— Eja, Ilir, — tha gjithë gëzim ai sapo e pa. — Ke ardhur tamam në kohë. Shkojmë nga son-
da.

— Çfarë bëhet atje? — pyeti Iliri.

— Në qoftë se çdo gjë ka shkuar mbarë, ti do ta shikosh vetë naftën të rrjedhë nëpër tuba.



Ilirit i qeshi fytyra. Mundi e djersa e punëtorëve dhe e inxhinierëve po jepte frytin e vet, naftën që do ta fuqizonte edhe më tej atdheun në 100-vjetorin e çlirimit të tij dhe të fitores së revolucionit popullor. Tashmë të gjitha pengesat ishin kaluar, megjithëse dikush andej matanë ende luftonte e përpiquej për të shkatërruar gjithçka, për t'ia prerë rrugën naftës drejt sipërfaqes.

Agroni jepte porosinë e fundit dhe lëvizte nga të gjitha anët. Të gjithë vinin e pyesnin për diçka. Dhe ai shkonte e shihte në vend. Ishin masat e fundit dhe nuk lejohej tashmë asnjë nënvleftësim. Pas pak, sonda do të fillonte të shponte metrat e fundit dhe në tuba, ah, sa kishin luftuar ata që nëpër këta tuba të gurgullonte nafta.

Iliri e përshëndeti për së largu me dorë Agronin. Edhe ai ia ktheu përshëndetjen po ashtu dhe vazhdoi punën.

— Është lodhur shumë këto ditë, — tha drejtori.

— Nuk arrihet gjë pa lodhje, — shtoi Iliri, — të gjithë jeni lodhur. Por nuk do të kalojë shumë kohë dhe nuk do ta ndjeni lodhjen, do t'jua heqë nafta si pas një dushi me ujë të freskët.

Drejtori qeshi.

— Të them të drejtën, Ilir, — tha drejtori, — disa herë dyshoja.

— Përse? — vuri buzën në gaz Iliri.

— Po ja, gjithë ato të papritura, pengesa të paparashikuara, ndërsa fundi i javës po afronte. S'ka gjë më të keqe kur nuk mbahet fjala e dhënë.

— Punëtorët e mbajnë gjithnjë fjalën, — qeshi Iliri. — Siç e sheh, pengesat po kalohen.

Mister Xhoni ishte tërë qejf. Shkonte e vinte nga njëri cep i kabinetit në tjetrin, duke thithur fort puron e tij. Herë pas here sikur i vinte të këndonte.

«Ç'e kam sot gjithë këtë gëzim?» — pastaj iu kujtua se para pak minutash e kishin njoftuar se Henri mund të dilte nga spitali. Gjendja e tij shëndetësore ishte përmirësuar pak.

Pasi të përfundonte me sukses operacioni «Gjarpri i detit», ai kishte vendosur të merrej edhe më shumë me djalin e vet.

Qëndroi një copë herë përpara dritares me xhama të mëdhenj sa një faqe muri. Në rrugë, poshtë tij, veturat e shumta mezi arrinin të kalonin përmes gjithë atyre udhëkryqeve.

Nisi të fërshëllente me zë të ulët një melodi të vjetër.

«Operacioni «Gjarpri i detit», — mendoi, — hyn sot në fazën finale. Ma mori të keqen edhe sonda detare Nr. 1».

Mendoi me radhë të gjitha nderet e fitimet që do të kishte nga ky operacion i suksesshëm. Shpërblimi me siguri do të ishte i lartë dhe do të vinte në vend harxhimet e shumta që kishte bërë për Henrin. Pas kësaj do të kishte mundësi të pushonte për pak kohë; do t'i pëlqente të shkonte në ndonjë vend malor, sa më larg detit. Deti sikur e kishte mërzhitur ca kohët e fundit.

Pa orën. Ishte koha kur duhej të vinin të gjithë ata që kishin hartuar dhe zbatuar deri në kë-

të fazë planin e operacionit «Gjarpri i detit». Mister Xhoni u ul në poltronë dhe thithi me kënaqësi puron.

Ata u futën një nga një dhe u ulën nëpër poltrone. Mister Xhoni u dha të gjithëve nga një puron. Këtë gjë nuk e kishte bërë ndonjëherë, ndaj në fillim ata u çuditën, por pastaj e kuptuan se shefi i tyre ishte në qejf. Edhe ata sikur e ndjenë këtë kënaqësi të shefit dhe ndenjen më lirshëm nëpër poltrone.

Pas pak, mister Xhoni nisi të fliste:

— Zotërinj, erdhi më në fund edhe ora që ne të vjelim frytet e punës sonë të lodhshme. Sot do të hyjë në funksionim faza e fundit e operacionit «Gjarpri i detit» për hedhjen në erë të sondës detare shqiptare Nr. 1. Dy agjentët tanë, të specializuar për kalimin e tunelit artificial, do të kalojnë sot për të fundit herë kufirin detar shqiptar. Pasi të takohen nën ujë me agjentin tonë «SD-1», do të vendosin minën speciale në vendin e caktuar, nën sondë, dhe do të largohen të tre drejt anijes sonë, jashtë kufirit.

Në orën e caktuar nga ne, pikërisht atëherë kur do të bëhet inaugurimi, nga anija jonë, që ndodhet pranë kufirit detar shqiptar, do të lëshohen rrezet e duhura, që do të komandojnë minën, e cila do të plasë pikërisht kur ata do të kujtojnë se arritën fitoren. Suksesi do të jetë i plotë. Unë nuk do të vij me anije në detin Adriatik, por do të mbani lidhje me mua këtu, në kabinet. Kur të ktheheni, ju presin shpërblime të mëdha.

Ata u ngritën dhe, si në një ceremoni zyrtare, i dhanë dorën me radhë mister Xhonit. Pas pak,

kabineti ra në qetësi dhe mister Xhoni u mbësh-
tet në poltronë.

* * *

— Gati, — foli Agroni. — Kontrolloni çdo pa-
jisje!

Nuk u dëgjua më asnjë zë. Mbi platformë ishin
mbledhur shumë njerëz. Iliri qëndronte pranë drej-
torit.

Kontrolli kishte mbaruar dhe Agroni ngriti do-
rën përpjetë. Kryesondisti ia nguli sytë dorës së
Agronit. Naimi iu afrua butonëve të valëve. Ag-
roni e uli dorën dhe kryesondisti, me një lëvizje
të shpejtë, uli levën e komandimit. U ndie një
zhurmë e lehtë. Sonda nisi të përparonte. Pas di-
sa çastesh Agroni thirri:

— Naim!

Naimi shtypi butonin dhe pa me shpejtësi orën.
Duheshin edhe katër minuta. U largua nga buto-
ni dhe iu afrua Agronit.

— Si ndihesh? — e pyeti.

— Nuk di ç'të them, — u përgjigj Agroni.

— Kurse unë jam shumë i qetë, — tha Naimi.

— Çdo gjë është llogaritur me saktësi.

Agroni nuk po ia ndante sytë orës.

Atë çast u dëgjua një zë i fortë:

— Nafta... nafta...

Vrapuan të gjithë drejt tij, në hyrjen e tubit
kryesor, një pjesë e të cilit ishte ndërtuar prej qel-

qi për të parë naftën. Nëpër të rridhte me shpejtësi një lëng i zi, i trashë.

— Naftë!... Naftë!... — thirri me të madhe Agroni dhe përqafoi të parin njeri që ndeshi pranë vetes. Pastaj përqafoi tjetrin... tjetrin...

Pastaj iu hodh në qafë Ilirit.

— Mua më përqafove një herë, — tha me të qeshur Iliri.

— Ashtu? — u çudit Agroni. — Epo mirë, ia vlen të të përqafoj dy herë.

Qeshën të gjithë. Në fytyrat e tyre shkëlqente një gëzim i madh. Bënin ç'bënin dhe hidhnin sytë nga tubi i naftës.

— Merrni pak naftë për analizë dhe dërgojeni në laborator, — tha Agroni. Sytë i zunë drejtorin.

— Shoku drejtor, — tha me gëzim, — mendoj se mund ta inaugurojmë sondën kur të dëshironi.

— Ashtu mendoni? — qeshi drejtori. — Epo mirë, edhe unë jam në një mendje me ju.

Ata u përqafuan persëri.

— Të lumtë, Agron! — i tha drejtori.

— Kjo fjalë nuk më takon vetëm mua, — ia ktheu Agroni.

— E di, e di, punuan e u lodhën të gjithë. Kur të përqafoj ty, përqafoj gjithë kolektivin.

Iliri iu afrua Besnikut dhe Arbenit, që qëndronin pak më tutje.

— Të dyfishohen rojat, — tha. — Bëni shumë kujdes. Tani që u arrit sukcesi, duhet të jemi më shumë vigjilentë.

Ata pohuan me kokë dhe u larguan. Njerëzve sikur nuk po u ikej nga sonda.

Nga apartamenti i Anës vinte një zhurmë zë-rash. Dallohej zëri i saj.

— Sikur ju të gjeni në atë anije «kalorësin prej bronzi», do të jetë një sukses i mrekullueshëm.

— Ç'është ky kalorës? — pyeti Gjergji.

— Kam lexuar në një revistë, — vazhdoi Ana, — se në hyrje të qytetit të Durrësit, në kohën e shtetit të fuqishëm të ilirëve ishte ngritur një statujë e lartë prej bronzi, që paraqiste një kalorës ilir. Ishte e mrekullueshme thonë studiuesit. Kushdo që e shihte, mbetej i mahnitur. Por pastaj shteti i ilirëve u dobësua, e gjithë Iliria ra pak nga pak pas luftërave të shumta nën sundimin romak. Pushtuesit, si çdo gjë tjetër, vodhën e grabitën në vendin tonë edhe veprat e artit. Arti i ilirëve ka qenë shumë më i lashtë se i romakëve, dhe romakët mësuan nga ilirët. Edhe ajo statujë pësoi po këtë fat. E rrëmbyen romakët dhe e nisën për në vendin e tyre. Po statuja nuk arriti atje. Asnjëherë nuk u mor vesh ç'u bë ajo. Ka mendime se anija që transportonte atë statujë mund të jetë mbytur nga sulmet e shpeshta të ilirëve. Po sikur të jetë pikërisht anija që keni zbuluar ju?

— Të jetë vërtet ajo? — pyeti Lanti.

Ishte skuqur në fytyrë.

— Ku ta dish! — tha Ana.

— Ah, sikur ta gjejmë, — ndërhyri Adi, — do ta vendosim përsëri në të njëjtin vend.

— Unë them se do ta gjejmë, — tha me vendosmëri Gjergji.

— Ti, Gjergj, gjithmonë je shumë i bindur, shumë i vendosur, — foli Lanti. — Kështu the edhe për Bleniusin me katër sy.

— Po kam dëshirë, ore, — ia ktheu Gjergji me të qeshur.

— Dëshirë kemi të gjithë, — iu drejtua Ana. — Por sa anije janë mbytur në bregdetin tonë?

Iliri kishte qëndruar te dera dhe vetëm kur u përmend emri i Gjergjit, e kuptoi se kush ndodhej atë çast te shtëpia e Anës. I ra ziles dhe priti.

Derën e hapi Ana.

— Eja, — i tha, — kemi miq.

— E mora vesh. Ata bërtasin aq shumë, sa që dëgjohet në rrugë.

Djemtë qeshën.

— E, si shkon plazhi? — pyeti me të qeshur Iliri.

— U kënaqëm me rreze, — tha Adi.

— Shumë mirë, shumë mirë. Ju bën mirë për lëkurën, se rrezet e diellit aktivizojnë vitaminën D.

Fëmijët deshën të qëndronin serioz, por nuk mundën. E rrethuan Ilirin dhe, gati me një zë, pyetën:

— Mbaroi?

— Kush? — pyeti ai.

— Ajo puna, pra, që na pengoi të zhytemi tek anija?

— Nuk di unë nga këto punë, — tha Iliri. — Unë di të them vetëm se para pak çastesh sonda detare Nr. 1. dha naftë!

Djemtë kërcyen nga gëzimi.

— Vërtet, Ilir? — pyeti Ana. — Si nuk u ndo-
dha edhe unë!

— Do të jesh kur të bëhet inaugurimi.

— Po babai ku është? — pyeti Adi.

— Ju pret në hotel. Sonte është i lirë, kësh-
tu që mund të merret me ju.

— Po nesër, ç'do të bëjmë. ne? — e pyeti
Lanti.

— Nesër unë, Agroni dhe Ana do të jemi me
ju.

— Do të zhytemi nesër? — pyeti me gëzim
Lanti.

— Patjetër. Prandaj sot pushoni mirë që të
keni forca. Do të gjejmë edhe kalorësin e Anës.

— Kalorësin e Anës? — u çuditën ata.

— Kalorësin prej bronzi që ju tregoi Ana.

— Ilir, mos u tall, — tha Ana. — Ata kanë
bërë vërtet një zbulim të madh.

— Bëj shaka. Nesër, pra, që me mëngjes, në
orën 8.00, gati për zhytje, — iu drejtua djemve
Iliri.

* * *

Sa herë kalonin nën urën e madhe të Gjibraltarit, ata talleshin me rojat. Lëshonin ndonjë rreze të shkurtër dhe pastaj binin në qetësi. Aq mjaftonte që lart, në urë, të jepej alarmi. Aparatet jepnin shenjë se diçka po kalonte nën urë. Por pastaj nuk kapnin më asgjë. As sateliti nuk njoftonte gjë.

Anija speciale e mister Xhonit, pasi bëri lojën e zakonshme në Gjibraltar, u fut në Mesdhe e lundroi me shpejtësi. Ja edhe Adriatiku. Kur arritën përballë qytetit të Durrësit, qëndruan dhe u bënë gati për të çarë rrjetën valore. Kapiteni u lidh me mister Xhonin.

— Mister Xhon, ju flasim nga anija. Ndodhemi në vendin e eaktuar. Jemi gati të lëshojmë agjentët.

— Fare mirë, — u dëgjua zëri i gëzuar i mister Xhonit. — Filloni!

Kapiteni shtypi butonin e sinjalit të alarmit. Pas pak, të gjitha aparatet u vunë në punë. Kapiteni iu drejtua ekranit nga do të dukeshin dy agjentët me minën speciale. U dëgjua një sirenë e mprehtë, e shkurtër dhe në ekran u dukën dy agjentët duke notuar.

Ata u zhdukën tutje, në errësirën e ujit të thellë të detit.

— Zoti kapiten, — u dëgjua zëri i agjentit të parë në radio. — Kudo është qetësi e madhe. Po i drejtohem shpellës.

— Qetësi do të jetë, — tha kapiteni. — Në këtë orë nuk lëviz asnjëri në këtë thellësi. Sidoqoftë, kujdes. Po qe se ndokush do t'ju pengojë, asgjësojeni.

Kapiteni u ul në poltronë, duke mbajtur sytë nga ekranin. Kot po shihte tani andej. Kthimi i tyre do të vononte ca; derisa të vendosnin minën e të bënin gjithë atë rrugë për t'u kthyer, do t'u duhej ndoshta të kalonte një orë.

— Zoti kapiten, ja edhe shpella. Si gjithnjë, qetësi, — dëgjoi kapiteni.

— Afrohuni pranë! Pritni aty sa të vijë agjenti «SD-1».

Minutat po kalonin mengadalë.

«A nuk mund të lëviznin më shpejt këta akrepa? — mendoi kapiteni. — Çdo goditje e zemërekut të sahatit sikur më godet kokën. Të mbarojmë sa më shpejt... sa më shpejt... sa më shpejt...»

— Zoti kapiten, më duket se dikush po afrohet, — u dëgjua zëri i agjentit.

— Ai duhet të jetë; veproni shpejt! — Kapiteni ishte ngritur në këmbë nga padurimi. — Kur të takoheni, më njoftoni e pastaj nisuni drejt sondës.

— Si urdhëron, — u dëgjua zëri i agjentit, — zoti kap... zo....

Një thirrje alarmi, frike u dëgjua nga kufjet e kapitenit dhe pastaj asgjë.

— Fol, çfarë ngjau, fol! — thirri me të madhe kapiteni.

Në kufje nuk po dëgjohej asgjë.

— Fol, këtu kapiteni i anijes, çfarë ndodhi? — Ulërima e kapitenit u dëgjua qartë në të gjithë anijen.

Në kabinë u fut me vrap një djalë i ri.

— Zoti kapiten, — tha ai, — u ndërpre lidhja.


— Pse, kush e preu, pse?...

Radisti ngriti supet.

— Mos është defekt? — pyeti ai pas pak.

— Defekt... nuk ka mundësi. Kontrolloni aparatet!

Ato punonin shumë mirë. Kapiteni u zverdh në fytyrë dhe u ul i dërrmuar në kolltuk. Sytë, si edhe më parë, i mbetën nga ekrani nga priste agjen-



tët. Ndenji një copë herë ashtu, pastaj shtypi butonin dhe kërkoi lidhje me mister Xhonin.

— Mister Xhoni jam, — u dëgjua zëri i tij.

— Lidhja me agjentët tanë, që kaluan rrjetën, u ndërpre, — foli kapiteni me gjysmë zëri.

— Si?! — bërtiti me të madhe mister Xhoni.
— Pse u ndërpre?

— Ndoshta është defekt, — tha kapiteni, — ndoshta...

— Çfarë ndoshta?

— Nuk e di. Në fjalët e fundit m'u dukën shumë të shqetësuar.

— Rrjeta, u kalua me sukses rrjeta? — pyeti mister Xhoni.

— Po, si gjithmonë, — u përgjigj kapiteni.

— Dërgoni me urgjencë agjentët rezervë, — thirri përsëri mister Xhoni, — dhe mos e ndërpritni lidhjen. Dërgojini shpejt!

Agjentët rezervë u përgatitën në çast. Kapiteni dha sinjalin dhe hodhi sytë nga ekrani. Agjentët rezervë u dukën aty dhe iu drejtuan ujërave të Shqipërisë.

Kapiteni po ndiqte çdo gjë me vëmëndje të përqendruar. Agjentët aktualangistë vazhdonin të notonin me kujdes. Edhe pak metra dhe ata do të hynin në ujërat e Shqipërisë.

— Kaluan, — tha kapiteni dhe mori një herë frymë thellë, megjithëse ishte shumë i tendosur.

— Mbani vazhdimisht lidhje me radio! — urdhëroi kapiteni.

— Po, po, — u përgjigj njëri nga agjentët rezervë. — Deri tani çdo gjë është në rregull.

— Notoni drejt Shpellës së Peshkaqenit dhe

mundohuni të merrni vesh ç'u bë me agjentët e tjerë, lidhuni me ta dhe na njoftoni.

— Si urdhëron. Këtej sundon një qetësi e jash-tëzakonshme. Po i afrohemi bregut dhe nuk po shohim asgjë të veçantë.

— Me siguri lidhja me të parët do të jetë prerë nga ndonjë defekt, — tha disi i lehtësuar kapiteni.

— Notoni me shpejtësi drejt shpellës. Aty me siguri do t'i gjeni ata. Sapo t'i takoni, ju të dy kthehuni, — urdhëroi kapiteni.

— Si urdhëron, do të kthehemi shumë shpejt. Bile unë mendoj... zoti kapiten... zo... ten...

— Çfarë, çfarë, flisni, çfarë ndodhi? — Zëri i kapitenit u dëgjua me ulërima.

Ai priti pak, por heshtja po e tërbonte. Provoi përsëri, por asgjë nuk u dëgjua. E përplasi receptorin në tryezë dhe u lëshua i dërrmuar në poltronë. Tashmë çdo gjë ishte e qartë. Kapiteni vuri duart në kokë. Shqiptarët kishin zbuluar çdo gjë dhe askush nuk mund të hynte pa u kapur nëpër rrjetën valore.

Mezi arriti të mblidhte veten.

«Të paktën ne jemi gjallë», — mendoi me vete. Mori receptorin dhe tha me një zë të rëndë e të trashë:

— Mister Xhon, rrjeta valore e shqiptarëve është e pakalueshme.

— Çfarë thua? — u dëgjua zëri i ngjirur i mister Xhonit. — Nëpër tunelin artificial nuk kalohet më?

— Kalohet, — foli si me përtim kapiteni, — por agjentët, sapa bëjnë një pjesë të rrugës, bien në rrjetat e sigurimit shqiptar.

— Nuk është e mundur. Do të ketë defekt ndërlidhja. Agjentët tanë po veprojnë, kurse ju shihni ëndrra me sy hapur! — buçiti zëri i mister Xhonit.

Kapiteni nuk u përgjigj.

«Ndoshta është e vërtetë që agjentët veprojnë dhe ka defekt ndërlidhja», — mendoi ai.

— Kontrolloni aparatet!

— Janë fare në rregull, — iu përgjigj kapiteni mister Xhonit.

— Tani nuk mund të bëjmë asgjë, — tha i dërrmuar më në fund mister Xhoni. — Ndoshta është defekt. Pritni deri në orën e caktuar për kthimin. Po që se nuk vijmë, nisuni për në bazë.

— Po agjentët tanë që janë futur brenda?

— Ata e dinë detyrën: do të vendosin minën në vendin e caktuar.

— Por nuk mund ta kalojnë më kufirin detar të Shqipërisë, se do të kapen nga sigurimi shqiptar.

— Fati i tyre tashmë është vendosur, — ia ktheu mister Xhoni. — Po që se sonda hidhet në erë, humbja e agjentëve nuk është ndonjë gjë e madhe.

Kapiteni nuk e hapi më gojën. Nuk kishte ç'të thoshte. Edhe ai mendonte se do të kishte ndonjë defekt. Fundi i agjentëve tashmë dihej: ata nuk mund të dilnin më kësaj ane. Po të paktën të hidhej në erë sonda. Megjithatë, dyshimi se mos ishin kapur, nuk e linte të qetë. Ç'të ketë ndodhur vallë? As që mund ta merrte me mend. Priti shumë, pritë edhe më shumë nga ç'duhej.

Ishte i lodhur. Pasi dha urdhrin e nisjes, u

shtri në kanape. Pas pak, kur kaluan urën e Gjibraltarit, askujt nuk i ra ndër mend të bënte ndonjë shaka me rojat e urës e të ngushticës.

* * *

Përballë tryezës së punës të Ilirit po rrinte në këmbë Besniku.

— Çfarë po bën inxhinier Kujtimi? — pyeti Iliri.

— Është në hotel. Po përgatitet për t'u zhytur në ujë.

Iliri pa orën. Ishte vonë.

— Deri tani është zhytur dy herë, — sqaroi Besniku, — por po përgatitet të hyjë përsëri. Shpreson se do t'i gjejë agjentët.

— Mirë, — tha Iliri, — lëreni të zhytet sa herë të dojë. Veç kontrollojeni në çdo veprim, edhe nën ujë. Tani më sill ata bukuroshët!

Në zyrën e Ilirit u futën katër djem rreth 30 vjeç. Iliri iu drejtua në gjuhën e tyre. E fliste fare pastër.

— Pra, këtë minë, — dhe tregoi minën në tryezë, — ju do ta vendosnit te sonda, që ajo të shpërthente!

Ata pohuan me kokë.

— Po kush do t'ju drejtonte te sonda? — pyeti Iliri.

— Agjenti ynë që vepron këtu, — tha njëri.

— Si quhet ai? — pyeti përsëri Iliri.

— Ne e njohim me emrin agjenti «SD-1».

— Kurse ne e njohim me të gjithë emrat që ka e ka pasur, — tha Iliri. — Merri, — iu drejtua Besnikut.

Besniku i mori me vete dhe u kthye pas pak.

— Po tani, shoku Ilir?

— Tani më duhet të file pak; po shtrihem, këtu, në kanape.

— E pse këtu, shkoni në shtëpi!

— Nuk ia vlen. Së shpejti vjen mëngjesi. Në mëngjes duhet të zhytem deri tek anija e mbytur.

Besniku shoi dritën dhe tërhoqi derën me ngadalë.

E SHTUNË 9 KORRIK 2044

Rrezet e para sapo kishin kapur plazhin e Currilave. Iliri pa orën: ishte tetë pa pak minuta. I dha edhe më shumë gaz veturës dhe frenoi para hotelit të naftëtarëve. Zhurma e frenave nxori në dritare Agronin. Ai ia bëri me dorë Ilirit dhe u zhduk. Iliri priti poshtë dhe Agroni zbriti menjëherë.

— Ku janë arkeologët tanë? — pyeti Iliri.

— Tani vijnë, janë zgjuar që me natë dhe kanë shkuar të marrin Lantin. Nuk ju durohet.

— Nuk do të vonohemi shumë, — tha Iliri.
— Kur fillon inaugurimi?

— Në orën 12.00. Kemi kohë. Zhytëmi një orë e pastaj nisemi drejt e në kantier.

Iliri u mendua ca.

— Mirë, kemi kohë. Kam edhe një punë të vogël për të kryer.

— Çfarë? — pyeti Agroni.

— Do ta marrësh vesh, mos u nxito.

Ndërkohë u dëgjuan thirrjet e fëmijëve. Adi po bënte shenjë me dorë nga bregu. Ata të tre ishin gati, të veshur me akualang.

— Shpejt! — tha Iliri. — Na e kaluan djemtë.

Ata u futën brenda në hotel, morën kostumet e nënujit dhe dolën përsëri jashtë. Kur iu afruan djemve, panë në këmbët e tyre litarë dhe një thes.

— Po këto? — pyeti Agroni.

— Ku do t'i futim objektet që do të gjejmë?
— pyeti Adi.

— Kaq shumë do të gjejmë?! — pyeti Agroni.

— E, po tani ne jemi pesë vetë! — tha Gjergji.

— Të mos humbasim kohë, futemi, — dhe Iliri shikoi me sy Lantin.

— Në krye do të notoj unë, — tha Lanti, — pastaj Adi, Gjergji dhe shoku Agron, kurse ju, shoku Ilir, në fund të kolonës.

— Më vjen keq që do të jem në bisht, — qeshi Iliri, — po duhet të bindem.

Ndërsa bëheshin gati të zhyteshin, një zë i hollë vajze i ndali në vend.

Ana erdhi pranë, qëndroi të merrte frymë

dhe, pa i hedhur sytë fare Ilirit, iu kthye Lantit:
— Domethënë kështu, vendosët të zhyteni pa mua! Po si e kishim fjalën?

Lanti u skuq pak në fytyrë. Iu kujtua se dje kështu kishin vendosur: me ta do të vinte edhe Ana.

— Po... — tha ai, — ju nuk erdhët në kohën e caktuar.

Ana pa nga Iliri, i cili kishte ulur kokën dhe buzëqeshte.

— Pse nuk erdhe? Unë të prita!

— E kam unë fajin, — foli Agroni. — Donim të mbaronim shpejt, se do të shkojmë në kantier për inaugurimin.

— Atje do të vij edhe unë, — tha Ana dhe e pa përsëri me qortim Ilirin.

— Këtë radhë po të fal, po herë tjetër...

— Herë tjetër nuk ka për të ndodhur një gjë e tillë.

— Po mua a do të më merrni? — pyeti ajo.

— Vishu! — dha urdhër Lanti. — Dhe futu në kolonë pas shokut Agron.

Pas disa minutash ata ishin zhdukur nën ujë. Lanti, në krye, duke kontrolluar herë pas here busullën, udhëhiqte tërë kolonën prej gjashtë vetash. Kaluan fare pa folur algat e mëdha dhe po i afroreshin anijes.

— Një Blenius! — thirri Ana.

Të gjithë kthyen kokat andej nga tregonte ajo.

— Që kur levreku qenka bërë Blenius? — pyeti me të qeshur Lanti. Qeshi edhe vetë Ana.

— Kështu m'u duk, — tha ajo. — Nuk jam mësuar nën ujë.

— Ja edhe anija, — u dëgjua edhe zëri i Adit.

Ata notuan me shpejtësi drejt saj. Lanti shkoi andej nga ishin shenjat e shkronjave të emrit të anijes.

— A nuk është tamam «Zeusi»? — iu drejtua Agronit.

Agroni, Ana dhe Iliri u afruan më pranë.

— Zeusi, Zeusi, duket qartë! — thirri Ana.

— Po, s'ka asnjë dyshim, — tha edhe Agroni. — Ajo është dhe, me sa kam dëgjuar, ka qenë e ngarkuar me vepra arti të grabitura.

— Dhe ne deri tani nuk kemi gjetur asgjë, — vazhdoi si me dëshpërim Gjergji.

— Mos u mërzit, — i tha Iliri, — tani do të fillojmë sulmin me forca të shumta.

Pastaj mori levën dhe u zhyt thellë në hambar. U dëgjuan disa goditje e pastaj zëri i Ilirit:

— Këtu duhet të jetë një derë, ejani më bëni dritë.

Të gjithë shkuan atje. Ndezën elektrikët e dorës dhe në paretet anësore të hambarit vunë re një derë tërë myshk. Iliri e goditi disa herë dhe një dërrasë e madhe ra me zhurmë. U futën brenda. Elektrikët e dorës ndriçuan gjithçka.

— Këtu, këtu, — u dëgjua zëri i Lantit.

Ai u ul dhe zuri një grykë amfore. U mundua ta tërhiqte, por nuk arriti. Agroni, që u ndodh më pranë, e ndihmoi dhe ajo doli e plotë. Ishte veshur gjithë myshk, ashtu si dera.

— Nxirre në kuvertë! — urdhëroi Lanti Adin.

— Merre edhe këtë! — tha Iliri.

Në dorë kishte një amfore të vogël, por të

thyer te gryka. Adi i mori të dyja dhe u ngjiti lart. Kërkuan përsëri, por nuk gjetën gjë tjetër. Panë gjithandej se mos kishte ndonjë derë tjetër, por, siç dukej, ishte e vetmja.

— Me siguri ndodhen në pjesën e pazbuluar të anijes, nën rërë, — tha Agroni. — Këtu duhet të vijnë mjetet detare të portit, ato mund ta nxjerrin anijen.

Askush nuk foli. Amfora e sotme dhe ajo që u gjet disa ditë më parë, bashkë me trupin e statujës, nuk ishin pak. Ato dhe emri i anijes vlenin shumë për të krijuar bindjen se kishin të bënin me një anije të ngarkuar me vepra arti. Por do të ishte ndryshe sikur ata të paraqitnin në simpozium një gjë të re, të paparë ndonjëherë.

Pothuajse kështu mendonte secili nga të tre djemtë. Iliri herë pas here shihte orën.

Në orën 12.00 bëhej ceremonia e inaugurimit të sondës, por ata duhej të ishin në breg disa orë më parë. Por, sapo bëheshin gati për të dalë, u dëgjua thirrja e trembur e Anës.

Iliri notoi me shpejtësi në thellësi të hambatit, ku kishte mbetur Ana. Pas tij edhe të tjerët.

— Ana, çfarë ke? — pyeti i trembur Iliri.

— Asgjë, asgjë, — tha ajo, — m'u duk sikur në kuvertë kishte edhe njerëz të tjerë. Nga lëvizja ime ranë disa dërrasa dhe e mbuluan gropën.

Iliri dhe Agroni notuan andej nga tregonte Ana. Panë një kokë të bukur bronzi, që po i vështronte me krenari.

— Një statujë, një statujë! — thirri me gëzim të madh Lanti. — Ta nxjerrim.

— Fitore... fitore! — tha edhe Adi. — Ta nxjerrim shpejt.

— Daleni, mos u nxitoni, — foli Iliri. — Do të futemi unë dhe Agroni.

Ata u futën me vështirësi nëpërmjet gropës së hapur dhe u zhdukën.

— Na bëni dritë, — thirri Agroni. Ata u afruan me elektrikët e dorës.

— Qenka vetëm koka, — u dëgjua zëri i Ilirit.

— Aty duhet të jetë edhe trupi, — tha Lanti.

— Jo, këtu nuk ka gjë tjetër. Kushedi si ka rënë këtu kjo kokë, — foli Agroni.

Pas pak, ata e ngritën kokën lart. Djemtë e rrëmbyen. Ishte shumë e rëndë.

— Është bronz, ndaj rëndon, — tha Agroni.

Ai dhe Iliri u ngjitën dhe e morën vetë kokën.

— Sa e bukur qenka! — u çudit Ana. — Tamam fytyrë luftëtari ilir.

— Nisemi tani, — tha Iliri. — Kokën po e mbaj unë me Agronin. Ti, Lanti, vazhdo si gjithnjë në krye.

Të gjithë donin të qëndronin në fund, sa më pranë kokës së bronzit të luftëtarit.

Ora po afronte 9.00. Ata dolën në breg dhe, pasi u zhveshën, rrethuan me shumë kureshtje kokën e bronzit.


— Po amforat, ç'i bëtë? — pyeti Agroni.

Vetëm atëherë u kujtuan se, nga gëzimi, kishin harruar mbi kuvertë amforat që kishin gjetur.

— Nuk prish punë, — tha Lanti, — një amforë e kemi. Ato që lamë, i marrim ndonjëherë tjetër. Pak rëndësi kanë para kësaj koke të mrekullueshme.

* * *

Iliri dhe Agroni kishin kohë që ishin futur në zyrën e drejtorit.
Pritej të fillonte inaugurimi.



Iliri pa nga dritarja. Në shesh ishin mbledhur qindra njerëz. Orkestrina popullore ia kishte marrë një valleje të bukur dhe naftëtarët po kërcenin tërë vrull. Gjithandej flamuj të kuq zbukuronin sheshin. Në majë të sondës valëvitej gjithashtu një flamur. Në mes të saj, një parullë e madhe,

ku shkruhej: «E presim 100-vjetorin e çlirimit të atdheut dhe të fitores së revolucionit popullor ballëllartë».

— Sado të përpiqen armiqtë, nuk mund ta prishin këtë gëzim të popullit tonë, — tha Iliri si me vete.

— Çfarë, çfarë? — pyeti drejtori.

Iliri kishte folur me zë dhe ata e kishin dëgjuar.

— Them për festën e sotme, — iu përgjigj Iliri. — Armiqtë u munduan të na e prishin, por nuk u doli.

— Asnjëherë s'ka për t'u dalë, — tha Agroni.

Drejtori shtypi butonin e dha urdhër. Pas pak, në zyrë nisën të futeshin të gjithë ata që kërkoi drejtori. Naimi iu afrua e i dha dorën me dashuri. Po ashtu bëri edhe Kujtimi, por atë ditë ai se ç'kishte. Nuk ishte fort në qejf.

— Tani presim të vijnë shokët nga Tirana, — tha drejtori. — Çdo gjë është gati, apo jo?

— Po, — u dëgjua një thirrje e lehtë.

Atë çast u hap dera dhe në zyrë u futën Besniku dhe Arbeni.

Ata zunë vend pas shpatullave të Kujtimit.

Iliri bëri edhe një hap përpara. Në fytyrë ishte bërë tepër serioz. Të gjithë po e shihnin me habi.

— Inxhinier Kujtim Vraka, — tha Iliri me zë të lartë.

— Urdhëro! — tha i çuditur Kujtimi.

— Në emër të popullit je i arrestuar! — buçiti zëri i Ilirit.

Kujtimi ndjeu në çast ta shtrëngonin fort pas

krahëve. Ai u përpoq të shkëputej, por Besniku dhe Arbeni e kishin mbërthyer mirë e më pas i vunë prangat.

Të gjithë qëndronin në këmbë dhe shikonin këtë skenë kaq të papritur.

— Inxhinier Kujtim Vraka, — tha Iliri, — kujtove se po i hedh hi syve këtij populli, por gabove. Shqiptari është vigjilent në çdo hap. Nën udhëheqjen e Partisë së Punës të Shqipërisë, populli ka çelikosur unitetin e tij të pathyeshëm, ku keni thyer kokat të gjithë ju, armiqtë e vendit e të socializmit. Merreni! — u dha urdhër Besnikut dhe Arbenit.

Iliri u kthye pastaj nga shokët e tjerë.

— Shokë, ky gjarpër, — ia bëri me kokë andej nga nxorën Kujtimin, — ishte fshehur në gjirin e popullit, por u zbulua, iu dogjën planet në dorë. Ai ka vite që është përgatitur për të sabotuar dhe kujtoi se i erdhi rasti në sondën tonë detare. Në fillim propozoi të zëvendësohej dalta që të vonoheshin punimet, të vihej një tjetër aparaturë dhe kështu të shpërthente nafta e të ndotej tërë bregu. Por kur propozimi i tij nuk u pranua nga Agroni dhe Naimi, atëherë ai u zhyt një natë dhe e preu korpusin. Që dyshimi të binte mbi Agronin, veshi natën aktualangun e tij. Por nuk i eci. Dhe së fundi, në bashkëpunim me armikun e jashtëm, donte ta hidhte sondën në erë. Por vigjilenca e popullit tonë, ku jo vetëm të rriturit, por edhe fëmijët janë vigjilentë, e zbuloi dhe ia preu gjuhën këtij gjarpri.

Një ndjenjë gëzimi i pushtoi të gjithë.
Nisi të fliste drejtori:

— Shokë, armiqtë gjithnjë do të thyejnë kokën në kalanë tonë. Ejani tani të hedhim valle së bashku me naftëtarët.

Ata dolën jashtë dhe u futën të gjithë në valle. Ashtu i gjeti ministri dhe shokët e tjerë që erdhën nga Tirana. Drejtori u mat të ndërpriste muzikën, por ministri tha:

— Jo, prit. Më ka marrë malli të kërcej kësh-tu, — dhe u fut në valle.

Kur pushoi vallja, nisi edhe ceremonia e inaugurimit. Adi, Lanti dhe Gjergji kishin mundur të hynin deri në krye, pranë platformës, dhe po shikonin me fytyra të qeshura. Pas fjalimit zyrtar, u pre shiriti dhe sonda nisi punën. Në tub rrodhi nafta dhe të gjithë brohoritën me të madhe, sikur nëpër trup të tyre të kishte rrjedhur më me vrull gjaku jetëdhënës. Ata këndonin, kërcenin, qeshnin me zë të lartë dhe uronin njëri-tjetrin për këtë fitore. Midis tyre sillej rrotull një djalë i shkurtër, me flokë të drejtë, me një magnetoskop në krah dhe incizonte pjesë për kronikën stereovizive. Ishte Andi, kronist i stereovizionit.

— Merre, Andi, merre, — i thirri një punëtor, — shpërndaje në eter gëzimin tonë. E fut dot në atë kamerën tënde gjithë këtë gëzim?

Andi qeshi dhe shkoi më tej. Pas pak u largua dhe vetura e tij u nis me ngut për në qendrën e transmetimit.

*
*
*

Mister Xhoni kishte orë që s'kishte lëvizur nga kabineti i tij. Drejtori i institutit e kishte sharë rëndë dhe ai akoma nuk po e merrte veten. Si dështoi kështu operacioni «Gjarpri i detit»? Edhe këtë radhë ia kishin hedhur shqiptarët. Megjithatë, e mbante një shpresë se mos agjentët e tij nuk kishin pësuar gjë dhe kishin arritur ta hidhnin në erë sondën. Bile kështu i kishte thënë edhe drejtorit të tij.

— Akoma shpresoj!

Ra sinjali i videofonit dhe ai dëgjoi zërin e egër të drejtorit.

— Ti ndoshta shpreson akoma. Hap aparatën e stereovizorit dhe ndiq transmetimin në kanalin ndër-kombëtar.

Ai shtypi me shpejtësi butonin dhe në ekran u dukën pamjet e para. Në një sondë po bëhej festë e madhe. Zëri i folësit po njoftonte: Sot naftëtarët shqiptarë arritën një sukses të madh duke nxjerrë naftë nga nëndeti me një metodë të re shkencore, të papërdorur deri tani...

Mister Xhoni mbylli aparatën dhe zuri veshët me duar. Nuk mund të dëgjonte më. I dukej sikur po çmendej. U ngrit dhe mori rrugën për në shtëpi. Te dera nuk e priti askush.

«Aq më mirë, — mendoi. — Nuk dua të shoh asnjë njeri sot».

Sakaq u fut në kabinetin e tij. Por shtangu në derë. Kasaforta e tij personale ishte hapur dhe pra-

në saj, me një shumë të madhe dollarësh në dorë, po qëndronte i biri.

— Henri, — thirri Xhoni, — lëri dollarët aty.

Henri qeshi me të madhe dhe i rrsi dollarët në fund të xhepit.

— Henri! — thirri përsëri mister Xhoni.

Djali qeshi përsëri dhe e pa të atin me një palë sy të skuqur e të zgurdulluar.

— Qenka fare i narkotizuar, — mendoi Xhoni dhe iu sul të birit, por nuk arriti.

U dëgjua një krismë revolveri dhe Xhoni u plas në dysheme. Henri fryu me kapadaillëk grykën e revoles dhe doli nga kabineti pa e kthyer kokën fare.

Këtu mbaroi karriera e mister Xhonit, në kabinetin e tij, nga dora e djalit të tij të vetëm.

*

* * *

Sapo ra ora 17.00, në sallë u bë qetësi. Në presidium zunë vend profesor Dorian Koçiu, drejtori i pallatit të pionierëve dhe Lanti, përfaqësuesi i pionierëve arkeologë.

I pari foli drejtori:

— Sot zhvillohet simpoziumi i arkeologëve të vegjël të pallatit të pionierëve të qytetit të Durrësit. Të gjithë ata që kanë zbuluar diçka, do të raportojnë dhe në fund profesori do të bëjë konkluzionet e do të ndajë distinkтивat.

Adi, Gjergji, Agroni, Naimi dhe Ana kishin zënë vend në rreshtin e parë. Diskutantët raportojnë

nin për punën e tyre. Adi dhe Gjergji mezi po pritnin të ngrihej Lanti, që ishte ulur në presidium, dhe të fliste për kërkimet e zbulimet e tyre. Ja edhe radha e Lantit. Ai u ngrit dhe zuri vend në podium.

— Gjatë kësaj vere, — tha Lanti, — na ndodhi një ndryshim në planin tonë të kërkimeve. Rastësisht ramë në gjurmë të një anije të mbytur dhe krijuam bindjen se në atë anije mund të gjenim objekte të shumta arkeologjike. Kjo rastësi na çoi në një zbulim të madh, në zbulimin e anijes romake të mbytur shumë shekuj më parë, «Zeusi», dhe të një numri objektesh arkeologjike, ndërmjet të cilave më me rëndësi na duket një kokë bronzi e një luftëtari ilir.

Lanti fliste rrjedhshëm dhe tregonte për të gjitha pengesat që kaluan për të shkuar deri te zbulimi i rëndësishëm. Të gjithë po e dëgjonin me vëmendje të madhe.

— Për të gjitha këto, — tha Lanti në fund, — duhet të falënderojmë Adin dhe Gjergjin, të pranishëm në këtë sallë, dy pionierë tiranas, pa pjesëmarrjen e të cilëve ky zbulim nuk do të ishte bërë.

Adi dhe Gjergji u skuqën dhe ulën kokat. Lanti mbaroi dhe, nën breshërinë e duartrokitjeve, u ul në karrige. U ngrit profesori dhe në sallë ra qetësia.

— Të gjitha ato që raportuan këtu arkeologët e vegjël, janë shumë të rëndësishme. Në emër të kolektivit të muzeut, ju falënderoj. Por dua të falënderoj në mënyrë të veçantë zbuluesit e kokës së bronzitë. Vlerat e saj janë të jashtëzakonshme

dhe zbulimi ka rëndësi kombëtare. Më lejoni, pra, të falënderoj edhe një herë Lantin, Adin dhe Gjergjin, — përfundoi profesori. — Me këtë rast, siç është zakoni, distinktivin «Arkeolog i dalluar» e merr ai që ka bërë zbulimin më të rëndësishëm: Lanti, Adi dhe Gjergji.

— Ku janë? Të dalin në skenë, — thirrën nga salla.

Drejtori i vuri distinktivin në gjoks Lantit dhe u bëri me shenjë dy djemve të tjerë. Ata u ngjitën në skenë dhe në sallë buçitën duartrokitjet. Ata morën distinktivat dhe, të skuqur në fytyrë, shkuan drejt vendit të tyre. Agroni i puthi të dy me shumë dashuri. Ashtu bënë edhe të tjerët. Kur dolën jashtë, kishte rënë mbrëmja.

— Tani do të ndahemi, — tha Adi. — Sa keq më vjen!

— Edhe mua, — ia ktheu Lanti. — Sa shpejt kaloi kjo javë!

— Përshëndetuni tani, — tha Agroni. — Duhet të nisemi me trenin që shkon pas dhjetë minutash.

Ata u përqaftuan fort me njëri-tjetrin dhe premtuan të takoheshin përsëri. Lanti do të shkonte në Tiranë dhe ata do të vinin tek ai në Durrës. U përshëndetën edhe me Naimin, Ilirin dhe Anën.

— Mirupafshim! — thirrën të gjithë njëzëri.

— Daleni, daleni! — thirri Ana. — Ilir, harrove ftesën.

— Po, vërtet, — u hutua Iliri. — Më vjen keq që po ndahem nga shokët e rinj.

Ai i mori përsëri të tre pranë vetes dhe u tha:

— Në gusht do të bëjmë dasmën. Ju ftojme

të vini në Valbonë. Atje nuk ka anije të mbytura,
por ka bjeshkë të mrekullueshme dhe peshq, që
nuk i keni parë kurrë.

Djemtë e përçafuan edhe një herë Ilirin e Anën
dhe u ndanë duke premtuar:

— Do të vijmë, patjetër do të vijmë!...

Qerama, Th.

Një javë në vitin 2044.
Roman fantastiko-shkencor.
[Red.: K. Leli. Pikt.: I. Shahini]. T.,
«Naim Frashëri», 1982.

148 f. me il. (Bibliot e Pionierit)

(B.m.) dhe

(B.v.) : 891.983-93-31

Q 45

Tirazhi 8000 kopje

Format 70x100/32

Stash 2204-79

KOMBINATI POLIGRAFIK, Shtypshkronja e Re -

Tiranë, 1982